



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 37 regjistër (JR)
Datë 01.09.2022

Nr. 25 i vendimit
Datë 26.06.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtaret:

Albana Shtylla	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 26.06.2023, ditën e hënë, në orën 14:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 37/2022 (JR), datë 01.09.2022, që i përket:

ANKUESE: Komisionerja Publike Irena Nino.

OBJEKTI: Ndryshimi i vendimit nr. 535, datë 26.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Bledar Bejko.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, Neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e Komisioneres Publike Irena Nino, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, e cila përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 535, datë 26.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, shqyrtoi prapësimet e subjektit të rivlerësimit Bledar Bejko, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Bledar Bejko ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet përkatëse ndihmëse, deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata vetting”) në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka administruar raportet e hartuara për subjektin e rivlerësimit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).
 - 3.1. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Bledar Bejko, ka dërguar në Komision një raport në të cilin ka konstatuar se: (a) *deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;* (b) *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;* (c) *ka*

mosdeklarim pasurie ndër vite; (ç) nuk ka kryer deklarim të rremë; si dhe (d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

3.2. DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar për subjektin e rivlerësimit raportin nr. {***} prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës, të përditësuar dhe deklasifikuar pjesërisht, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Bledar Bejko, duke konkluduar, ndër të tjera, se: *në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit të pastërtisë së figurës së një subjekti rivlerësimi, në rastin tonë, në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve, në kundërshtim me ligjin, në mospërbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jomateriale të padrejta për atë vetë si funksionar publik apo për persona të lidhur me të, duke dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit apo të personave të tjerë, vlerësohet se cenohet pastërtia e figurës së subjektit në fjalë dhe shkalla e besueshmërisë së tij.*

3.3. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe, në përfundim, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, referuar Aneksit të Kushtetutës, nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriteret e rivlerësimit, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, në provat e administruara, në shpjegimet e subjektit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara, konkludoi se subjekti i rivlerësimit Bledar Bejko:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

- Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se subjekti i rivlerësimit Bledar Bejko ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke

arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

5. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni vendosi: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Bledar Bejko, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.*

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

6. Në datën 03.08.2022, Komisionerja Publike Irena Nino (në vijim “Komisioneri Publik”) ka paraqitur ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 535, datë 26.05.2022, i cili ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit Bledar Bejko.
7. Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, ka konstatuar se, nga shqyrtimi i vendimit nr. 535, datë 26.05.2022, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, duke analizuar konstatimet për secilin nga kriteret e vlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, paraqiten gjetje dhe rrethana të tilla ligjore e faktike, të cilat e bëjnë atë të cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmbajnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’ia paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.
8. Referuar përmbajtjes së ankimit të Komisionerit Publik, rezulton se çështjet e ngritura prej tij, adresohen në drejtim të të tria kriterëve të rivlerësimit, të cilat paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

Lidhur me gjetjet në kriterin e vlerësimit të pasurisë

9. **Për pasurinë apartament, me sip. 96,5 m², {***}, {***}, Tiranë,** Komisioneri Publik, sipas situatës faktike, vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni nuk është i mbështetur në provat e administruara dhe në ligjin e zbatueshëm, pasi:
 - 9.1. Në deklaratën periodike vjetore (në vijim “DPV”) 2008, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, nuk ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “{***}” ShPK, pagesën në shumën 20.000 euro, të kryer në prill të vitit 2008, si dhe burimin e krijimit të saj.
 - 9.2. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në 2008 kreditë konsumatore, në shumën totale 9.000 euro, të marra nga ai dhe personi i lidhur me të, në Tirana Bank, shlyerjen e parakohshme të kredive konsumatore dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e tyre.

9.3. Burimi i krijimit për shlyerjen e parakohshme të kredive është deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur në deklaratën *vetting*, me burim fondet e familjes së znj. R. B.. Ky burim krijimi është i ndryshëm nga burimi i deklaruar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, çka bie në kundërshtim me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet qartë se subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë dhe duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave.

9.4. Komisioneri Publik vlerëson se mosdeklarimet në deklaratat periodike vjetore, deklarinimet e pasakta dhe kontradiktore në deklaratën *vetting* dhe gjatë hetimit administrativ, mbi burimin financiar që ka shërbyer për shlyerjen e parakohshme të kredive në shumën totale 9.000 euro, çojnë në pamundësi për të verifikuar se cilat nga deklarinimet e subjektit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me burimin e të ardhurave për shlyerjen e kësaj shume. Pasaktësitë në deklarinimet e subjektit të rivlerësimit e bëjnë në këtë rast, deklarinimin e tij të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a”, dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

10. Për pasurinë **automjet tip “Daimler Chrysler”, E270 CDI**, blerë në Gjermani nga subjekti i rivlerësimit më datë 13.4.2007, Komisioneri Publik, referuar gjendjes së akteve në dosje, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni dhe vlerëson se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, për sa në vijim.

10.1. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2007, blerjen, burimin e krijimit, shitjen dhe të ardhurat e realizuara nga shitja e këtij automjeti.

10.2. Pretendimet e subjektit mbi konsiderimin si lapsus të shumës 500.000 lekë, të parashikuar në kontratën e shitjes, mbeten në nivel deklarativ dhe duket se subjekti kërkon të provojë një fakt të ndryshëm nga përmbajtja e kontratës noteriale të shitblerjes së pasurisë së luajtshme.

10.3. Deklarimet e subjektit se e ka blerë këtë automjet vetëm për të ndihmuar shokun e tij, z. I. V., bien ndesh me përmbajtjen e kontratës, ku referohet se palët nuk njihen me njëra-tjetrën. Në këto rrethana, mbetet e paqartë marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me shtetasin I. V..

10.4. Komisioneri Publik vlerëson se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, në drejtim të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të përcjellë në lidhje me këtë pasuri të luajtshme, e bëjnë deklarinimin e subjektit të rivlerësimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

11. Për pasurinë **automjet tip “Mercedes Benz”, me targa belge, {***}**, Komisioneri Publik, në ndryshim nga Komisioni, vlerëson se rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ mbi këtë

pasuri, deklaramet kontradiktore, çështjet e pahetuara mbi rrethanat e vjedhjes së mjetit, shtetasit e përfshirë në transaksionin e blerjes, të cilat mbeten në nivel deklarativ, mungesa e arsytimit ligjor në vendimin e pushimit të procedimit penal nr. {***}, shfaqin qasje të pakujdesshme të subjektit të rivlerësimit dhe janë elemente të cilat duhen vlerësuar nga Kolegji, në drejtim të parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në referencë të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

12. **Për transaksionet bankare të kryera nga personi i lidhur, znj. R. B. (R.),** Komisioneri Publik paraqet para Kolegjit disa rrethana, të cilat, në vlerësimin e tij, paraqesin elemente që mund të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të procedurave lidhur me kriterin e pasurisë, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me kontrollin e figurës dhe gjetjet në raportin e DSIK-së

13. Komisioneri Publik parashtron se lidhur me procedimin penal nr. {***}, në rastin e subjektit të rivlerësimit, ndryshe nga qëndrimi i mbajtur nga Komisioni, çështjet e referuara në raportin e DSIK-së që ngrenë dyshime për përfshirje në veprime korruptive, paraqesin rrethana të ndryshme nga ato të verifikimit të aftësive profesionale të subjektit dhe, në konsideratë edhe të jurisprudencës së Kolegjit, është e pamundur që në kuadër të vlerësimit të figurës, të zbatohen standardet e kontrollit të aftësive profesionale. Në përfundim, për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioneri Publik vlerëson se nga të dhënat e administruara si rezultat i informacioneve të organeve ligjzbatuese, duket se rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuar së bashku me rezultatet e tjera të hetimit, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Nga të dhënat e administruara, rezulton se gjatë procedimit penal nr. {***}, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë kryer njoftim mbi vendimin e pushimit, sipas parashikimeve ligjore, duke u mohuar palëve të drejtën për ushtrimin e ankimit. Mosushtrimi i ankimit nga palët e interesuara, për shkak të mosnjoftimit të tyre, ka sjellë si pasojë barazimin e vendimit për pushimin e akuzës me vendimin e pafajësisë për të akuzuarin.

Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale

14. Në procedimin penal nr. {***}, regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të punonjësve të policisë të dyshuar, komisar K. Xh. dhe nënkomisar Gj. A., duket se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e çështjes, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, të arsytimit ligjor dhe cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik të prokurorit, sipas parashikimeve të nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, të cilat duhet të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me denoncimet nga publiku

15. Për sa i përket denoncimit të paraqitur në Komision nga shtetasi A. A., Komisioneri Publik, ndryshe nga Komisioni, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje penale, pasi mosrespektimi i afateve ligjore, moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3, dhe nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe duhet të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
16. Për sa i përket denoncimit të shtetasit S. M., në analizë të përmbajtjes së denoncimit, rezultateve të hetimit administrativ dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim hetimor në drejtim të zgjidhjes së çështjes. Subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, pasi moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme bie ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3, si dhe në nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe duhet të merret në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
17. Në përfundim, Komisioneri Publik, duke konstatuar mangësi për kriterin e pasurisë, problematika në kontrollin e figurës dhe të aftësive profesionale, si dhe në raport me sjelljen e pakujdesshme të subjektit të rivlerësimit në marrëdhënie me të tretë, arrin në përfundimin se qëndrimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit Bledar Bejko ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nuk është i mbështetur në një vlerësim të drejtë të fakteve, provave dhe legjislacionit të zbatueshëm. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe në përfundim të shqyrtimit të çështjes, të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 535, datë 26.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

IV. Kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit

18. Subjekti i rivlerësimit, në datën 06.09.2022, ka paraqitur apel kundërshtues kundër ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik, duke kërkuar nga Kolegji mospranimin e ankimit kundër vendimit nr. 535, datë 26.05.2022, të Komisionit, si ankim i paraqitur jashtë afatit 15-ditor të parashikuar nga nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, lënien në fuqi të këtij vendimi.

V. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

19. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Çështja në shqyrtim, që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit nga Komisioneri Publik, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

20. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
21. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis* të ankuesit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegj, më datë 06.09.2022, një apel kundërshtues, duke pretenduar se ankimi i paraqitur nga Komisioneri Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 535, datë 26.05.2022, është paraqitur tej afatit 15-ditor të parashikuar nga neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka marrë dëgjimin për vendimin e Komisionit më datë 19.07.2022 dhe dita e fundit kur legjitimohej të paraqiste ankimin, ka qenë data 02.08.2022, dhe jo data 03.08.2022, datë kur është depozituar ankimi. Subjekti i rivlerësimit parashtron se sipas nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, afati 15-ditor fillon që ditën e njoftimit, ndryshe nga parashikimet për llogaritjen e afateve në Kodin e Procedurave Administrative dhe në Kodin e Procedurës Civile. Për këto arsye, subjekti kërkon nga Kolegji prishjen e vendimit nr. 535/1, datë 05.08.2022, të Komisionit për pranimin e ankimit të Komisionerit Publik.
22. Në vlerësim të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) sjell në vëmendje se ligji nr. 84/2016, në nenin 63, pika 1 parashikon se: *1. Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.* Ndërsa në nenin 3 të këtij ligji parashikohet se: *1. “Ditë” nënkupton ditë kalendarike që llogariten sipas rregullave të përcaktuara në nenin 56 të Kodit të Procedurave Administrative. Neni 56 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon se: 1. Përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji, afatet caktohen në ditë, muaj ose vite. Përfundimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të*

caktuar kalendarike. 2. Kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati. 3. Afati i përcaktuar në muaj ose vite mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji apo atij viti të fundit, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. 4. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

23. Nga dispozitat e mësipërme, trupi gjykues vëren se, ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, në procedurën e rivlerësimit llogaritja e afateve bëhet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative. Sipas këtyre dispozitave, duke llogaritur afatin 15-ditor të paraqitjes së ankimit të Komisionerit Publik nga data 19.07.2022 kur ka marrë dijani për vendimin¹, pa e përfshirë këtë datë, rezulton se paraqitja e ankimit nga Komisioneri Publik më datë 03.08.2022², është brenda afatit prej 15 ditësh (dita e fundit e këtij afati). Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se Komisioneri Publik legjitimohet *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

24. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 535, datë 26.05.2022, për subjektin e rivlerësimit Bledar Bejko, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.
25. Në funksion të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, në seancën gjyqësore të datës 17.05.2023, vendosi çeljen e hetimit gjyqësor duke marrë në cilësinë e provës, për nevoja të hetimit gjyqësor, aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit³. Trupi gjykues ia nënshtroi këto akte debatit gjyqësor e më pas i vlerësoi ato në raport me vendimin objekti shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik.

¹ Sipas dokumentit lajmërim marrje, regjistruar nga Institucioni i Komisionerëve Publikë me numër {***} prot., datë 19.07.2022.

² Regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 03.08.2022.

³ Në seancën gjyqësore të datës 17.05.2023, subjekti i rivlerësimit i kërkoi trupit gjykues marrjen dhe shqyrtimin në seancë gjyqësore të provave si më poshtë:

1. Shkresa nr. {***} prot., datë 05.05.2023, kthim përgjigje subjektit, si dhe dokumentacioni dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme në lidhje me ankesat e shtetases V. A. (32 fletë).

2. Vendim nr. {***}, datë 2.11.2017, i Gjykatës së Apelit Durrës, ndaj të ndaluarit Gj. A., që i përket procedimit penal nr. {***} (10 fletë).

26. Në Kolegj, pas regjistrimit të çështjes objekt gjykimi, janë administruar disa denoncime nga publiku që i adresoheshin subjektit të rivlerësimit, si më poshtë.

- *Pesë denoncime nga shtetasi I. H., nga të cilat tri denoncime janë përcjellë në Kolegj nga Komisioneri Publik me shkresën nr. {***}, datë 09.12.2022, shkresën nr. {***}, datë 13.12.2022 dhe shkresën nr. {***}, datë 18.4.2023; si dhe dy denoncime të ardhura në Kolegj, protokolluar me nr. {***}, datë 16/01/2023 dhe me nr. {***} prot., datë 11.05.2023.*

- *Denoncim nga shtetasit A. G., S. R., J. K., B. Xh., A. D., përcjellë në Kolegj me shkresën nr. {***}, datë 09.02.2023, të Komisionerit Publik.*

- *Denoncim nga banorët e pallatit nr. {***}, Durrës, përcjellë në Kolegj me shkresën nr. {***}, datë 10.02.2023, të Komisionerit Publik.*

- *Denoncim nga shtetasja A. Z., protokolluar në Kolegj me nr. {***}, datë 22.02.2023.*

- *Denoncim nga avokati S. K., protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 28.03.2023.*

- *Denoncim nga shtetasja L. P., protokolluar me nr. {***} prot., datë 11.05.2023, në Kolegj.*

27. Këto denoncime, Kolegji ia vuri paraprakisht në dispozicion subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar, para fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Për këto denoncime, subjekti i rivlerësimit, në seancën gjyqësore të datës 17.05.2023, paraqiti shpjegimet dhe prapësimet e tij, të depozituara paraprakisht me shkrim në Kolegj, më datë 15.05.2023.

28. Trupi gjykues, mbështetur në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, në seancën e datës 17.05.2023, pasi shqyrtoi dhe vlerësoi denoncimet e paraqitura në Kolegj, edhe në raport me shpjegimet dhe aktet që paraqiti subjekti i rivlerësimit lidhur me to, me vendim të ndërmjetëm, vendosi:

(i) Për denoncimet e shtetasit I. H., trupi gjykues vlerësoi se nuk ishte e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme, duke qenë se aktet e administruara në Kolegj ishin të mjaftueshme për të bërë një vlerësim lidhur me to.

(ii) Për denoncimin e banorëve të pallatit nr. {***} në Durrës, shtetasve A. G., S. R., J. K., B. Xh., A. D., trupi gjykues vendosi t'i kërkojë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës informacion se kur është regjistruar kjo çështje, kur është caktuar subjekti i rivlerësimit prokuror i saj, listimin e veprimeve hetimore që subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë lidhur me to, si dhe kopje të akteve që tregojnë këto veprime.

(iii) Lidhur me denoncimin e shtetasës A. Xh., trupi gjykues vendosi t'i kërkojë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, informacion nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur angazhime gjyqësore në datat e seancave gjyqësore të cituara nga denoncuesja, konkretisht në datat 15.04.2022, 06.06.2022 dhe 06.12.2022, në të cilat pretendohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë prezent.

(iv) Për denoncimin e avokatit S. K., trupi gjykues vendosi t'i kërkojë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës informacion për veprimet hetimore të kryera nga subjekti i

rivlerësimi për regjistrimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2017 e në vijim, si dhe kopje të akteve që tregojnë këto veprime.

(v) Trupi gjykues vlerësoi se denoncimi i depozituar nga shtetasja L. P. nuk sjell fakte dhe rrethana që sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, sjellin nevojën për hetime të mëtejshme.

29. Në përgjigje të kërkesës së Kolegjit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me shkresën nr. {***}, datë 02.06.2023, dërgoi informacion, si dhe akte lidhur me çështjet e trajtuara në kërkesën e Kolegjit. Këto akte, pasi u përçollën paraprakisht Komisionerit Publik dhe subjektit të rivlerësimit, u administruan në cilësinë e provës nga trupi gjykues dhe iu nënshtruan gjithashtu debatit gjyqësor në seancën gjyqësore të datës 19.06.2023.
30. Në përfundim të hetimit gjyqësor, Kolegji vlerësoi shkaqet e ngritura në ankim, pretendimet përfundimtare të Komisionerit Publik dhe pretendimet e ngritura në denoncimet për të cilat trupi gjykues vendosi të kryente hetime, duke analizuar e çmuar të gjitha provat që gjendeshin në fashikullin e hetimit administrativ të krijuar nga Komisioni, si dhe ato që u morën gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Kolegj dhe që iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit nga Kolegji

i. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

31. **Për pasurinë apartament, me sip. 96,5 m², të ndodhur {***}, {***}, Tiranë,** Komisioni ka arritur në konkluzionin se: [...] 2.36. *Sa i përket burimit tjetër të krijimit të pasurisë, 10.000 euro, të cilat janë transferuar nga llogaria bankare e subjektit të rivlerësimit, ashtu siç u citua edhe më sipër, burimi i kësaj shume ishin dy kredite konsumatore të cilat u morën nga subjekti dhe bashkëshortja e tij për të paguar këstin e parë të kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë “{***}” ShPK. Pas revokimit të kontratës, kjo shumë iu kthye subjektit dhe u përdor si burim krijimi për kontratën e re të lidhur me shoqërinë “{***}”. 2.37 Trupi gjykues nuk ka konstatuar problematika lidhur me marrjen e këtyre dy kredive. 2.38 Ndërsa, sa i përket konstatimit të Komisionit dhe ILDKPKI-së se subjekti nuk i ka deklaruar shlyerjet e këtyre dy kredive në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, trupi gjykues vlerëson se, për sa kohë provohet marrja e këtyre kredive dhe shlyerja e tyre brenda të njëjtit vit kalendarik, mosdeklarimi në DPV-në e vitit 2008 nuk mund të kategorizohet si pasaktësi apo të evidentohet si problematikë. 2.39 Në këtë çështje, trupi gjykues ka analizuar dhe vlerësuar faktet sa i takon burimit të përdorur për shlyerjen e këtyre dy kredive, pasi subjekti ka deklaruar se ato u shlyen nga fondet e familjes së bashkëshortes, ndërkohë ky deklarim pretendohet si lapsus nga ana e tij, pasi janë shlyer nga prindërit. 2.40 Trupi gjykues, në referim të deklaramit të subjektit në vitin 2008, se prindërit i kanë dhuruar shumën 57.000 euro, i cili përputhet me deklaramin e tij gjatë procesit dhe provueshmërisë së veprimeve juridike të ndodhura në vitin 2008, arsyetuar në pikën 2.8 (i-iv)*

të këtij vendimi, por edhe nga analiza financiare e kryer (pasqyruar në tabelën nr. 2), konkludon se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare të dhurojnë shumën totale prej 57.000 eurosh (47.000 + 10.000). Në këtë kontekst, lapsusi i pretenduar për shumën 10.000 euro bëhet i besueshëm, për sa kohë u provua që prindërit e subjektit në vazhdimësi janë karakterizuar me të ardhura të ligjshme dhe në nivel mbi mesataren. 2.41 Nga ana tjetër, po për këtë çështje objekt vlerësimi, nisur nga fakti se subjekti: (i) gjatë gjithë procesit i qëndron deklaramentit se këto kredi janë mbyllur nga prindërit e tij; (ii) në shlyerjet e kryera për këto dy kredi, nuk është cilësuar burimi as në depozitimet në bankë – trupi gjykues ka vlerësuar të kryejë analizën financiare të subjektit të rivlerësimit në kushte asnjënjëse, se shlyerjet e këtyre dy kredive janë mbuluar me të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes.

32. Pas kryerjes nga Komisioni të përlllogaritjeve financiare në datën e mbylljes së kredive, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare të shlyejë dy kreditë e marra për të paguar këstin e parë të kontratës së sipërmarrjes, e cila u revokua dhe shuma e kthyer shërbeu më pas për një nga pagesat e kontratës së re për blerje apartamenti, pasuri që subjekti e zotëron aktualisht.
33. Në konkluzion për këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar se deklaramentet e subjektit edhe në eventualitetin e çmuarjes si pasaktësi të deklaramentit të tij, për sa kohë kjo e fundit nuk rezultoi e shoqëruar me mungesë burimesh financiare, pra nuk passjell ndonjë pasojë, nuk mund të përbëjnë shkak për penalizimin e tij. Në një vlerësim tërësor të të gjitha rrethanave të rezultuara, si gjatë hetimit administrativ, përfshirë edhe atij shtesë, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmoi se subjekti ka shpjeguar dhe provuar bindshëm burimet e krijimit të saj.
34. Komisioneri Publik vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni nuk është i mbështetur në provat e administruara dhe ligjin e zbatueshëm, pasi:
 - (i) Në DPV-në 2008 rezulton se subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, nuk ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “{***}” ShPK, pagesën në shumën 20.000 euro, të kryer në prill të vitit 2008, si dhe burimin e krijimit të saj. Kjo marrëdhënie kontraktuale nuk është saktësuar nga subjekti as në deklaratën “vetting”, në kushtet kur shuma e kthyer nga kjo shoqëri ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit që subjekti i rivlerësimit ka aktualisht në pronësi.
 - (ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në 2008 kreditë konsumatore, në shumën totale 9.000 euro, të marra nga ai dhe personi i lidhur me të në Tirana Bank, shlyerjen e parakohshme të kredive konsumatore dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e tyre.
 - (iii) Për herë të parë, burimi i krijimit për shlyerjen e parakohshme të kredive është deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur në deklaratën “vetting”, me burim fondet e familjes së znj. R.R.B. Ky burim krijimi është i ndryshëm nga burimi i deklaruar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, çka bie në kundërshtim me parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ku

parashikohet qartë se subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë dhe duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave.

35. Komisioneri Publik vlerëson se mosdeklarimet në deklaratat periodike vjetore, deklarimet e pasakta dhe kontradiktore në deklaratën *vetting* dhe gjatë hetimit administrativ, mbi burimin financiar që ka shërbyer për shlyerjen e parakohshme të kredive në shumën totale 9.000 euro, çojnë në pamundësi për të verifikuar se cilat nga deklarimet e subjektit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me burimin e të ardhurave për shlyerjen e kësaj shume. Pasaktësitë në deklarimet e subjektit të rivlerësimit e bëjnë në këtë rast deklarin e tij të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a”, dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
36. Nga analiza e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë çështje, rezulton se blerja e këtij apartamenti është deklaruar për herë të parë prej tij në deklaratën periodike vjetore 2008, me burim: 57.000 euro, dhënë *cash* nga kursimet e prindërve dhe diferenca prej 30.000 eurosh është marrë kredi në Bankën Tirana. Në vitet në vijim, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore shlyerjen e kësaj kredie. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit shumën 47.000 euro, transferuar nëpërmjet Bankës Tirana Bank nga prindërit e tij, ndërsa 10.000 euro janë marrë nga dy kredi konsumatore, 4.000 euro në emër të subjektit dhe 5.000 euro në emër të bashkëshortes R. R.. Subjekti ka deklaruar në këtë deklaratë se këto dy kredi janë marrë në vitin 2008 dhe janë shlyer brenda këtij viti nga fondet e familjes së bashkëshortes. Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë të vitit 2008, subjekti nuk i ka deklaruar dy kreditë konsumatore në shumën 9.000 euro dhe shlyerjen e tyre brenda vitit, sikurse deklaroi, nga prindërit e bashkëshortes. Ndërkohë, gjatë hetimit në Komision, subjekti ka deklaruar se këto dy kredi janë shlyer para afatit, me burim nga ndihma e prindërve të tij.
37. Nga analiza e akteve të administruara gjatë hetimit administrativ lidhur me situatën faktike që shoqëron dy kreditë konsumatore, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë lidhur një kontratë sipërmarrjeje [me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.04.2008] me shoqërinë “{***}” ShPK për blerjen e një apartamenti me sipërfaqe neto 103,22 m², në vlerën 85.000 euro, me adresë: rruga “{***}”. Sipas këtij akti, kësti i parë është likuiduar nga porositësit në shumën 20.000 euro, në momentin e redaktimit të kësaj kontrate pa pretendime nga palët. Babai i subjektit të rivlerësimit, shtetasi S.B., ka paguar nga llogaria e tij bankare në Bankën Tirana, shumën 8.000 euro, në datën 07.04.2008, për shoqërinë “{***}” ShPK, me përshkrimin “Kapar, garanci ap. 2+1, deri 30.04.2008, ku do të kryhet kontrata”. Subjekti rivlerësimit ka paguar nga llogaria e tij bankare në Bankën Tirana, shumën 9.000 euro, më datë 24.04.2008, për shoqërinë “{***}” ShPK, me përshkrimin: “Pagesë blerje apartamenti, kontratë sipërmarrjeje 30.04.2008”. Për pagesën prej 9.000 eurosh, subjekti së bashku me bashkëshorten e tij kanë marrë dy kredi në Bankën Tirana, më datë 23.04.2008, përkatësisht

5.000 euro R. R. dhe 4.000 euro subjekti. Kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë “{***}” ShPK është revokuar me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.10.2008, ku palët kanë rënë dakord që të revokojnë kontratën e sipërmarrjes dhe shoqëria i ka kthyer subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes shumën e paguar prej 20.000 eurosh. Pas revokimit të kontratës me shoqërinë “{***}” ShPK, subjekti ka lidhur një kontratë të re, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.10.2008, me palë shitëse shoqërinë “{***}” ShPK, për blerjen e apartamentit që ka aktualisht në pronësi.

38. Lidhur me transaksionin e kryer me shoqërinë “{***}” ShPK të përshkruar më sipër, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar në Komision se si burim i shumës 20.000 euro, paguar për llogari dhe më pas kthyer nga kjo shoqëri, kanë qenë 11.000 euro të dhëna nga babai dhe 9.000 euro nga dy kreditë konsumatore të marra më datë 23.04.2008, në Bankën Tirana, nga subjekti në vlerën 4.000 euro, si dhe nga bashkëshortja në vlerën 5.000 euro, të cilat janë shlyer brenda vitit 2008, me burim paratë e dhëna nga prindërit e subjektit. Gjithashtu, ai ka shpjeguar në hetimin administrativ se nuk ka deklaruar në DPV-në 2008 as kontratën e sipërmarrjes dhe as transaksionet lidhur me pagesën e shumës prej 20.000 eurosh, duke qenë se kjo marrëveshje, si edhe pagesa për shoqërinë “{***}” ShPK, ishin revokuar brenda këtij viti kalendarik.
39. Në këto kushte, trupi gjykues vëren se qëndron konstatimi i Komisionit dhe i Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar kontratën me shoqërinë “{***}” ShPK, revokimin e saj, si dhe kthimin e shumës prej 20.000 eurosh në vitin 2008. Në këto rrethana, ai është ftuar të japë shpjegime rreth kësaj marrëdhënieje përgjatë hetimit administrativ, gjatë të cilit ka deklaruar se marrëveshja me shoqërinë “{***}” ShPK është prishur brenda vitit, në datën 10.10.2008, dhe më pas është lidhur marrëveshja me shoqërinë “{***}” ShPK, për porositjen e apartamentit që ai ka në pronësi aktualisht e në të cilin banon. Lidhur me burimin e krijimit të shumës 20.000 euro, rezulton se ajo është krijuar nëpërmjet dy kredive konsumatore të mara prej subjektit dhe bashkëshortes, si dhe 11.000 eurove të dhëna nga babai i tij. Subjekti ka shpjeguar se pas kthimit të këtyre shumave prej shoqërisë “{***}” ShPK, për shkak të revokimit të kontratës së sipërmarrjes, ai e ka përdorur këtë shumë si burim për blerjen e apartamentit që ka aktualisht në pronësi. Pavarësisht faktit se kjo marrëdhënie është krijuar dhe prishur brenda vitit 2008, pa krijuar pasoja juridike për subjektin e rivlerësimit në fund të këtij viti, dhe në këtë kuptim, subjekti nuk ka pasur detyrim ta deklarojë atë në DPV-në e vitit 2008, fakti që për pagesën e kryer për këtë shoqëri, në shumën prej 20.000 eurosh, kanë shërbyer edhe dy kredi konsumatore, të cilat janë marrë nga subjekti dhe janë shlyer prej tij brenda vitit kalendarik, para kohës së maturimit, me fonde të cilat në çdo version, nuk kanë qenë nga të ardhurat e subjektit, ka krijuar detyrimin për deklarim në DPV-në e atij viti. Një deklarim i tillë do të jepte qartësi se cilat kishin qenë burimet e financimit jashtë njësisë familjare, të cilat kishin mundësuar shlyerjen para kohe të këtyre kredive konsumatore, për më tepër që ato janë përdorur si burim për blerjen e pasurisë apartament nga shoqëria “{***}” ShPK, në të njëjtin vit, sipas

deklarimeve të subjektit në deklaratën *vetting*. Në këto kushte, mosdeklarimi i marrëdhënies me shoqërinë “{***}” ShPK, në DPV-në e vitit 2008, dhe transaksioneve që kanë shoqëruar atë, ndonëse lidhen me pasaktësi të deklaratës periodike, të cilat nuk mund të ngrihen në nivelin e një deklarimi të pasaktë sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, sërish ka krijuar premisa për vështirësinë/pamundësinë e verifikimit të burimeve të krijimit të pasurisë apartament në pronësi të subjektit, të deklaruar në deklaratën *vetting* e të vlerësuar përgjatë procesit të rivlerësimit.

40. Lidhur me verifikimin e burimit për shlyerjen e dy kredive konsumatore, në shumën totale 9.000 euro, të marra nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja në Bankën Tirana, në kushtet e mosdeklarimit të marrjes, të shlyerjes së parakohshme të këtyre kredive dhe të burimit të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e tyre në DPV-në e vitit 2008, trupi gjykues iu referua deklarimeve që subjekti ka bërë për herë të parë për këto kredi në deklaratën *vetting*. Në këtë deklaratë, e cila është edhe objekti i kontrollit në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti rezulton se ka deklaruar përdorimin e shumatores së tyre, në vlerën prej 9.000 eurosh, si burim të financimit të apartamentit në pronësi të tij, të blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, dhe të shlyer para kohe me fonde të familjes së bashkëshortes së tij R. R. B.. Në ndryshim nga ky deklarim i bërë në deklaratën *vetting*, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka shpjeguar se shlyerja e kredive ka si burim shumën e kaluar me dhurim nga babai i tij dhe se deklarimi i bërë prej tij në deklaratën *vetting* për burimin që ka financuar shlyerjen e tyre të parakohshme, është një lapsus. Në mbështetje të këtij argumenti, subjekti ka sqaruar se, ashtu siç ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, shuma e dhuruar nga prindërit e tij është 57.000 euro, dhe saktësia aritmetike ($57.000 = 47.000 + 1.000 + 9.000$) është një e dhënë që duhet të bindë si për vlerën totale të shumës së dhuruar, ashtu edhe për faktin se shlyerja e dy kredive në vlerën 9.000 euro ka si burim pikërisht këtë shumë.
41. Gjendur në rrethanat e mësipërme të deklarimeve e shpjegimeve, Komisioni ka pranuar si të besueshëm shpjegimin e subjektit të rivlerësimit për një lapsus në deklaratën *vetting* lidhur me burimin që ka mundësuar shlyerjen e këtyre kredive, konkluzion i cili është kontestuar prej Komisionerit Publik. Trupi gjykues, në vlerësim të të dhënave të mësipërme, çmon se pretendimi i Komisionerit Publik i ngritur në ankim lidhur me këtë çështje, është i drejtë. ***Së pari***, konstatohet se subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting*, përdorimin e dy kredive konsumatore prej 9.000 eurosh, si një nga burimet e krijimit të pasurisë në pronësi të tij, krahas dhurimit të shumës prej 47.000 eurosh prej prindërve dhe shumës prej 30.000 eurosh të marrë kredi. Ky deklarim i tij, i dhënë nën përgjegjësinë e deklarimeve të vërteta në deklaratën *vetting*, si një mundësi dhe ftesë që iu bë të gjitha subjekteve të rivlerësimit për të paraqitur në mënyrë të detajuar e të plotë të gjitha të dhënat e kërkuara nga ligji lidhur me pasuritë e tyre në funksion të procesit të rivlerësimit, ka përcaktuar se shuma e dhuruar prej prindërve të tij për blerjen e apartamentit është në vlerën 47.000 euro, shumë e cila i ka kaluar subjektit nëpërmjet transaksionit bankar. Nëse prindërit do të kishin paguar edhe për shlyerjen e kredive

konsumatore, siç subjekti pretendon në hetim, atëherë shuma e dhuruar do të ishte 57.000 euro. Fakti që subjekti ka deklaruar shumën prej 57.000 eurosh si të dhuruar në DPV-në e vitit 2008, nuk vlerësohet nga trupi gjykues si një e dhënë që mbështet deklarin e subjektit, por përkundrazi, si një element që i shton konfuzion situatës lidhur me dy kredite konsumatore si burim të krijimit të pasurisë. Nëse do të pranohet kësaj version të subjektit, gjithsesi ai sërish do të ishte në kushtet e deklarin të pasaktë, përderisa shuma e deklaruar si e dhuruar në deklaratën *vetting*, është e ndryshme nga ajo që pretendohet në hetim dhe që është deklaruar në DPV-në e vitit 2008. **Së dyti**, edhe sikur të pranohet si i vërtetë pretendimi i subjektit se prindërit i kanë dhuruar 57.000 euro për blerjen e apartamentit, sërish kjo shumë do të shkonte për shoqërinë “{***}” ShPK, dhe jo për shlyerjen e kredive konsumatore të marra prej subjektit e bashkëshortes së tij, fakt që evidenton sërish nevojën e verifikimit të burimeve të përdorura për shlyerjen e parakohshme të këtyre kredive. **Së treti**, edhe sikur të pranohet se deklarimi në deklaratën *vetting* se kredite janë shlyer me fonde të familjes së bashkëshortes së subjektit, është vetëm një deklarin i pasaktë/lapsus, sërish ai nuk mund të konsiderohet pa peshë në këtë proces, për sa kohë ai modifikon tërësisht burimin e ligjshëm që duhet të verifikohet sipas deklarimeve në deklaratën *vetting*, nga të ardhurat e familjes së bashkëshortes së tij. Arsyetimi që bën Komisioni se subjekti në çdo rast ka pasur vetë të ardhura për ta përballuar shlyerjen e këtyre kredive, ndërsa ai vetë nuk e pretendon këtë fakt, duket se deformon realitetin jetësor të pretenduar prej vetë subjektit e të bërë pjesë e deklarimeve të tij.

42. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se mungesa e deklarimeve në DPV-në e vitit 2008 lidhur me marrëveshjen e revokuar dhe transaksionet respektive me shoqërinë “{***}” ShPK, si edhe deklarimet e pasakta dhe kontradiktore të subjektit mbi burimin financiar që ka shërbyer për shlyerjen e parakohshme të kredive në shumën totale 9.000 euro, si një ndër burimet e krijimit të pasurisë në pronësi të tij, çojnë në pamundësi për të verifikuar se cilat nga deklarimet e subjektit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me burimin e të ardhurave për shlyerjen e kësaj shume.
43. Në përfundim, për pasurinë apartament me sipërfaqe 96,5 m², trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë të burimit të shlyerjes së dy kredive konsumatore të marra prej tij në vitin 2008, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, pasaktësi e cila, për shkak të identifikimit të një burimi tjetër financimi përgjatë hetimit administrativ, ka pamundësuar kontrollin e të ardhurave të ligjshme të përdorura për shlyerjen e parakohshme të kredive.
44. Për pasurinë **automjet tip “Daimler Chrysler”, E270 CDI**, blerë në Gjermani nga subjekti i rivlerësimit më datë 13.4.2007, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: (i) nga hetimi administrativ, nuk rezultoi që subjekti të ketë përdorur apo përfituar të ardhura nga shitja e këtij automjeti; (ii) vlera e blerjes së automjetit, së bashku me të gjitha taksat dhe detyrimet doganore mbi çmimin e blerjes së tij, përbëjnë shumën totale të dhënë nga shtetasi I.V. sipas

deklaratës noteriale; (iii) konfirmohet fakti se i njëjti noter ka hartuar dhe nënshkruar aktet noteriale, përfshirë edhe deklaratën për dhënien e shumës 2.000.000 lekë subjektit për blerjen e automjetit, kontratën e shitjes në favor të shtetasit I. V. për shumën 500.000 lekë dhe se kjo vlerë e shënuar në kontratën e shitjes duket se nuk ka ndikuar në shmangien e ndonjë takse apo detyrimi doganor, pasi DPSHTRR-ja ka konfirmuar regjistrimin e automjetit në emër të shtetasit I.V. dhe njëkohësisht deklarata e këtij të fundit konfirmon marrëveshjet e bëra dhe në asnjë rast nuk rezulton të kenë lindur pretendime mes palëve, konkludon se në gjendjen faktike të kësaj çështjeje, përjashtohet çdo rrethanë përfituese nga subjekti, si shmangia nga ndonjë detyrim tatimor, për sa kohë pronari real i këtij automjeti është shtetasi I.V. Në të tilla kushte, nuk identifikohen fakte apo rrethana që mund të passillnin një vlerësim ndryshe për penalizimin e subjektit.

45. Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni dhe vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, pasi nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2007, blerjen, burimin e krijimit, shitjen dhe as të ardhurat e realizuara nga shitja e këtij automjeti. Ekzistenca e akteve noteriale me përshkrimin e të drejtave të subjektit mbi këtë pasuri tregon, në kuptim formal, deri në provimin e së kundërtës, se këto të drejta i përkasin pikërisht subjektit të rivlerësimit, prandaj ai kishte detyrimin, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, t'i deklaronte ato. Pretendimet e subjektit mbi konsiderimin si lapsus të shumës 500.000 lekë, të parashikuar në kontratën e shitjes, sipas Komisionerit Publik, mbeten në nivel deklarativ dhe duket se subjekti kërkon të provojë një fakt të ndryshëm nga përmbajtja e kontratës noteriale të shitblerjes së pasurisë së luajtshme. Deklarimet e subjektit bien ndesh me përmbajtjen e kontratës, ku referohet se palët nuk njihen dhe mbetet e paqartë marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me shtetasin I. V.. Në konkluzion, Komisioneri Publik vlerëson se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, në drejtim të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të përcjellë në lidhje me këtë pasuri të luajtshme, e bëjnë deklarin e subjektit të rivlerësimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
46. Nga aktet në fashikujt e hetimit administrativ të Komisionit, lidhur me këtë automjet, ndër të tjera, konstatohet se në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, më datë 27.04.2016, subjekti ka deklaruar se: *Në vitin 2007, kam blerë një automjet tip “Mercedes Benz”, në Gjermani, të cilin e kam sjellë në Shqipëri. Por sqaroj se të gjitha shpenzimet i ka mbuluar shtetasi I. V., sepse automjeti ishte i destinuar për të. Automjeti ka hyrë nga Murriqani dhe zhdoganimi është bërë nga ana ime sepse isha personi që e kisha blerë në Gjermani, pasi është bërë zhdoganimi është bërë edhe kontrata e shitjes me shtetasin I. V.. Pra, në të gjithë këtë transaksion, unë nuk kam pasur asnjë përfitim dhe nuk kam shpenzuar asnjë të ardhur pasi të gjitha veprimet janë kryer për interes të shtetasit I.V. dhe normalisht të gjitha shpenzimet janë mbuluar nga ai.*

47. Subjekti ka depozituar në Komision kontratën e shitblerjes së automjetit nr.{***}, datë 11.05.2007, me të cilën shtetasi Bledar Bejko i shet shtetasit I. V. automjetin tip “Daimler Chrysler”, me targa{***}, në vlerën 500.000 lekë, si dhe një deklaratë noteriale nr.{***}, datë 11.05.2007, të nënshkruar prej tij dhe prej blerësit, në të cilën ka deklaruar se ka marrë në datën 02.04.2007 nga z. I. V., shumën 2.000.000 lekë, si vlerë për blerjen e një automjeti tip “Mercedes Benz” në Gjermani. Nga dokumentacioni i depozituar në Komision nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, rezultoi se automjeti është blerë prej subjektit të rivlerësimit në Gjermani, më 13.04.2007, në vlerën 11.950 euro dhe se vlera totale e shpenzuar për këtë automjet (blerja + zhdoganimi) është 1.969.608 lekë (1.511.556 lekë + 458.052 lekë).
48. Trupi gjykues konstaton, nga aktet e administruara, se subjekti i rivlerësimit e ka pasur në pronësi këtë automjet për një periudhë gati njëmuajore (nga data 13.04.2007 deri në datën 11.05.2007, kur është bërë shitja sipas kontratës), dhe se në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, blerjen dhe shitjen e këtij automjeti, si dhe burimet e financimit për blerjen dhe të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit. Fakti që në kontratat respektive të blerjes dhe shitjes së këtij automjeti figurojnë çmime me diferencë të madhe, blerja në vlerën 1.969.608 lekë dhe shitja në vlerën prej 500.000 lekësh, ka përcaktuar nevojën e deklarimit në DPV-në e vitit 2007 të këtij transaksioni, me qëllim shpjegimin e kësaj difference, e cila në pikëpamje formale duket se ka prodhuar pakësim të pasurisë likuiditet të subjektit, për aq sa kontratat e regjistruara në DPShTRr, tregojnë. Mungesa e këtyre deklarimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit për këtë pasuri, e bën të vështirë provimin e pretendimeve të tij për burimin e të ardhurave për blerjen e automjetit dhe se midis tij dhe shtetasit I. V. ka pasur një marrëdhënie “porosie” për blerjen e automjetit, me shpenzime dhe vlerë të parapaguar nga ky shtetas.
49. Lidhur me mospërputhjet midis vlerës së blerjes dhe çmimit të shitjes në kontratat respektive, subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit në Komision është shprehur se është një lapsus i noterit dhe pakujdesi për ta korrigjuar shifrën në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes. Sipas subjektit të rivlerësimit, nga deklarata noteriale, por edhe nga dokumentacioni i automjetit, rezulton se kostoja e blerjes dhe zhdogimit të automjetit ishte 2.000.000 lekë dhe në kushtet kur është përpiluar deklarata noteriale pranë noterit, si autoritet publik, vërtetohet tej çdo dyshimi se shuma 500.000 lekë në kontratën e shitjes është gabim material. Trupi gjykues vëren se janë jobindëse shpjegimet e subjektit për një lapsus në përcaktimin e vlerës 500.000 lekë në kontratë, ndërkohë që në deklaratën noteriale të hartuar dhe nënshkruar në të njëjtën ditë me kontratën, tek i njëjti noter, palët kanë deklaruar marrjen e shumës 2.000.000 lekë. Gjithashtu, nga procesverbali i mbajtur në ILDKPKI më datë 27.04.2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dhënë sqarime lidhur me blerjen e këtij automjeti, si dhe ka dorëzuar kopje të kontratës së

shitjes së automjetit, por pa sqaruar/pretenduar ndonjë lapsus në çmimin e përcaktuar në këtë kontratë. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se mbeten jobindëse dhe të paprovuara argumentet që ai sjell lidhur me çmimin real të shitjes së automjetit dhe mospasqyrimin e tij në aktin e kontratës së shitjes. Këtij fakti i shtohen dhe deklaratimet kontradiktore të subjektit në deklaratën noteriale, si dhe gjatë hetimit në Komision për marrëdhënien që ka pasur me shtetasin I. V.. Në dy akte që nga ekstremitet tregojnë se janë hartuar në mënyrë të pashpjegueshme në vijim të njëri-tjetrit – kontrata e shitjes e më pas deklarata noteriale për dhënien e shumës prej 2.000.000 lekësh nga z. I. V. te subjekti i rivlerësimit – pasqyrohen dy fakte të ndryshme për sa i përket marrëdhënies së subjektit me z. V.. Në kontratën e shitjes është shënuar se palët nuk njihen mes tyre, si një fakt që zakonisht nuk gjen pasqyrim në të tilla kontrata, duke qenë se është pa relevancë lidhur me vullnetin për kalimin e pronësisë së sendit objekt i kontratës, ndërsa te deklarata e hartuar menjëherë pas shitjes, është pasqyruar deklarimi se blerësi i ka parapaguar shitësit, subjektit të rivlerësimit, të gjithë shumën e përdorur për blerjen dhe zhdoganimin e mjetit në vlerën prej 2.000.000 lekësh. Subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim të arsyeshëm për të gjitha këto kundërshti dhe mospërputhje të dhënash e faktesh, të cilat në mungesë të deklaratimeve në kohën e ndodhjes së transaksionit, krijojnë mungesë besueshmërie për faktet e deklaruara prej tij e pamundësi për të verifikuar plotësisht natyrën dhe të dhënat që përbëjnë këtë transaksion.

50. Në përfundim, për pasurinë automjet, tip “Daimler Chrysler”, E270 CDI, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit është jobindës në shpjegimet e tij lidhur me natyrën e transaksionit të kryer në vitin 2007 për blerjen dhe shitjen e kësaj pasurie. Ai nuk rezulton të ketë bërë deklaratime në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 për këtë pasuri të luajtshme të regjistrueshme në regjistrat publikë, e cila, më së paku formalisht, është fituar dhe tjetërsuar prej tij nëpërmjet veprimeve juridike të blerjes dhe shitjes së pasurisë e të pasqyruara në kontratat formale të shitjes. Kontradiktat në elementet e çmimit të këtij transaksioni, të evidentuara në kontratat respektive të shitjes dhe blerjes, në mungesë të deklaratimeve në kohën e kryerjes së transaksionit, mbeten elemente të cilat pasqyrojnë një problematikë që meriton të vlerësohet prej Kolegjit në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
51. Për pasurinë **automjet, tip “Mercedes Benz”, me targa belge, BE VZP**, Komisioni pasi ka hetuar në lidhje me deklarin e subjektit të rivlerësimit në pyetësonin standard për përdorimin e këtij automjeti, në analizë të shpjegimeve të subjektit, dokumentacionit të depozituar prej tij, si dhe dokumentacionit të administruar nga agjencitë ligjzbatuese, vërejt se provat e administruara nuk nxorën në pah ndonjë të dhënë që mund të cenonte ndonjë nga komponentët e kriterëve të vlerësimit të subjektit të rivlerësimit.
52. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, vlerëson se duket se rezultojnë disa rrethana të mbështetura nga aktet në dosje, të cilat, të analizuara së bashku, më së paku, ndikojnë në perceptimin negativ të publikut mbi përgjegjshmërinë dhe seriozitetin e subjektit të

rivlerësimit. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të interesave vjetorë të vitit 2008, blerjen e kësaj pasurie të luajtshme, vlerën dhe as burimin e krijimit të kësaj shume. Komisioneri vlerëson se rrethanat e rezultuara nga hetimi administrativ mbi këtë pasuri/mjet, deklarimet kontradiktore, çështjet e pahetuara mbi rrethanat e vjedhjes së mjetit, shtetasit e përfshirë në transaksionin e blerjes, të cilat mbeten në nivel deklarativ, mungesa e arsytimit ligjor në vendimin e pushimit të procedimit penal nr. {***}, shfaqin qasje të pakujdesshme të subjektit të rivlerësimit, dhe janë elemente të cilat duhen vlerësuar nga Kolegji, në drejtim të parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në referencë të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

53. Në shqyrtim të konstatimeve të Komisionerit Publik, trupi gjykues, pas verifikimit të akteve në fashikuj, vëren se në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, dërguar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar: *Në vitin 2008 i kam marrë në përdorim për provë një makinë “Mercedes Benz”, një shtetasi të panjohur mirë nga unë, i quajtur N.. Takimi është bërë pranë {***}, Tiranë, në prani të shtetasit P. A.. Mjeti kishte targa belge, viti 1993 i modifikuar ‘95, i pazhdoganuar. Rreth 2-3 ditë më pas, konstatoj një mëngjes se ma kishin vjedhur poshtë shtëpisë. I kam bërë pagesë rreth 100.000 lekë këtij personi, pasi kjo ishte vlera e mjetit si i amortizuar, edhe pa targa. Nuk bëmë kontratë.* Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se nuk i kujtohej emri i saktë i personit të cilit i ka marrë mjetin, si dhe në momentin e marrjes së automjetit, por pa rol, ishte prezent shtetasi P. A.. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 6 të datës 14.01.2022, subjekti ka shpjeguar se shtetasin P. A. e ka njohur pasi e ka pyetur si deklarues në një procedim penal, të filluar me ankim, të regjistruar nga zv.drejtuasi i prokurorisë, për veprën penale “Vetëgjyqësia”. Me vendimin e subjektit të rivlerësimit, ky procedim është pushuar, vendimi iu është njoftuar palëve, të cilët nuk e kanë ankimuar. Bashkëlidhur pyetësorit, subjekti ka paraqitur vërtetimet nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, shoqëruar me aktet e procedimit penal numër{***}, të vitit 2006, si edhe dy vërtetime nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, ku është emëruar pas muajit dhjetor të vitit 2013, ku rezulton të mos ketë pasur asnjë procedim me shtetasit e mësipërm, dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, ku është emëruar pas muajit maj të vitit 2007, ku rezulton të mos ketë pasur asnjë procedim me shtetasin e mësipërm. Në procesverbalin e kallëzimit të subjektit të rivlerësimit për vjedhjen e automjetit, të datës 09.01.2008, dërguar Komisionit me shkresën nr. {***}prot., datë 17.03.2022, të Prokurorisë Tiranë, subjekti ka deklaruar se *mjetin e kam blerë për një milion lekë te një person që quhej N. [...] para tri ditësh dhe po e mbaja edhe për provë.* Në këtë procesverbal, subjekti ka deklaruar se i kishte vendosur automjetit dhe sistem alarmi e se e përdorte vetë, por edhe pjesëtarët e tjerë të familjes. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me shkresën nr. {***} prot., datë 01.12.2021, ka informuar Komisionin se nuk rezulton e regjistruar në sistemin TIMS hyrja e automjetit me targë {***}.

54. Nga të dhënat e rezultuara prej akteve të fashikullit të hetimit administrativ, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar rreth fitimit dhe humbjes së të drejtave mbi këtë automjet në DPV-në e vitit 2008. Referuar deklarimeve të tij në hetim, duket se ai ka lidhur një marrëveshje verbale me pronarin e mëparshëm të mjetit për blerjen e tij, si edhe ka paguar një shumë prej 100.000 lekësh si çmim apo pjesë e çmimit për këtë pasuri. Referuar shpjegimeve të tij, ai e ka konsideruar vjedhjen e këtij automjeti si një vjedhje që i është bërë pasurisë së tij dhe, në këtë kontekst, ai duhej të kishte deklaruar rreth gjendjes së të drejtave mbi këtë pasuri në DPV-në e vitit 2008, si vit në të cilin ai fitoi pronësinë mbi këtë send të luajtshëm. Për më tepër, nga aktet e fashikullit, në mungesë të deklarimeve në DPV-në e vitit 2008, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit është kontradiktor dhe i paqartë në shpjegimet e tij lidhur me pronësinë mbi automjetin, pasi në disa raste shprehet për marrje në përdorim për provë, në disa të tjera për blerje të automjetit, për të cilën pranon që nuk ka lidhur kontratë. Gjithashtu, është e paqartë si është dakordësuar dhe kryer pagesa prej 100.000 lekësh midis palëve, në mungesë të deklarimit që duhet të kishte bërë subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, për blerjen e kësaj pasurie të luajtshme, vlerën dhe burimin e krijimit të kësaj shume. Shpjegimet e subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 1, të cituara në paragrafin 53 më sipër, vijnë në kundërshtim me faktet që ai ka denoncuar në kallëzimin e bërë për vjedhjen e automjetit, në të cilin ai deklaroi se mjeti ka qenë në pronësi të tij dhe se i kishte vendosur atij një sistem alarmi, rrethanë që tregon se mjeti nuk ishte në kondicionet teknike, si i amortizuar, të cilat subjekti i deklaroi përgjatë hetimit administrativ. Një mjet i amortizuar, sipas një logjike të thjeshtë, nuk ka nevojë të sigurohet me një sistem alarmi kundër vjedhjes dhe as mund të jetë objekt tërheqës për t'u vjedhur. Këto kundërshti sugjerojnë për deklarime të pavërteta të subjektit për vlerën e automjetit, si dhe shtojnë argumentet rreth paqartësisë së marrëdhënies së subjektit me këtë automjet, shumën e paguar për blerjen e tij apo rrethanat në të cilat subjekti ka fituar pronësinë mbi të. Rezultojnë se janë jobindëse edhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbi marrëdhënien/njohjen me pronarin e mëparshëm të automjetit, si dhe me një nga personat që, sipas tij, ka qenë prezent në momentin e marrjes së automjetit, shtetasin P. A., i cili rezultoi i proceduar në çështjen penale nr. {***} të vitit 2006, për hetimin e së cilës ka qenë i ngarkuar vetë subjekti i rivlerësimit, shpjegime të cilat tregojnë një qasje të pakujdesshme të subjektit të rivlerësimit në marrëdhëniet me të tretët, në raport me statusin e tij. Për më tepër, nga shkresa e Ministrisë së Drejtësisë nr. {***} prot., datë 28.01.2022, kthim përgjigje Komisionit për gjendjen gjyqësore të shtetasit P. A., sipas informacioneve të disponuara nga autoritetet italiane dhe kosovare, rezultoi se ky shtetas ka qenë i përfshirë në aktivitetin kriminal të trafikimit të automjeteve, element që gjithashtu shton paqartësitë dhe cenon besueshmërinë e deklarimeve të subjektit rreth marrëdhënies me këtë pasuri dhe rrethanat e përfitimit të saj.

55. Për sa i përket konstatimit të Komisionerit Publik se nuk janë ndërmarrë veprime hetimore dhe nuk është hetuar për rrethanat e vjedhjes së mjetit⁴, trupi gjykues sjell në vëmendje se përgjegjësia për kryerjen e hetimeve lidhur me vjedhjen e automjetit i përket prokurorit të caktuar për hetimin e çështjes dhe jo subjektit të rivlerësimit, i cili në këtë rast ka qenë në rolin e denoncuesit.
56. Trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimin e Komisionerit Publik se ka mungesë të arsytimit ligjor në vendimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit për pushimin e procedimit penal nr. {***}, në ngarkim të shtetasit P. A.. Nga verifikimi i akteve të kësaj çështjeje penale, konstatohet se me vendimin e datës 19.05.2006, të zëvendësprokurorit të rrethit, është regjistruar procedimi penal nr. {***} për veprën penale “Vetëgjyqësia”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit P. A., si dhe për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive”, parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A. G., për hetimin e të cilit është ngarkuar subjekti i rivlerësimit. Me vendimin e datës 03.08.2006, subjekti i rivlerësimit ka vendosur: “Mbi pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2006”, mbështetur në nenin 328/1, shkronja “c”, dhe nenin 19 të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti i rivlerësimit, në këtë vendim ka arsyetuar se *nuk rezulton se shtetasi P. A. të ketë konsumuar elemente të kundërvajtjes penale të “Vetëgjyqësisë”, ndërsa për shtetasin A. G. ka arsyetuar se ka vepruar në kushtet e mbrojtjes së nevojshme*. Komisioneri Publik pretendon se nuk duket i arsyetuar pushimi i veprës penale “Vetëgjyqësi” për shtetasin P. A., ndërkohë që nga dy ekspertizat mjeko-ligjore, të administruara në dosjen e çështjes, të cilat u referohen dëmtimeve të marra nga shtetasit në konflikt, rezultojnë humbje e aftësisë së përkohshme për punë në masën 9 ditë pushim, për shtetasin E. G..
57. Nga vlerësimi i dy akteve të ekspertimit mjeko-ligjor, si dhe i vendimit të pushimit të çështjes penale, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar në tërësi provat e administruara në fashikullin e procedimit penal në fjalë, si dhe nuk ka arsyetuar në mënyrë të plotë dhe logjike shkaqet ligjore të pushimit të çështjes në ngarkim të shtetasit P. A.. Në vetë përmbajtjen e vendimit të pushimit, konstatohen rrethana faktike të cilat bien ndesh me konkluzionin e subjektit të rivlerësimit se shtetasi P. A. nuk ka vepruar dhe nuk ka konsumuar elemente të kundërvajtjes penale të vetëgjyqësisë, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Në vendimin e pushimit mungon arsyetimi se përse vepra penale e “Vetëgjyqësisë”, për të cilën ishte regjistruar procedimi penal në ngarkim të shtetasit P. A., nuk konkurron me veprën penale të “Plagosjes së lehtë me dashje”, për të cilën subjekti ka konkluduar se duhej të hetohej ky shtetas. Kjo mungesë arsyetimi shmang edhe analizën mbi faktin se hetimet për veprën penale

⁴ Komisioneri, në poshtëshënimin nr. 12 në ankim, shprehet: “Nga fashikulli, nuk rezultojnë të jenë ndërmarrë veprime hetimore për këtë kallëzim. Në lidhje me këtë konstatim, rezultojnë se Komisioni i ka kaluar barrë prove dhe kërkuar shpjegime dhe një subjekti tjetër rivlerësimi, z. H. M., që rezultojnë të ketë qenë në cilësinë e prokurorit të çështjes. Referojuni vendimit të publikuar në faqen zyrtare, nr. 539, datë 8.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, f. 41 e tij”.

të “Vetëgjyqjësish” ndiqen kryesisht. Në arsyetimin e vendimit të pushimit, por që përfaqëson njëkohësisht edhe vendimin për kualifikimin e veprave penale si “Plagosje e lehtë e kryer me dashje”, mungon analiza për rolin dhe cilësimin e sjelljes së personave të tjerë të përfshirë në konflikt ditën e ngjarjes, analizë që do të ndihmonte në kualifikimin e saktë të veprimeve të kundërligjshme të kryera. Për më tepër, kontradiktor dhe alogjik gjendet konkluzioni i prokurorit lidhur me zbatimin e nenit 19 të Kodit Penal, sipas të cilit përjashtohet nga përgjegjësia shtetasi A. G., duke qenë se është gjendur në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, pa përcaktuar se cilën vepër penale ai ka konsumuar në këto kushte dhe duke përdorur arsyetimin se ai ka vepruar në kushtet kur rrezikohej jeta e tij dhe e të tjerëve, ndërsa akuza ka konkluduar se e vetmja vepër që është kryer nga shtetasi P. A., është ajo e “Plagosjes së lehtë me dashje”. Për të gjitha argumentet e dhëna më lart, trupi gjykues e gjen të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik lidhur me këtë çështje.

58. Në përfundim, për pasurinë automjet tip "Mercedes Benz", me targa belge{***}, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi nga subjekti i rivlerësimit i transaksionit të blerjes së kësaj pasurie në deklaratën periodike të vitit 2008, në konsideratë të fakteve të tjera që kanë rezultuar nga hetimi e që tregojnë për një vlerësim të cekët të rrethanave në të cilat është kryer ky transaksion, qoftë në drejtim të personit të deklaruar si shitës, si një i panjohur prej subjektit apo të personit të deklaruar si prezent/dëshmitar/ndërmjetës në këtë transaksion dhe statusit të këtij të fundit, si i dyshuar në një procedim penal të pushuar prej subjektit me një vendim që duket se i mungon arsyetimi ligjor, krijojnë kushtet që Kolegji të trajtojë këtë problematikë në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Për transaksionet bankare të kryera nga personi i lidhur, znj. R. B. (R.)

59. Lidhur me transaksionet, depozitimet e kryera nga R. B. (R.) në llogaritë e babait të subjektit të rivlerësimit në Tirana Bank, Komisioni në vendim është shprehur: *Trupi gjykues, për këtë çështje, vlerëson se provat, rrethanat e konstatuara, dokumentacioni i depozituar, si dhe shpjegimet e subjektit duhen parë dhe konsideruar në harmoni me njëra-tjetrën. Më konkretisht, u vërejt se dokumentacioni i depozituar nga subjekti, si gjatë hetimit administrativ, por edhe pas kalimit të barrës së provës, vërteton përfitimin e të ardhurave të ligjshme të familjes së tij, në një masë të konsiderueshme, çka arrin të mbulojë shumën e depozituar nga ana e bashkëjetueses së tij. Në këtë drejtim, trupi gjykues ka konstatuar se analiza financiare e familjes së origjinës së subjektit, e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, në çdo alternativë të mundshme, rezulton pozitive. Nga ana tjetër, vlen të evidentohet fakti se në asnjë rast nuk u konstatua ndonjë tërheqje apo veprim/transaksion tjetër nga bashkëjetuesja e subjektit në llogarinë e babait të tij, çka tregon se ajo nuk ka pasur asnjë të drejtë tjetër në llogarinë e tij, përveçse depozitimit. Po ashtu, konstatohet se depozitimet e kryera përputhen me periudhat më impenjative të babait të subjektit si pedagog, konkretisht, shkurt, mars, qershor, shtator, periudhë kjo që korrespondon me sezon provimesh në universitet, hartim tezash etj. Në*

konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të këtyre transaksioneve.

60. Komisioneri Publik, duke i konsideruar të mjaftueshme gjetjet e referuara në shkaqet e tjera të ankimit për të arritur një konkluzion mbi nivelin e besueshmërisë të subjektit të rivlerësimit, në vlerësimin e pasurisë, paraqet para Kolegjit dhe disa rrethana, të cilat, në vlerësimin e tij, paraqesin elemente që mund të merren në konsideratë nga Kolegji, në vlerësimin tërësor të procedurave lidhur me kriterin e pasurisë, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik, pasi analizoi aktet e administruara në dosjen e Komisionit, lidhur me këto transaksione, në raport dhe me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe pas kalimit të barrës së provës, vëren se disa prej këtyre transaksioneve, për të cilat është pyetur subjekti, janë kryer gjatë vitit 2010, pas martesës ligjore të subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten. Konkretisht: (i) në datën 26.02.2010, është depozituar *cash* në llogarinë e personit të lidhur, znj. R. R., në Tirana Bank, shuma 9.000 euro. Kjo shumë është tërhequr po *cash* në datën 8.03.2010; (ii) në datën 31.08.2010, është depozituar *cash* në llogarinë e personit të lidhur, znj. R. B., pranë Tirana Bank, shuma 1.095.000 lekë, e cila është tërhequr një ditë më pas. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, si dhe në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 27.04.2016, ka deklaruar se burimi i këtyre shumave janë kursimet e familjes së bashkëshortes. Nga analizimi në tërësi i transaksioneve të kryera në llogaritë bankare të bashkëshortes së subjektit dhe babait të subjektit të rivlerësimit, duket se, më së paku, depozitimi i këtyre shumave në llogarinë e personit të lidhur, në Tirana Bank, korrespondon me tërheqjen e të njëjtave shuma, në të njëjtën datë, nga llogaria bankare e babait të subjektit, në Union Bank, çka bie ndesh me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ.
61. Trupi gjykues konstaton se lidhur me këtë shkak ankimi, Komisioneri nuk ka pretenduar për një pasojë direkte lidhur me deklaratimet e subjektit për këto transaksione bankare, por i kërkon Kolegjit që të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të procedurave lidhur me kriterin e pasurisë sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësim të shkaqeve të tjera lidhur me: (i) burimet e përdorura për shlyerjen e huasë prej 9.000 eurosh, si burim i deklaruar për pasurinë apartament me sipërfaqe 96,5 m², blerë te “{***}”; (ii) automjetin e përdorur me targa belge në vitin 2008.
62. Për sa u përket rrethanave që sjell në vëmendje Komisioneri Publik, nga aktet konstatohet se lidhur me veprimet, depozitime dhe tërheqje në llogaritë bankare në Tirana Bank të bashkëshortes, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *Veprimet janë të gjitha në llogaritë e saj. Duke qenë se ka punuar në bankë, i ka pasur të lehta veprimet e depozitimeve dhe tërheqjeve. Në llogaritë e saj ka kryer veprime si për vete, dhe për anëtarët e familjes, duke lehtësuar ata për veprimet e tyre në bankë. Burimi i krijimit të arkëtimit të kryera janë nga pagat dhe të ardhurat e familjarëve të saj. Në periudha të caktuara kohore, llogaria ka qenë e përbashkët me prindërit dhe motrën e saj. Theksoj se znj. R. B. është bërë*

person i lidhur me mua pas lidhjes së martesës në datën 26.01.2010. Vlerësoj se përpara kësaj date, ajo nuk ka pasur detyrimin të justifikojë burimin e ligjshëm të lëvizjeve në llogarinë e saj. Për veprimet në llogari të bashkëshortes nga viti 2010 deri në vitin 2016, ne i kemi raportuar në deklaratimet vjetore.

63. Sipas procesverbalit të ILDKPKI-së të datës 27.04.2016, dërguar Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 06.10.2020, subjekti i pyetur nga ILDKPKI lidhur me depozitimin e shumës cash prej 1.095.000 lekësh dhe tërhequr më datë 1.09.2010 për të shpjeguar burimin dhe destinacionin e saj, ka sqaruar se: *Kjo shumë ka pasur si burim kursimet personale të prindërve të b/shortes sime në vite dhe këto veprime i ka bërë b/shortja ime, për arsye se ata i kanë pasur të pamundur veprimet bankare për shkak të moshës dhe gjendjes së tyre shëndetësore. Për sa i përket veprimit, nuk kam dijeni se përse është bërë, mund të them vetëm që ajo shumë nuk ka qenë e imja ose e bashkëshortes sime. Gjithashtu, subjekti ka shtuar në këtë procesverbal se: Dua të qartësoj se te llogaria e bashkëshortes sime në Tirana Bank, që prej hapjes së kësaj depozite kur bashkëshortja ime ka qenë vajzë e në vitet në vijim edhe pas martese, në llogarinë e saj janë kryer veprime nga prindërit për efekt të moshës dhe të praktikitetit, por edhe nga vëllai edhe motra e saj, ashtu si ju del edhe juve nga verifikimi i kryer. Pra, kanë qenë veprime praktikiteti për familjen e saj.*
64. Sipas akteve në fashikujt e Komisionit lidhur me këto transaksione specifike, rezulton se:
- (i) Në lëvizjet e llogarisë bankare të znj. R. B., me nr. {***}, në Bankën Tirana, është bërë depozitimi i shumës 9.000 euro, më 26.02.2010, me përshkrim: “Depozitë në arkë, M. R.⁵”, dhe më datë 08.03.2010, tërheqja e kësaj shume me përshkrimin: “Tërheqje, M. R., pass. nr. {***}”.
 - (ii) Në lëvizjet e llogarisë bankare të znj. R. B., me nr. {***}, në Bankën Tirana, është kryer depozitimi i shumës 1.095.000 lekë, më 31.08.2010, me përshkrim: “R. R.”, dhe më datë 01.09.2010, tërheqja e shumës 1.100.000 lekë, me përshkrimin: “R. R.”.
65. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit në Komision ka dhënë shpjegime lidhur me transaksionet bankare të kryera në llogarinë bankare të bashkëshortes, duke sqaruar se kjo llogari është përdorur për veprime të kryera nga familjarët, por pa specifikuar për secilin transaksion. Duke qenë se këto transaksione bankare janë kryer brenda vitit dhe nuk rezulton që të kenë shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie të subjektit, subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur me të nuk kanë pasur detyrimin dhe nuk kanë bërë deklaratime në deklaratën periodike vjetore të vitit përkatës, sipas parashikimeve të legjislacionit të kohës. Gjithashtu, për sa i përket konstatimit të Komisionerit Publik për korrespondimin e shumave të tërhequra nga babai i subjektit nga llogaritë e tij bankare, me ato të depozituara në llogarinë e bashkëshortes, trupi gjykues vëren se Komisioneri, me përjashtim të korrespondimit të datave, nuk sjell asnjë të dhënë tjetër që do të indikonte se këto veprime janë kryer në interes të subjektit të rivlerësimit

⁵ Motra e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

apo me synimin e fshehjes së ndonjë veprimi financiar që afekton vlerësimin e pasurisë së tij. Në përfundim, lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues nuk gjen elemente të mjaftueshme dhe relevante për të arritur në një konkluzion dhe për të vlerësuar për sa pretendon Komisioneri Publik në raport me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e figurës dhe gjetjet në raportin e DSIK-së

66. DSIK-ja, pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, ka përcjellë raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, në të cilin informohet se: [...] *Gjatë periudhës në të cilën z. Bejko ushtronte detyrën si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive ***** [...] Në përfundim, grupi i punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës, në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Bledar S. Bejko [...].*
67. Komisioni, në përfundim të verifikimeve lidhur me vlerësimin e figurës, ka konkluduar se [...] *të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së nuk provojnë implikimin e subjektit të rivlerësimit në veprime të paligjshme me natyrë korruptive, ndikim të paligjshëm apo kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar (në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë).*
68. Komisioneri Publik, bazuar në raportin e DSIK-së, parashton në ankim se lidhur me procedimin penal nr. {***}, ndryshe nga qëndrimi i mbajtur nga Komisioni, çështjet e referuara në këtë dokument, që ngrenë dyshime për përfshirje në veprime korruptive, paraqesin rrethana të ndryshme nga ato të verifikimit të aftësive profesionale të subjektit. Në këtë kontekst, në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit⁶, është e pamundur që në kuadër të vlerësimit të

⁶ *Vendimi nr. 20/2020 (JR) i Kolegjit, prg. 34.3: “[...] Kolegji vlerëson se, pavarësisht se u është dhënë përgjigje të gjitha shkaqeve të ngritura nga subjekti në ankim, këto procedime penale janë marrë në shqyrtim nga Komisioni në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës, por duke analizuar aftësitë profesionale të subjektit, pasi në raportin e DSIK-së rezulton se disponohen të dhëna, nga ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive në disa çështje penale, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në këtë kontekst, është e pamundur që, në kuadër të vlerësimit të figurës, të zbatohen standardet e kontrollit të aftësive profesionale, pasi burimet mbi të cilat merren informacionet për kontrollin e këtyre kriterëve të rivlerësimit, janë të ndryshme, gjithashtu i ndryshëm është edhe objekti i kontrollit. Në nenin 71 të ligjit nr. 96/2016 përcaktohen kriteret, mbi të cilat kryhet vlerësimi profesional, të cilat janë: aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë organizative; etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Në këtë këndvështrim, në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës, e cila ka standarde të posaçme të kontrollit sipas nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të aplikohen standardet e kontrollit të kriterit të aftësive profesionale [...]”.*

figurës, të zbatohen standardet e kontrollit të aftësive profesionale. Në përfundim, për kontrollin e figurës, Komisioneri Publik vlerëson se nga të dhënat e administruara si rezultat i informacioneve të organeve ligjzbatuese, duket se rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuara së bashku me rezultatet e tjera të hetimit, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

69. Trupi gjykues, nga verifikimi i akteve, konstaton se Komisioni, në vijim të informacioneve të DSIK-së, si dhe pas denoncimeve të përsëritura të shtetasës V. A., ka administruar fashikullin që i përket procedimit penal nr. {***}, datë 12.04.2017, në ngarkim të të pandehurit K. E., akuzuar për veprën penale “Vrasje nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal.
70. Nga aktet e administruara në Komision, konstatohet se shtetasja V. A. ka paraqitur kallëzimin penal, regjistruar me nr. {***}, viti 2017, duke pretenduar se nga subjekti i rivlerësimit është konsumuar vepra penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, e parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Referuar informacionit të dërguar Komisionit nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. {***} prot., datë 1.12.2020, rezulton se në ngarkim të shtetasit Bledar Bejko nuk rezulton të jetë regjistruar procedim penal, konfirmuar kjo nga verifikimi i bërë në regjistrat e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë për Krime të Rënda dhe SPAK-ut, dhe se për çështjen penale nr. {***} është vendosur mosfillimi i procedimit penal, pasi pretendimet e paraqitura në kallëzim nuk përmbajnë elementet e veprës penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Po për këtë çështje penale, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka informuar Komisionin, me shkresën nr. {***} prot., datë 29.12.2021, se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar kallëzimi nr. {***}, viti 2019, nga Ish-Prokuroria e Krimeve të Rënda Tiranë dhe se pas kryerjes së verifikimeve lidhur me këtë kallëzim, është regjistruar procedimi penal nr. {***}, i vitit 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”. Me vendimin nr. {***}, datë 20.10.2020, Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, mbështetur mbi kërkesën e prokurorit të çështjes, ka vendosur pushimin e saj.
71. Në vlerësim të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues vëren se nga raporti i DSIK-së, nuk rezulton të ketë informacion dhe të dhëna konkrete për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që formulari i kontrollit të figurës nuk është i plotë dhe i besueshëm, sipas përcaktimeve të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 38 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me standardet dhe procedurat e kontrollit të figurës. Në këto rrethana, në vlerësimin e këtij shkakut ankimi, trupi gjykues mban në konsideratë dhe qëndrimin e Kolegjit të mbajtur në disa vendime të tij, në të cilat është

shprehur se: [...] rastet e referuara në raportin e DSIK-së, që ngrenë dyshime për korrupsion, në mungesë të provave apo hetimit nga ana e Komisionit, në funksion të përcaktimit të ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme në dritën e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk përmbajnë elemente të qenësishme që të cilësohen me ndikim në vlerësimin e kriterit për kontrollin figurës. Këto janë elemente që ngushtësisht lidhen me komponentë të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale dhe që më së shumti afektojnë cenimin e besimit të publikut te drejtësia⁷.

72. Në vlerësim të sa më sipër, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, nga aktet në dispozicion, si dhe nga raporti i DSIK-së, trupi gjykues konfirmon qëndrimin e mbajtur nga Komisioni se nuk provohet që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo se ka rrethana të tilla që do të kualifikonin subjektin e rivlerësimit si të papërshtatshëm për kriterin e kontrollit të figurës, në kuptim të parashikimeve të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 38 e 39 të ligjit nr. 84/2016.
73. Pavarësisht sa konkludon më sipër, trupi gjykues, për t'i dhënë përgjigje shkakut të ankimit të Komisionerit Publik, çmon të analizojë ekzistencën e disa rrethanave që përftohen nga verifikimi i akteve dhe hetimi i bërë brenda kriterit të figurës, të cilat vlerësohen me interes, se mund të japin informacione rreth indikatorëve të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit. Konkretisht, Komisioneri Publik parashtron në ankim se gjatë procedimit penal nr. {***}, subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë kryer njoftim mbi vendimin e pushimit të hetimit për një nga të dyshuarit për kryerjen e veprës penale, shtetasin K. E., sipas parashikimeve ligjore, duke u mohuar palëve të drejtën për ushtrimin e ankimit. Mosushtrimi i ankimit nga palët e interesuara, për shkak të mosnjoftimit të tyre, ka sjellë si pasojë barazimin me vendimin e pafajësisë për të akuzuarin. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin dhe përgjegjësinë ligjore të njoftonte shtetasen V. A., e cila ishte më shumë se në cilësinë e personit të interesuar, pasi ajo ka qenë e pranishme në konfliktin me të dyshuarit, ku si pasojë ka humbur jetën bashkëshorti i saj.
74. Trupi gjykues vëren se Komisioni, pasi ka trajtuar denoncimin e shtetasës V. A. në kuadër të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, ka konstatuar se në kohën kur është dhënë vendimi i pushimit, në datën 11.07.2017, nuk kishte hyrë në fuqi ligji nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë””, dhe nuk njiheshin trashëgimtarët si subjekte procedurale. Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se në tërësi, nga të dhënat e rezultuara, nga komunikimet, si dhe nga vendimet e gjykatave, duket se ankuesja ka marrë dijeni për vendimin e pushimit. Në përfundim, Komisioni, pas një hetimi në raport me legjislacionin, veprimtarinë e subjektit

⁷ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 1/2020, datë 15.01.2020, paragrafët nr. 66, 68; nr. 6/2020, datë 18.06.2020, paragrafi nr. 43.6, nr. 20/2020, paragrafi nr. 34.5.

të rivlerësimit në këtë çështje, vendimet e dhëna nga gjykatat ndaj subjektit lidhur me kallëzimet e bëra nga shtetasja V. A., përfshirë edhe statusin ligjor të vendimmarrjes, i kontrolluar nga një gjykatë më e lartë, ka konkluduar se lidhur me procedimin penal nr. {***}, nuk konstatohen problematika që ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

75. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e datës 10.05.2023 të paraqitura në Kolegj ka parashtruar se pavarësisht diskutimit nëse në rastin konkret trashëgimtari i viktimës ka qenë apo jo subjekt procedural, rezulton e provuar se kallëzuesja V. A. ka marrë në dorëzim vendimin e pushimit dhe të gjitha aktet e dosjes. Subjekti vlerëson se njoftimi i vendimit është detyrë e sekretarisë dhe mungesa e aktit formal që provon marrjen dijeni për vendimin e pushimit, nuk mund të hedhë poshtë faktin e vërtetuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se ankuesja është njohur me vendimin e prokurorit.
76. Në shqyrtim të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstaton nga aktet në fashikujt e Komisionit, se procedimi penal nr. {***}, të cilit i referohet denoncuesja, është regjistruar në datën 12.4.2017, në ngarkim të të pandehurve K. E. dhe K. E., për veprën penale “Vrasje, e kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 76-25 të Kodit Penal. Këta dy shtetas, në datën 11.4.2017, janë përfshirë në një konflikt fizik, duke goditur me grushte dhe me mjete të forta shtetasin A. A. (bashkëshorti i denoncueses). Si rezultat i dhunës fizike, ky shtetas ka mbetur i dëmtuar rëndë dhe ka gjetur vdekjen në vend. Subjekti i rivlerësimit, në datën 13.04.2017, ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës, caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, ndaj të pandehurve, pasi ishin verifikuar kushtet dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për caktim të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues ndaj tyre, parashikuar në nenet 228, 229, 230, 238 dhe 258 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimet nr. {****} dhe nr. {***} , datë 15.4.2017, ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin e dy shtetasve K. E. dhe K. E.. Pas hetimit për një periudhë 3-mujore të të dy shtetasve të mësipërm, si autorë të dyshuar të kryerjes së veprës penale “Vrasje e kryer me dashje në bashkëpunim”, subjekti i rivlerësimit, në datën 11.07.2017, në cilësinë e prokurorit të çështjes, duke arsyetuar, ndër të tjera, se: [...] duke mbajtur parasysh rrethanat e faktit, konstatohet se nuk ka asnjë provë që të provojë, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se i dyshuari K. E. të ketë konsumuar figurën e veprës penale për të cilën dyshohet. Në këto kushte, akuza ndaj tij mbetet në kuadrin e dyshimit, për sa kohë që nuk rezulton asnjë provë tjetër për të vërtetuar këtë dhe, në këtë rast, dyshimi shkon në favor të të pandehurit [...], ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të të pandehurit K. E., shuarjen e masës së sigurimit personal “Arrest me burg” dhe lirim të menjëhershëm të tij. Më datë 10.7.2017, subjekti i rivlerësimit i ka njoftuar shtetasit tjetër, K. E., akuzën për veprën penale “Vrasje nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal dhe ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq, duke arsyetuar se: [...] Nga tërësia e akteve hetimore të çështjes penale të mësipërme, janë kryer të gjitha veprimet procedurale të nevojshme dhe janë mbledhur prova që tregojnë fajësinë e të pandehurit për veprën penale që është akuzuar [...].

77. Trupi gjykues, pas verifikimit të vendimit të pushimit të hetimeve, të datës 11.07.2017, për të dyshuarin K. E., në drejtim të kontrollit të tij sipas shkakut të ankimit të Komisionerit Publik, konstaton se në pjesën urdhëruese të vendimit, prokurori është shprehur: “Me këtë vendim të njoh personat e interesuar”. Nuk rezulton nga aktet që ky vendim t’u jetë njoftuar personave të interesuar, në këtë rast bashkëshortes së viktimës. Subjekti i rivlerësimit, por edhe Komisioni kanë arsyetuar lidhur me këtë moment se bashkëshortja e viktimës, me cilësinë e trashëgimtares, nuk legjitimohej në kohën e marrjes së këtij vendimi, sipas dispozitave procedurale penale, të njoftohej për një vendim të tillë, të drejtë që e fitoi vetëm pas ndryshimeve që pësoi Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues ndan një qëndrim të ndryshëm. Neni 58 i Kodit të Procedurës Penale⁸ para ndryshimeve parashikonte një pozitë të njëjtë të të dëmtuarit nga vepra penale me trashëgimtarët e viktimës, kur i dëmtuari i drejtpërdrejtë nuk jetonte më. Sipas kësaj dispozite, qoftë i dëmtuari, qoftë trashëgimtarët kishin të drejtë të kërkonin procedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit. Sipas pikës tre të kësaj dispozite, i dëmtuari kishte të drejtë të ankimonte në gjykatë vendimet e prokurorit që refuzonin kërkesat e tij, dhe ndonëse në këtë paragraf nuk parashikohet shprehimisht trashëgimtari, ai duhet lexuar në harmoni me paragrafin e parë të po së njëjtës dispozite, i cili jep të njëjtat të drejta për të dëmtuarin dhe trashëgimtarët për të kërkuar procedimin e fajtorit. Sipas një interpretimi teleologjik të dispozitës, trupi gjykues pajtohet me konkluzionin se trashëgimtari dhe i dëmtuari gëzonin të njëjtat të drejta procedurale në drejtim të mbrojtjes së interesave të shkelura prej veprës penale. Kur i dëmtuari jetonte, ai i ushtronte ato drejtpërdrejt dhe, kur ai nuk jetonte më, trashëgimtarët e tij gëzonin po të njëjtat të drejta. Në këtë kuptim, parashikimi i nenit 329, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, para ndryshimeve të vitit 2017, se: Kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri, interpretohet prej trupit gjykues se garanton të drejtën edhe të trashëgimtarit, për t’u ankuar ndaj një vendimi pushimi, kur i dëmtuari prej veprës ka humbur jetën dhe ankimi lidhet me të drejtën e trashëgimtarit për të kërkuar procedimin e fajtorit, siç neni 58, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale parashikon.
78. Gjithashtu, sillet në vëmendje se me ndryshimet e pritshme në Kodin e Procedurës Penale, të konsultuara gjerësisht e të miratuara në muajin mars të vitit 2017, pra shumë kohë para marrjes së këtij vendimi dhe që hynë në fuqi vetëm disa ditë pas marrjes së tij⁹, trashëgimtarët ligjorë të

⁸ *Personi i dëmtuar nga veprat penale ose trashëgimtarët e tij, kanë të drejtë të kërkojnë procedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit. [...] 3. I dëmtuari ka të drejtë të parashtojë kërkesa në organin procedues dhe të kërkojë marrjen e provave. Kur kërkesa e tij nuk pranohet nga prokurori, ai ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja dijani.*

⁹ *Vendimi për pushimin e procedimit penal është marrë në datën 11.07.2017, ndërkohë që ligji nr. 35/2017 ka hyrë në fuqi më datë 1 gusht 2017. Pas ndryshimeve, neni 58, pika 4 e Kodit të Procedurës Penale parashikon se: “Trashëgimtarët e viktimës kanë të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “j” të paragrafit 1 të këtij neni”. Neni 328, pika 2 e K.Pr.Penale parashikon se: “Prokurori, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të pushimit, njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe*

viktimës parashikoheshin shprehimisht si subjekte procedurale, të cilave duhej t'u njoftohen aktet procedurale¹⁰, duke dhënë qartësi në këtë mënyrë për të drejtat që ata gëzonin në procedimin penal. Në kuadër të ndryshimeve të pritshme ligjore, si dhe duke pasur në konsideratë dhe rolin aktiv që bashkëshortja e viktimës ka pasur në procesin e hetimit, edhe si dëshmitare e ngjarjes, subjekti i rivlerësimit ka pasur përgjegjësinë që ta njoftonte atë lidhur me vendimmarrjen e tij, për pushimin e akuzës dhe të çështjes së një prej të dyshuarve për ngjarjen e ndodhur, vendimmarrje e cila afektonte edhe cilësimin ligjor të veprës penale, për shkak të rënies së bashkëpunimit si një nga rrethanat rënduese, të konsideruara deri në atë moment prej prokurorit të çështjes.

79. Trupi gjykues sjell në vëmendje se në dispozitat procedurale penale, parashikohet se njoftimi i akteve të prokurorit kryhet nga policia gjyqësore dhe sekretaria, por është detyrë e prokurorit të ndjekë zbatimin e urdhërimit për njoftimin e palëve, si dhe të orientojë për kryerjen e veprimeve të nevojshme. Në rastin konkret, pretendimi i ngritur në procesin gjyqësor të zhvilluar në Kolegj prej subjektit, se sekretaria gjyqësore kishte detyrimin të njoftonte vendimin dhe jo prokurori, në këtë rast subjekti, vlerësohet prej trupit gjykues pa relevancë, për sa kohë që në vendimin e prokurorit është bërë shënimi: *Me këtë vendim të njoh të interesuarit*, pa u identifikuar se cilët ishin ata. Sekretaria gjyqësore ka për detyrë të zbatojë urdhërimet e prokurorit kur ato janë të qarta dhe të identifikueshme, ajo nuk mund të marrë një rol aktiv në identifikimin e shtetasve që kanë statusin e të interesuarit, sipas asaj që prokurori kishte disponuar në vendim. Për pasojë, pretendimi se kjo detyrë i takonte sekretarisë gjyqësore dhe jo subjektit të rivlerësimit, u konsiderua i pambështetur në ligj. Kjo mangësi procedurale në veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit u ka mohuar trashëgimtarëve të viktimës aksesin në organet e drejtësisë, për të realizuar mbrojtjen e interesave të ligjshëm në hapat e mëtejshëm proceduralë, duke i pamundësuar për të ushtruar të drejtën e ankimit dhe duke evituar në këtë mënyrë kontrollin e ligjshmërisë së akteve të prokurorisë. Kjo situatë bëhet dhe më e ndjeshme dhe me interes, në kushtet kur ajo ka ndodhur vetëm pak ditë para hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, të cilat detyrojnë prokurorin të paraqesë një kërkesë në gjykatë për të vendosur pushimin e akuzës dhe çështjes, për një të dyshuar ndaj të cilit zhvillohen hetimet. Marrja e vendimit, para hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve dhe mosnjoftimi i vendimit të pushimit trashëgimtares së viktimës kanë krijuar një terren në të cilin kjo vendimmarrje e subjektit ka mbetur e pakontrolluar nga kontrolli gjyqësor, ndonëse për një ngjarje me pasojë të rëndë e me sensibilitet të lartë për publikun, për vetë rrethanat e ndodhjes së saj.
80. Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se për këtë procedim penal, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e shkeljes së nenit 74, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, pasi njoftimi i

vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim, duke u bërë të ditur të drejtën për t'u njohur me aktet, për të marrë kopje të tyre dhe për të paraqitur ankim në gjykatë”.

vendimmarrjes së prokurorit, si veprimtari e rëndësishme e procedurave hetimore, duket se është cenuar. Ky konkluzion, i gjeneruar nga informacionet e referuara për shkak të kontrollit të figurës, ndonëse nuk provon dyshimet e ngritura në ato informacione, të marra në analizë edhe nga procedimi penal i kryer prej Prokurorisë së Posaçme Kundër Krimit të Organizuar e Korrupsionit për këtë rast, evidenton problematika të rëndësishme në ushtrimin e ndjekjes penale në çështjen në fjalë, të cilat vlerësohet se kanë mbetur jashtë kontrollit gjyqësor, të paktën për shkak të mangësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

81. Në konkluzion, për kriterin e kontrollit të figurës, në analizë të veprimeve procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me procedimin penal nr. {***} të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprën penale të vrasjes, të vendosura në kontekstin e informacioneve të administruara nga organet ndihmëse në procesin e kontrollit të figurës, sipas nenit 36 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në përfundimin se ndonëse nuk rezultojnë rrethana që çojnë në kualifikimin e subjektit si të papërshtatshëm në kuptim të këtij kriteri, gjenden mjaftueshëm elemente që tregojnë për ekzistencën e një vlerësimi me mangësi në kuadër të aftësive profesionale, të vlefshme për të krijuar premisat e duhura për një vlerësim të tyre sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit mbi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

82. Komisioni, pas analizimit të disa procedimeve penale, si dhe disa denoncimeve nga publiku, të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka vlerësuar se ato në tërësi, nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit. Në përfundim, Komisioni, pasi shqyrtoi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, konsiderohet “i aftë”.
83. Komisioneri Publik në ankim ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me gjetjet e konstatuara në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, duke parashtruar për shqyrtim para Kolegjit disa konstatime për disa procedime penale për ndjekjen e të cilave ka qenë i ngarkuar subjekti i rivlerësimit.
84. Komisioneri Publik parashtron se në procedimin penal nr. {***}, regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të punonjësve të policisë të dyshuar, komisar K. Xh. dhe nënkomisar Gj. A., subjekti i rivlerësimit ka kryer pjesërisht veprimet hetimore të udhëzuara nga drejtuesja e prokurorisë, si dhe ka ndryshuar kërkimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit Gj. A., nga arrest me burg, sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit, të datës 18.10.2017, në arrest në shtëpi, në seancën gjyqësore të datës

20.10.2017. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, vlerëson se në rastin konkret, duket se në aktet e hartuara nga subjekti i rivlerësimit, mungon arsyetimi ligjor mbi informacionet verifikuese të disponuara në mënyrë të shpejtë, të cilat, sipas subjektit të rivlerësimit, diktuan ndryshimin e kërkimit të masës së sigurimit personal nga “Arrest me burg” në “Arrest në shtëpi”, ndaj shtetasit Gj. A.. Gjithashtu, duket se mungon argumentimi i subjektit të rivlerësimit mbi trajtimin si të panevojshme të disa prej veprimeve hetimore të udhëzuara nga prokurori epror. Nga aktet e administruara, duket se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, të arsyetimit ligjor dhe cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik të prokurorit sipas parashikimeve të nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, dhe duhet të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

85. Lidhur me procedimin penal nr. {***}, nga aktet e fashikullit të çështjes të administruara nga Komisioni, rezulton se:

85.1. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 13.10.2017, duke regjistruar përkatësisht emrat e shtetasve Gj. A. dhe K. Xh., nën akuzën “Shpërdorim detyre”, mbi informacionin e përcjellë nga SHÇBA-ja se, në kundërshtim me ligjin, kanë përgatitur vërtetimin e besueshmërisë dhe përshtatshmërisë për shtetasin G. N., i cili është gjendur i pajisur me autorizim për mbajtjen e armës. Subjekti i rivlerësimit ka qenë prokurori i ngarkuar për këtë çështje.

85.2. Në datën 28.02.2018, drejtuesja e prokurorisë ka udhëzuar kryerjen e disa detyrave në hetimin ndaj këtyre dy personave, si: (i) kërkimin e dokumentacionit për të verifikuar nëse qëndronte pretendimi i shtetasit K. Xh. si epror, se nuk kishte nënshkruar vërtetimin e besueshmërisë për shkak se në periudhën e lëshimit kishte qenë në trajnim; (ii) ballafaqimin midis dy shtetasve, K. Xh. dhe Gj. A., nën pretendimin e shtetasit K. Xh. se vërtetimin mund ta ketë nënshkruar shtetasi Gj. A.; (iii) verifikimin e faktit se shtetasi G. N. ka ndryshuar emrin e tij dy herë përkatësisht, në vitet 2009 dhe 2010, dhe përse nuk është administruar certifikata në lidhje me ndryshimet e emrit dhe për këtë të ripyetet shtetasi Gj. A., ky i fundit të ripyetet edhe në lidhje me pretendimin për nënshkrimin në emër të shtetasit K. Xh.; (iv) kryerjen e ekspertimit teknik-grafik të shkrimit, nëse nënshkrimi në praktikë është i shtetasit K. Xh. ose jo; (v) kryerjen e verifikimit se si është caktuar shtetasi Gj. A. për ndjekjen e kësaj praktike, kur në kartelën shoqëruese është sigluar nga komisar K. Xh. një tjetër punonjës.

85.3. Nga subjekti i rivlerësimit si prokuror i çështjes janë kryer veprimet hetimore, lidhur me: (i) kryerjen e ekspertimit; (ii) administrimin e dokumentacionit/praktikës sa i përket ndjekjes së dhënies së vërtetimit të besueshmërisë për blerjen e armës së zjarrit. Në dosje është administruar edhe aktekspertimi, datë 23.03.2018, ku në konkluzion citohet se nënshkrimet nuk janë të shtetasit Gj. A..

85.4. Në kërkesën për vlerësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj të pandehurit Gj. A., drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, më datë 18.10.2017, subjekti i rivlerësimit, pasi ka vlerësuar si të ligjshëm ndalimin e bërë të hetuarit Gj. A., ka kërkuar vendosjen e masës së sigurimit “Arrest me burg”.

85.5. Në seancën gjyqësore të datës 20.10.2017, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”. Lidhur me ndryshimin e masës së kërkuar, në Komision, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *Sqaroj Komisionin se në seancën e vlerësimit të masës së sigurimit, kam kërkuar ndryshimin e masës së sigurimit nga “Arrest në burg” në “Arrest në shtëpi”, pasi masa “Arrest në burg” nuk u përgjigjej më nevojave të sigurimit. Mbi bazë të informacioneve verifikuese që u disponuan në mënyrë të shpejtë, në momentin që gjykata mori në shqyrtim kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, ra niveli i provueshmërisë së dyshimit të arsyeshëm mbi ekzistencën e faktit penal. Në këto kushte, çmova të ndryshoj qëndrimin duke kërkuar një masë sigurimi më të butë, kur si rrethana të tjera shërbyen edhe disa fakte të tjera të paraqitura në seancë, siç janë: ky shtetas ishte kryefamiljar, me fëmijë të sëmurë, bashkëshortja ishte e papunë, si dhe u paraqitën dokumente që provonin gjendjen e vështirë ekonomike. Vendimi im për të zbutur masën e sigurimit rezultoi i drejtë për shkak se në përfundim të hetimit, nuk u provua kryerja e ndonjë veprë penale dhe, për këtë arsye, kërkoja në gjykatë pushimin e çështjes, kërkesë e cila u pranua nga gjykata.*

85.6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 20.10.2017, ka vendosur vlerësimin të ligjshëm të ndalimit të shtetasit Gj. A., i dyshuar për kryerjen e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, dhe caktimin e masës shtrënguese “Arrest në shtëpi”. Mbi ankimin e të dyshuarit Gj. A., Gjykata e Apelit Durrës, më datë 02.11.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe caktimin e masës shtrënguese “Detyrim për paraqitje”.

85.7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. {***}, datë 14.5.2018, ka vendosur (sipas kërkesës së organit të akuzës) pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***}, në ngarkim të shtetasve të akuzuar për veprën penale “Shpërdorim detyre”, vendim ndaj të cilit nuk është ushtruar ankim.

85.8. Lidhur me moskryerjen e disa veprimeve hetimore të lëna detyrë nga drejtuesja e prokurorisë, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në përgjigje të rezultateve të hetimit në Komision se: *Lidhur me detyrat e lëna nga eprori, si ripyetje e shtetasit Gj. A. dhe ballafaqim i dy punonjësve të policisë, kryerja e tyre është parë si e panevojshme. Bazuar në ndryshimet ligjore të Kodit të Procedurës Penale, udhëzimet e drejtuesit të prokurorisë nuk janë detyruese. Është në vlerësim të prokurorit të çështjes të çmojë përfundimisht kryerjen ose jo të këtyre detyrave. Kam vlerësuar se nga aktet e administruara, rrethanat e faktit ishin të qarta dhe ripyetja apo ballafaqimi i personave ishte i panevojshëm, për shkak se të gjitha faktet ishin*

sqaruar. Vlerësimi im në lidhje me moskryerjen e veprimeve hetimore nga Drejtuesi i Prokurorisë rezultoi i drejtë, pasi gjykata pranoi kërkesën për pushimin e çështjes dhe nuk e çmoi të nevojshme kryerjen e veprimeve të udhëzuara nga drejtuesi i prokurorisë (udhëzimi i drejtuesit ishte pjesë e fashikullit të dërguar për gjykim). Vlerësoj se edhe kryerja e veprimeve të panevojshme dëmton qëllimin e ndjekjes penale dhe punën e prokurorisë, njësoj si në rastet kur nuk kryen veprimet e domosdoshme.

86. Komisioni, pas shqyrtimit të fashikullit që i përket procedimit penal nr. {***}, të trajtuar më sipër, ka konkluduar se: *Argumentet e parashtruara nga subjekti lidhur me kërkimin e ndryshimit të masës së sigurimit personal ndaj të dyshuarit G.J.A., të cilat kishin nxjerrë në pah problematikat shëndetësore, familjare dhe ekonomike të tij, duken të pranueshme në raport me të dhënat e para, të cilat nuk mund të jenë gjithnjë prezente në kushtet e ngutshmërisë që kërkohet për të vendosur mbi caktimin e një mase sigurimi personal ndaj një personi. Referuar dokumentacionit të administruar, ndër të tjera, pasqyrohet një epikrizë e fëmijës së të dyshuarit Gj. A., me titull “Epikrizë përcjellëse për invalidë” dhe disa dokumente të tjera shëndetësore, çka përkon me vlerësimin dhe veprimet justifikuese për një ndryshim të mundshëm të një mase sigurimi, sikurse është edhe rasti në fjalë. Gjithashtu, si një rrethanë tjetër e rëndësishme nga aktet e administruara në dosjen objekt i këtij hetimi administrativ, u identifikua edhe pezullimi i tij nga detyra, si dhe nisja e procedimit disiplinor nga institucioni punëdhënës, Drejtoria e Policisë. Pra, paralelisht me ndërmarrjen e masave administrative dhe konfirmimin e disa të dhënave në favor të shtetasit të dyshuar Gj. A., për të bërë të mundur zëvendësimin e masës së sigurimit, sikurse e parasheh neni 260 i Kodit të Procedurës Penale, u ndërmorën edhe veprimet hetimore, të cilat duket se janë ndjekur profesionalisht nga subjekti. Në të tilla kushte, duket se janë grumbulluar disa prova, të cilat, pa mënjnuar edhe vlerësimin e bindjes së brendshme të subjektit, përpos edhe logjikës së përdorur në arsyetimin e kërkimit të tij ndaj organeve gjyqësore, e cila nuk mund të zëvendësohet dhe as interpretohet, përfshirë këtu edhe vendimmarrjet e gjykatave, së bashku krijojnë një panoramë të plotë e të qartë për të cilën trupi gjykues duket se nuk konstaton problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit.*
87. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik **për mungesën e arsyetimit ligjor mbi informacionet verifikuese që kanë justifikuar kërkesën për ndryshimin e masës së sigurisë**, trupi gjykues konstaton se i vetmi akt i hartuar nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë çështje, është kërkesa për vlerësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit, e datës 18.10.2017, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me të cilën ka kërkuar vlerësimin si të ligjshëm të ndalimit të bërë ndaj të hetuarit Gj. A. dhe vendosjen ndaj tij të masës së sigurimit “Arrest në burg”. Në seancën gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit, të datës 20.10.2017, siç rezulton nga vendimi nr. {***}, datë 20.10.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar, në ndryshim nga kërkesa e depozituar dy ditë më parë,

caktimin ndaj të dyshuarit të masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”. Nga aktet, rezulton se asnjë provë/dokument/rrethanë e re nuk është administruar prej subjektit të rivlerësimit para kësaj seance, përveçse provat/aktet e paraqitura nga ana e mbrojtjes së të dyshuarit, avokatit G. L., i cili ka kërkuar vlerësimin me objektivitet të masës së sigurimit ndaj shtetasit Gj. A., edhe për shkak të kushteve ekonomike dhe sociale familjare, dhe fëmijës së sëmurë. Bashkëlidhur kësaj kërkesë janë dhe epikriza e fëmijës së të dyshuarit, disa dokumente të tjera shëndetësore, rekomandimi i mjekut i datës 17.07.2017, si dhe një certifikatë familjare.

88. Nga sa më sipër, rezulton se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit është referuar pikërisht në këto pretendime dhe dokumente të mbrojtjes për të ndryshuar qëndrimin e tij për llojin e masës shtrënguese që duhej të vendosej ndaj të dyshuarit. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar se cila prej kriterëve të veçanta të nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale është përmbushur në rastin e personit në hetim, për të justifikuar ndryshimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” në një masë më të lehtë. Ndërsa subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në gjykatë një kërkesë për caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, sipas kërkesës së datës 18.10.2010, dhe ka vlerësuar në të se ekzistojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 228 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale për caktimin e kësaj mase sigurimi, ka ndryshuar këtë qëndrim vetëm pas dy ditësh dhe jo në mbështetje të ndonjë hetimi shtesë që do bënte nivelin e dyshimit të arsyeshëm, siç ai pretendon, pasi nuk rezulton asnjë e dhënë e tillë prej akteve, por duket se është mbështetur vetëm në pretendimet e mbrojtjes për rrethana që lidhen me kushtet shëndetësore e familjare të të dyshuarit. Lidhur me kushtet shëndetësore e familjare, si pengesë për vendosjen e masës së sigurimit “Arrest me burg”, neni 230, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale¹¹ parashikon vetëm rrethanat specifike, asnjëra prej të cilave nuk përputhet me ato që ka tentuar të provojë mbrojtja e të dyshuarit. Përpos këtij arsytimi, vlerësimi i këtyre rrethanave në kushte të tilla, është detyrë e gjykatës e cila vlerëson në tërësi të gjitha rrethanat që përcaktojnë llojin e masës së sigurimit që duhet të vendoset. Në këtë kuptim, trupi gjykues çmon se është i drejtë konstatimi i Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në kuadër të aspektit të njohurive ligjore në analizimin e çështjes, në përputhje me nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, pasi në vendimmarrjen e tij në këtë procedim penal, ka demonstruar mangësi profesionale në vlerësimin e situatës faktike dhe kriterëve ligjore lidhur me përcaktimin e masës së sigurimit personal apo ndryshimin e saj.
89. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se mungon argumentimi i subjektit të rivlerësimit mbi trajtimin si të panevojshme të disa prej veprimeve hetimore të udhëzuara nga prokurori epror, konstatohet se në udhëzimin lidhur me kryerjen e disa veprimeve të mëtejshme

¹¹ Nuk mund të vendoset arresti në burg ndaj një gruaje që është shtatzënë ose me fëmijë nën moshën 3 vjeç dhe që jeton me të, ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë ose që ka kaluar moshën shtatëdhjetë vjeç ose një personi toksikoman apo të alkoolizuar, për të cilin zbatohet një program terapeutik në një institucion të posaçëm.

procedurale në çështjen nr. {***}, drejtuesja e prokurorisë ka udhëzuar kryerjen e një sërë veprimesh hetimore të përshkruara në paragrafin 85.2 më sipër. Rezulton nga aktet se subjekti i rivlerësimit ka kryer disa nga veprimet hetimore të udhëzuara nga drejtuesja e prokurorisë. Konkretisht, është administruar me procesverbal këqyrje-marrje shkresa nr. {***}, datë 27.03.2017, për pjesëmarrjen në trajnim të komisar K. Xh., nga ku rezulton se ky shtetas ka qenë në punë ditën kur është nënshkruar vërtetimi i besueshmërisë. Nëpërmjet vendimit për këqyrjen dhe sekuestrimit të dokumenteve të datës 28.02.2018, janë ndërmarrë nga subjekti i rivlerësimit veprimet në drejtim të kryerjes së aktekspertimit grafik, duke kërkuar marrjen e mostrave të shkrimit të hedhura në akte prej personave të dyshuar. Nga aktekspertimi grafik i datës 23.03.2018, ka rezultuar se nënshkrimi në dokumentin “Vërtetim i besueshmërisë dhe përshtatshmërisë” nuk i përkiste të dyshuarit Gj. A., por eprorit të tij. Rezultati i dalë nga ky aktekspertim, konfirmon qëndrimin e subjektit të rivlerësimit se *nga aktet e administruara, rrethanat e faktit ishin të qarta dhe ripyetja apo ballafaqimi i personave ishte i panevojshëm, për shkak se të gjitha faktet ishin sqaruar*. Në aktin e datës 28.03.2018, “Njoftim për përfundimin e hetimeve”, subjekti i rivlerësimit ka arsyetuar veprimet hetimore të kryera prej tij, nga të cilat rezulton se nga rekordet e hedhura në sistemin TIMS, nuk pasqyrohet ndryshimi i emrit të shtetasit G. N., i cili nuk rezultonte të kishte precedentë penalë dhe të ishte regjistruar si kontingjent i policisë në kohën kur i është dhënë vërtetimi i besueshmërisë për pajisjen me armë zjarri. Nga sa rezulton më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka marrë në konsideratë dhe ka zbatuar udhëzimet e drejtueses së prokurorisë, duke përzgjedhur të kryejë ato veprime hetimore që, sipas “interpretimit dhe logjikës” së tij, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes.

90. Në lidhje me procesin gjyqësor të kësaj çështjeje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. {***}, datë 14.05.2018, ka vendosur (sipas kërkesës së organit të akuzës) pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***}, vendim ndaj të cilit nuk është ushtruar ankim. Kjo rrethanë e prezantuar prej subjektit të rivlerësimit se legjitimon kërkimin e tij për ndryshimin e masës së sigurimit, nuk vlerësohet si relevante nga trupi gjykues. Mungesa e arsytimit dhe e rrethanave që legjitimonin prokurorin të kërkonte një masë të ndryshme sigurimi vetëm dy ditë pasi kishte kërkuar caktimin e masës “Arrest në burg”, nuk lidhen me zgjidhjen në themel të procedimit që subjekti, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka ndërmarrë pas kryerjes së hetimeve të plota. Objekt kontrolli për këtë trup gjykues, mbështetur në shkakun e ankimit të ngritur prej Komisionerit Publik, është ndryshimi i kërkesës për caktimin e masës, pa ndryshuar kushtet dhe kriteret për të cilat subjekti kishte kërkuar caktimin e një mase të tillë.
91. Në përfundim, lidhur me procedimin penal nr. {***} të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mangësi të aftësive profesionale në kushtet e ndryshimit të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetasit nën hetim, në mungesë të elementeve që mund të afektonin këtë qëndrim të prokurorit

sipas parashikimit të nenit 230 të Kodit të Procedurës Penale, mangësi që konsiderohen në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nënindikatoreve të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

92. Komisioni, në zbatim të nenit 43, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ka verifikuar denoncimin e shtetasit A. A., i cili pretendon se subjekti ka vendosur në mënyrë të padrejtë mosfillimin e procedimit penal të iniciuar mbi bazën e kallëzimit të denoncuesit lidhur me problematikat e shfaqura nga një kontratë huaje e lidhur mes tij dhe z. Z. K., për vlerën 2.200 euro, për të cilën është pretenduar se nuk është kthyer, duke vijuar kështu me pretendimet e më tej deri në kallëzim për kanosje me qëllim përfitimin e tyre. Denoncuesi ka parashtruar në Komision se vendimi i mosfillimit është rrëzuar nga gjykatat në të dyja shkallët e gjykimit, por edhe pse gjykata ka vendosur rifillimin e hetimeve, subjekti i rivlerësimit për afërsisht një vit nuk ka kryer asnjë hetim.
93. Në përfundim të shqyrtimit të këtij denoncimi, Komisioni ka konkluduar se: *Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje, konstatoi se periudha për dhënien e vendimit të mosfillimit i përkiste kohës në të cilën kryhet leje vjetore. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në hetimin e çështjes ka vlerësuar sipas bindjes së tij të brendshme, argument ky që në çdo rast individualizon situatën, është një arsye legjitime dhe, për pasojë, nuk mund të cenohet apo vlerësohet ndryshe. Në tërësi, u vërejt se çështja ka pasur në thelb marrëdhënie juridiko-civile (referuar një marrëdhënieje kontraktore huaje me të drejta dhe detyrime mes palëve, shkelja e të cilave, po sipas klauzolave kontraktuale, është parashikuar të zgjidhet në rrugë gjyqësore). Trupi gjykues ka vërejtur gjithashtu se përtej kryerjes së veprimeve të para, por edhe bindjes së brendshme, subjekti ka zbatuar detyrat e lëna pas kthimit nga gjykata dhe, për pasojë, ka konkluduar në ngritjen e akuzës "mashttrim" ndaj shtetasit F. K., duke i njoftuar edhe akuzën. Po ashtu, trupi gjykues ka vërejtur se Gjykata e Apelit, në arsyetimin e vendimit të saj, nga njëra anë orienton se duhej të ishte vendosur pushimi i çështjes dhe jo mosfillimi i saj, por, nga ana tjetër, vijon të lërë detyra të tjera për hetim. Aktualisht, sipas procesverbaleve gjyqësore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, rezultoi se çështja vijon të jetë nën gjykim. Për sa kohë është ezauruar roli dhe puna e subjektit të rivlerësimit dhe për sa kohë çështja vijon të jetë në proces gjyqësor, Komisioni nuk ka kompetencë për të konkluduar apo penalizuar subjektin e rivlerësimit.*
94. Komisioneri Publik, ndryshe nga Komisioni, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, pasi mosrespektimi i afateve ligjore dhe moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3, dhe nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe duhet të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, Komisioneri Publik kundërshton konkluzionin e Komisionit se: *për sa kohë çështja vijon të jetë në proces gjyqësor, Komisioni nuk ka*

kompetencë për të konkluduar apo penalizuar subjektin e rivlerësimit, duke çmuar se Komisioni e ka pasur këtë kompetencë, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit¹².

95. Lidhur me këtë shkak ankimi, nga aktet në fashikujt e Komisionit, rezulton se:

95.1. Në kallëzimin penal nr. {***}, datë 02.09.2017, referohet se shtetasi A. A. ka pasur një kontratë huaje me shtetasin Z. K., për vlerën 2.200 euro, fakt ky i vërtetuar me kontratën e huasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2014. Shtetasi A. A., ndër të tjera, parashtron në kallëzim se: *pavarësisht se detyrimi është shlyer, shtetasi Z. K. dhe shtetasi F. K. kanë vazhduar të kërkojnë para, duke kërkuar në mënyrë ultimative para të kartëmonedhave euro, duke më vënë në kushte se, përveç pasurisë së vendosur si barrë hipotekore për shlyerjen e huasë (tashmë të shlyer), kërkojnë edhe para të tjera në formën cash. Nga ana tjetër, i kallëzuari, në mënyrë të vazhdueshme më telefonon në numrin tim celular, duke më kërkuar që të vazhdojë të bëjë pagesa për llogari të tij.*

95.2. Subjekti i rivlerësimit, si prokuror i çështjes, me vendimin e datës 7.09.2017, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke arsyetuar se: [...] *vërehet se marrëdhënia midis A. A. dhe Z. K., babai i të kallëzuarit F. K., ka lindur për shkak të kontratës së huasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.10.2014, nga e cila rrjedhin të drejta dhe detyrime. Pretendimet e kallëzuesit mund të realizohen nëpërmjet proceseve civile, që kanë të bëjnë me mospërmbushjen e detyrimeve të kontratës. Meqenëse ky fakt nuk është penal, mbështetur edhe në nenet 290/1 “c” dhe 291/1,2 të K.Pr.Penale; vendosa mosfillimin e hetimeve të kallëzimit penal nr. {***} të vitit 2017 [...].*

95.3. Pas ankimit të denoncuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. {***}, datë 31.10.2017, ka vendosur anulimin e vendimit të mosfillimit, datë 7.9.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke arsyetuar se: [...] *Nga shqyrtimi i çështjes penale, del se gjatë fazës së verifikimit të kallëzimit penal të bërë, është pyetur në mënyrë të përciptë ankuesi A. A., si dhe janë marrë deklaratimet e shtetasit Z. K. dhe F. K.. Rezulton se nuk është kryer asnjë veprim verifikues rreth pretendimeve të bëra në kallëzimin penal nga ana e ankuesit A. A., si dhe të provave shkresore të paraqitura prej tij, dhe në këtë gjendje, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, është marrë vendimi i datës 7.09.2017, “Mbi mosfillimin e hetimeve”, për kallëzimin penal nr. {***}, datë 6.07.2017, që është kundërshtuar në gjykatë nga ankuesi A. A., duke kërkuar anulimin e tij dhe detyrimin e organit të akuzës të kryejë hetimet përkatëse. Gjykata shqyrtoi materialet e çështjes dhe konkludon se vendimi për mosfillimin e hetimeve, i datës 7.09.2017, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, nuk është rezultat i verifikimit të kallëzimit penal të bërë nga ankuesi A. A., dhe se duhet të kryhen një sërë veprimesh procedurale hetimore [...]. Gjykata në dispozitiv ka përcaktuar dhe veprimet*

¹² Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 7/2019 (JR), nr. 16/2020 (JR), nr. 28/2020 (JR).

hetimore që duhet të kryhen (ka kërkuar të ripyetet kallëzuesi, të merren dorëshkrimet e shtetasit F.K., të kryhet aktekspertim për të, të kryhen veprime hetimore lidhur me telefonatat e pretenduara, të pyetet noteri tek i cili është nënshkruar kontrata e huasë etj.).

95.4. Subjekti i rivlerësimit ka bërë ankim në datën 6.11.2017, në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila, në datën 19.12.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 31.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, ka çmuar faktin se: *Vendimi për mosfillimin e procedimit penal, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është i pabazuar në prova e ligj dhe, me të drejtë, është anuluar nga Gjykata e Shkallës së Parë, duke caktuar edhe kryerjen e disa veprimeve të domosdoshme procedurale. [...]* Rezulton se kallëzimi nga ankuesi/denoncuesi A. A. është regjistruar në prokurori në datën 6.07.2017 dhe, në referim të nenit 290/1, të Kodit të Procedurës Penale, prokurori duhet të kishte vendosur mosfillimin e procedimit brenda datës 15.08.2017 (ndryshimet e K.Pr.Penale, ligji nr. 35/2017, kanë hyrë në fuqi më datë 1.08.2017). Në këtë kontekst, prokurori jo vetëm që nuk ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, por, në kundërshtim me nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, më datë 7.9.2017, ka kryer veprime hetimore, si pyetjen e deklaruësve Z. K. dhe F. K., kur duhej të ishte shprehur me vendim brenda datës 15.8.2017. Më tej, gjykata shprehet se: *Kryerja e veprimeve të mësipërme procedurale presupozon se kjo çështje de facto ka filluar dhe nga ana e prokurorisë nuk duhej që të vendosej mosfillimi i procedimit, por pushimi i këtij procedimi penal, konform nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale.*

95.5. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit të Komisionit, ndër të tjera, ka parashtruar se: *[...] Në lidhje me sa konstaton Komisioni, shpjegoj se në datën 15.08.2017 (apo 6.08.2017), si data limit brenda së cilës duhet të kisha marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal, përfshihen në ditët e muajit gusht, kur prokuroria dhe gjykata ka të planifikuara lejet vjetore. Vendimin e mosfillimit e kam marrë bazuar në bindjen time të brendshme, menjëherë sapo jam kthyer nga leja vjetore. Bazuar në vendimin gjyqësor, kam filluar hetimet dhe, bazuar në hetimet shtesë të kryera, kam konkluduar, në datën 28.09.2020, se shtetasit F. K. duhet t'i njoftohet akuza për veprën penale të "Mashtrimit", të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Më datë 23.10.2020, çështja është dërguar për gjykim dhe vazhdon gjykimi me procedurën e gjykimit të zakonshëm. Gjatë gjykimit është vendosur të kryhet një riekspertim, pasi akti i parë i ekspertimit grafik nuk e bindi gjykatën se në dokumentet e dorëzuara nga kallëzuesi, ndodhej shkrimi dhe nënshkrimi i shtetasit F. K. [...].*

96. Në vlerësim të pretendimeve të Komisionerit Publik, së pari trupi gjykues vlerëson se qëndron konstatimi i tij se Komisioni, ndryshe nga qëndrimi që ka mbajtur, ka pasur kompetencë për të konkluduar apo penalizuar subjektin e rivlerësimit për çështjen penale të referuar nga denoncuesi. Çështja konkrete që ka vlerësuar Komisioni, lidhej me vendimmarrjen për mosfillimin e procedimit penal, si dhe me mungesën e veprimeve hetimore dhe zgjatjen e procesit, dhe fakti që çështja aktualisht është në gjykatë, nuk e bën atë një çështje në shqyrtim,

për sa kohë që ashtu si dhe e pranon vetë Komisioni, është ezauruar roli dhe puna e subjektit të rivlerësimit. Për këto raste, Kolegji ka një jurisprudencë të gjerë¹³, duke u shprehur se: “Kolegji ka pranuar se zbatimi i nenit E, paragrafi i 2-të i Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: [...] Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve të cilat janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe jo nga organe të tjera më të larta apo alternative, siç është rasti në fjalë”. Për pasojë, Komisioni nuk ka qenë në kushtet e pengesës ligjore të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, dhe ishte i legjitimuar të analizonte e vlerësonte edhe këtë çështje në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

97. Për sa i përket pretendimit të Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, për shkak të moskryerjes së të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme dhe mosrespektimit të afateve ligjore, trupi gjykues, referuar vendimeve gjyqësore në të dyja shkallët, vëren se ka rezultuar një veprimtari e pamjaftueshme hetimore nga ana e subjektit, për të verifikuar pretendimet e kallëzuesit. Kjo pamjaftueshmëri del dhe nga detyrat që janë lënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (*të ripyetet kallëzuesi, të merren dorëshkrimet e shtetasit F.K., të kryhet aktekspertim për të, të kryhen veprime hetimore lidhur me telefonatat e pretenduara, të pyetet noteri tek i cili është nënshkruar kontrata e huasë*), për kryerjen e disa veprimeve hetimore që dukshëm janë veprimet hetimore bazë që kryhen nga prokurori në trajtimin dhe verifikimin e një kallëzimi penal. Pavarësisht se subjekti ka vepruar më pas, me rrëzimin e ankimit të tij nga Gjykata e Apelit Durrës, vlerësohet se ai vetë duhet të kishte kryer veprimet hetimore në funksion të zbardhjes së ngjarjes. Vetë koha shumë e shkurtër e hetimit, brenda një periudhe disaditore, pas së cilës subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e çështjes, datë 7.09.2017, pyetja e personit që ka dijeni për veprën penale në të njëjtën ditë kur është marrë vendimi i mosfillimit, arsyetimi se kallëzimi ka qenë një konflikt civil, konfirmon më tej mungesën e angazhimit të subjektit të rivlerësimit në drejtim të vlerësimit të çështjes dhe të kryerjes së detyrave të tij si prokuror. Për sa u përket afateve ligjore për shqyrtimin e çështjes, rezulton se pas vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, datë 19.12.2017, për rifillimin e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka kryer hetimet shpesh, duke konkluduar vetëm në datën 28.09.2020, pas më shumë se dy vitesh, për regjistrimin e procedimit penal dhe njoftimin e akuzës ndaj shtetasit F. K..
98. Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit lidhur me procedimin penal me nr. {***}, datë 2.09.2017, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e çështjes penale që ka nisur mbi bazën e kallëzimit të paraqitur prej këtij denoncuesi, të cilat janë konfirmuar edhe nga kontrolli gjyqësor, si: mosrespektimi i afateve ligjore në marrjen e vendimeve nga ana e subjektit, moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të

¹³ Shih vendimet e Kolegjit nr. 7/2019 (JR); nr. 16/2020 (JR); nr. 28/2020 (JR).

nevojshme për t'i dhënë përgjigje materialit kallëzues dhe për zbardhjen e së vërtetës, zgjatja e kohës së hetimit paraprak përtej afateve të arsyeshme, konsideruar natyrën dhe rrethanat e veprës penale në rastin konkret. Këto mangësi konsiderohen në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nënindikatorëve të parashikuar në nenin 73, pikat 2 dhe 3, si dhe në nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Denoncimi i shtetasit S. M.

99. Shtetasi S. M. ka paraqitur denoncim në Komision, regjistruar me nr. {***} prot., datë 29.07.2019 dhe nr. {***} prot., datë 18.09.2019, depozituar pranë ONM-së, duke pretenduar se kallëzimi i bërë prej tij me nr. {***}, datë 15.5.2008, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier nuk është ndjekur dhe trajtuar, duke fajësuar disa subjekte, ndër të cilët edhe subjektin e rivlerësimit. Denoncimi i referohet, ndër të tjera, një aksidenti automobilistik të ndodhur në datën 4.10.2007, në qarkun Fier, ku një automjet ka aksidentuar rëndë motoçiklistin B. C.. Denoncuesi pretendon se policia dhe prokuroria kanë fshehur dhe zhdukur provat, nuk kanë vepruar, dhe prokurorët e çështjes nuk e kanë marrë në ndjekje penale autorin.
100. Nga aktet e administruara në dosje nga Komisioni, konstatohet se çështja penale ka nisur mbi kallëzimin e shtetasit S. M., më datë 15.05.2008, çështje e cila është regjistruar me nr. {***} në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, për veprën penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”.
101. Subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***}, me vendimin e datës 19.06.2009, me arsyetimin se mungon lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë mes veprimeve të kundërligjshme të drejtuesit të mjetit dhe pasojës së ardhur, meqenëse nuk është bërë e mundur të këqyrej vendi i ngjarjes pasi është prishur dhe njëkohësisht, nga marrëveshja e lidhur mes palëve për ta zgjidhur çështjen privatisht, nuk mund të vërtetohet se pasojat kanë ardhur si rezultat i shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, por edhe të identifikohet subjekti penal.
102. Ky vendim, pas ankimit nga shtetasi S. M., është shfuqizuar nga Prokuroria e Përgjithshme, me vendimin e datës 27.4.2010. Sipas vendimit të marrë nga prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme, vendimi i marrë nga subjekti i rivlerësimit, nga përmbajtja e tij, është alogjik, me paragrafë kontradiktorë dhe i paarsyetuar drejt. Vendimi është arsyetuar në mënyrë të gabuar pasi provueshmëria apo mungesa e elementeve të figurës së veprës penale të parashikuar nga nenin 290 i Kodit Penal, është argumentuar si rezultat apo si pasojë e mungesës së elementeve të figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Gjithashtu, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm pasi nuk është hetuar në lidhje me autorin e aksidentit, nuk është pyetur ky person për të sqaruar

mekanizimin e ndodhjes së aksidentit, nuk është hetuar nëse ka qenë i pajisur me leje për drejtimin e automjetit, nuk janë marrë deklarime të personit të dëmtuar dhe të familjarëve të tij, nuk është pyetur personeli mjekësor, nuk janë këqyrur regjistrat e sallës operative të Komisarariatit të Policisë Mallakastër e Fier, si dhe nuk janë pyetur punonjësit e policisë lidhur me faktin e moskryerjes prej tyre të asnjë veprimi me drejtuesin e automjetit. Për sa më sipër, është vendosur shfuqizimi i vendimit të pushimit të çështjes penale nr. {***}, i datës 19.06.2009, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier.

103. Më tej, çështja penale i ka kaluar për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, në ngarkim të shtetasit O. D., i akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, duke dërguar në gjykatë kërkesën për gjykimin e çështjes penale, për arsye se është provuar që shkak determinant i aksidentit të ndodhur ka qenë parakalimi i gabuar dhe qarkullimi pa patentë i shtetasit O. D. dhe se nga hetimet është vërejtur që janë konsumuar plotësisht elementet e veprës penale prej të pandehurit dhe, në këto rrethana, ky i pandehur mbetet i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, bazuar në nenin 290/1 të Kodit Penal.
104. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në konkluzionet përfundimtare të datës 22.12.2011, ka kërkuar deklarimin “fajtor” të të pandehurit O. D., për kryerjen e veprës penale “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal.
105. Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime, pasi dukej se në këtë çështje viheshin re mangësi në aspektin e njohurive ligjore, sipas parashikimeve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, në drejtim të aftësisë së subjektit për të kryer hetime të plota për identifikimin e autorit. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet drejtuar Komisionit, ka shpjeguar se vendimin e pushimit të procedimit penal e ka marrë bazuar në bindjen e tij të brendshme, mbi bazën e provave të administruara. Ai është shprehur se: *Pavarësisht vendimmarrjes së ndryshme të Prokurorisë së Rrethit Vlorë, kam çmuar se në kushtet kur nuk kishte këqyrje të vendit të ngjarjes, ishte e pamundur të vërtetohej akuza e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor. Vendimin e pushimit ua kam njoftuar palëve, të cilët kanë ushtruar të drejtën e ankimit. Përveç faktit se kjo dosje është jashtë periudhës së rivlerësimit, dua të theksoj për Komisionin se kjo është e vetmja çështje e njoftuar nga Komisioni, ku në përfundim është vendosur ndryshe nga vendimmarrja ime. Në këto kushte, në përfundim të analizës së sipërcituar, Komisioni duhet të arrijë në konkluzionin se kam arritur nivel të mirë të vlerësimit profesional.*
106. Në përfundim, Komisioni për këtë denoncim ka konkluduar se në analizë të hetimit administrativ të kryer për këtë çështje, shpjegimeve të subjektit, çdo dokumentacioni të administruar, vëren se edhe pse kemi të bëjmë me një çështje të vitit 2008, kontrolli i vendimmarrjes së subjektit nga ana e drejtuesit më të lartë të institucionit, i vlerësuar në një tjetër mënyrë, duhet parë në proporcionalitet me pretendimin e subjektit se në vendimmarrje ka

vendosur jo vetëm sipas bindjes së tij të brendshme, por edhe provave të administruara. Kjo çështje duket se nuk mund të ndikojë si një shkak determinant në rivlerësimin e subjektit. Trupi gjykues nuk mund të marrë attribute për të vlerësuar lidhur me themelin e çështjes apo lidhur me arsyet që kanë çuar subjektin në vendimmarrjen e tij në këtë çështje.

107. Komisioneri Publik, në analizë të përmbajtjes së denoncimit, rezultateve të hetimit administrativ dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim hetimor në drejtim të zgjidhjes së çështjes. Sipas Komisionerit, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse mbi gjetjet dhe të metat e veprimeve procedurale të kryera prej tij. Subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, pasi moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme bie ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3, dhe nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe duhet të merret në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
108. Fillimisht trupi gjykues i Kolegjit, bazuar dhe në jurisprudencën e tij të mëparshme¹⁴, gjen me vend të shprehet, ashtu si dhe konstaton Komisioneri Publik, se pavarësisht se kjo çështje penale i përket vitit 2008, referuar dispozitave kushtetuese dhe ligjore, periudha 3-vjeçare e parashikuar në nenin 41 të ligjit nr. 84/2016, lidhet me vlerësimin e aftësive profesionale sa u përket dosjeve të shortuara për këtë qëllim apo të përzgjedhura nga vetë subjekti, por vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet edhe përtej kësaj periudhe, siç është parashikuar në pikën 4 të këtij neni, nga viti 2006 e në vazhdim, pa u kufizuar në kohë.
109. Në shqyrtim të pretendimit të Komisionerit Publik se subjekti i rivlerësimit **nuk ka ndërmarrë asnjë veprim hetimor në drejtim të zgjidhjes së çështjes**, nga vendimi “Për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***}”, i datës 19.06.2009, rezulton se subjekti i rivlerësimit është shprehur: *Për të verifikuar pretendimet e ngritura në kallëzimin e kryer, janë ndërmarrë veprimet e nevojshme hetimore. I është kërkuar spitalit civil të Fierit të vihet në dispozicion kartela klinike e shtetasit B. C.. Kjo kartelë është vënë në dispozicion me shkresën nr. {***} prot., datë 17.06.2008, çka hedh poshtë pretendimin se kjo kartelë klinike është zhdukur. Kjo kartelë i është vënë në dispozicion Institutit të Mjekësisë Ligjore [...]. Është kërkuar materiali i mbajtur për këtë aksident rrugor [...]. Nga shkresa e administruar e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Fier, rezulton se nuk ekzistojnë materiale në lidhje me këtë aksident, dhe gjithashtu janë vënë në dispozicion dhe kamerat e efektivëve të policisë të qarkullimit rrugor [...]. Janë pyetur në cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit, shtetasit P.C. dhe A. M., të planizuar në këtë aks rrugor gjatë ndodhjes së aksidentit. Nga deklaratimet e tyre, ka rezultuar se në ditën kur ka ndodhur aksidenti, janë njoftuar nga salla operative për të. Është shkruar në vendin e ngjarjes dhe është konstatuar se kjo vendngjarje ka qenë e dëmtuar, pra mjetet kanë qenë të lëvizura dhe*

¹⁴ Shih vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 16/2021, paragrafi 9.

nuk ka pasur shenja të aksidentit. Është shkuar nga ata (policët) në poliklinikën e komunës Fratar, ku dhe është marrë informacion për një shtetas të dëmtuar, të përcjellë në spitalin civil të Fierit. Është shkuar në spitalin civil të Fierit dhe nga ana e personelit nuk është dhënë informacion për persona të dëmtuar [...]. Sipas deklaruësve, veprime në vendngjarje nuk janë kryer pasi ky veprim ka qenë i pamundur, si rezultat i prishjes së elementeve të tij, fakt i cili nuk ka bërë të mundur përcaktimin e përgjegjësive për shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e shtetasve të përfshirë në këtë aksident [...]. Në vazhdimësi të procesit hetimor, i është kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, administrimi i deklarimeve të dhëna në gjyqin penal me të pandehur S. M., të shtetasve S. D. dhe M. Y. [...].

110. Nga përshkrimi i dhënë në vendimin e pushimit, rezulton se në kundërshtim nga sa pretendon Komisioneri Publik, subjekti i rivlerësimit ka kryer disa veprime hetimore, referuar dhe udhëzimeve të dhëna nga drejtuesi i prokurorisë, i cili në urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, të datës 15.05.2008, ka orientuar prokurorin e ngarkuar (subjektin e rivlerësimit) dhe oficerin e policisë gjyqësore të përqendrohen në veprimet hetimore që lidhen me sqarimin e rrethanave, si: *A është marrë njoftim nga shërbimet e policisë së shtetit për aksidentin? A është dërguar njoftim nga institucioni spitalor ku është kuruar i dëmtuari në strukturat policore, për mbërritjen e një personi të dëmtuar? A janë kryer hetime për këtë rast, përfshirë njoftimin e prokurorit për ngjarjen, pyetjen e personave të pranishëm në vendngjarje, kryerjen e ekspertimeve autoteknike apo mjeko-ligjore? A është pasqyruar kategoria e dëmtimeve të të dëmtuarit dhe ecuria e gjendjes shëndetësore të tij, në kartelën klinike të institucionit spitalor?*
111. Nga aktet, rezulton se denoncuesi S. M. është kallëzuar penalisht nga shtetasi S. D. (vëllai i drejtuesit të mjetit që ka kryer aksidentin), për veprën penale të korrupsionit pasiv, pasi sipas tij mjeku kirurg (S. M.) i kishte marrë 500 euro dhe i kërkonte edhe 600 euro të tjera për operacionin që kishte kryer ndaj të aksidentuarit B. C.. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin e datës 02.05.2008, ka vendosur të deklarojë fajtor të pandehurin S. M. për veprën penale “Korrupsion pasiv nga persona që ushtrojnë funksione publike” dhe e ka dënuar me 2 vjet e 6 muaj burgim, me gjobë 500.000 lekë, si dhe me dënim plotësues heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për dy vjet. Më datë 13.05.2008, shtetasi S. M., pas daljes nga burgu, ka bërë kallëzimin penal ndaj shtetasit S. D., regjistruar me numër{***}. Këto fakte janë konstatuar dhe në vendimin e pushimit të hetimeve të procedimit penal nga subjekti i rivlerësimit.
112. Në vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme për shfuqizimin e vendimit të pushimit të çështjes penale nr.{***}, është konstatuar edhe mungesa e veprimeve nga punonjësit e policisë, të cilët nuk kanë njoftuar sipas ligjit në prokurori, si dhe moskryerja prej tyre e veprimeve të para hetimore në vendin e aksidentit, identifikimin dhe pyetjen e protagonistëve. Është pikërisht për shkak të mungesës së këtyre veprimeve që, sipas subjektit të rivlerësimit, në kushtet *kur nuk*

kishte këqyrje të vendit të ngjarjes, ishte e pamundur të vërtetohej akuza e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor.

113. Në vlerësim të pretendimeve të ngritura nga Komisioneri Publik, si dhe të akteve të cituara më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në drejtim të kryerjes së disa veprimeve paraprake hetimore për zbardhjen e ngjarjes, por që rezultojnë të jenë të paefektshme dhe të paplota. Shpjegimet e dhëna nga subjekti se ai ka qenë i kufizuar në kryerjen e veprimeve të plota hetimore, për shkaqe që nuk vareshin prej tij, si prishja e vendit të ngjarjes, nuk e shmang atë nga përgjegjësia e kryerjes së veprimeve të tjera nga të cilat të mund të dilnin elemente me vlerë provuese për zbardhjen e ngjarjes dhe përcaktimin e personave përgjegjës. Tërësia e veprimeve hetimore të përshkruara në vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme për prishjen e vendimit të pushimit të subjektit, ishte e mundur të kryhej dhe prej tyre mund të arrihej në një konkluzion. Këto veprime hetimore janë kryer më pas nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Argumenti i përdorur prej subjektit në vendimin e pushimit lidhur me stabilizimin e marrëdhënieve mes autorit dhe të dëmtuarit, dhe familjarëve reciprokë, është tërësisht jashtëprofesional në përdorimin e tij si një argument për përcaktimin e fajësisë, duke qenë se këto vepra penale ndiqen kryesisht dhe pavarësisht vullnetit të subjekteve të përfshira. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk jep shpjegime bindëse mbi moskryerjen prej tij të gjithë veprimeve hetimore të nevojshme për zbardhjen e aksidentit. Ai nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin për të kërkuar e mbledhur provat sipas kërkesave ligjore, dhe veprimet e kryera prej tij konsiderohen të pamjaftueshme për të argumentuar mungesën e elementeve të figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, dhe për të konkluduar në pushimin e procedimit penal.
114. Në përfundim të analizës mbi këtë shkak ankimi, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e procedimit penal nr. {***} të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, duke qenë se nuk ka kryer të gjitha veprimet hetimore të nevojshme për hetimin e rrethanave që lidheshin me kryerjen e veprës penale të “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal. Moskryerja e veprimtarisë së nevojshme hetimore, si edhe arsyetimi sipërfaqësor i vendimit të pushimit të procedimit penal, marrë nga subjekti i rivlerësimit për këtë çështje, i konfirmuar edhe nga kontrolli hierarkik brenda organit të akuzës, por edhe në mënyrë përfundimtare nga kontrolli gjyqësor, përbën cenim të veprimtarisë së organit të akuzës dhe moskryerje të detyrës në nivelin e duhur profesional, duke afektuar në këtë mënyrë kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale sipas nënindikatorëve të parashikuar prej nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
115. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim problematikat e trajtuara brenda kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale të ngritura në ankimin e Komisionerit Publik e të arsyetuara edhe më lart,

ndonëse konstatoi mangësi të subjektit të rivlerësimit në drejtim të aspektit të njohurive ligjore dhe të arsyetimit ligjor, por edhe në drejtim të aftësive organizative të tij, të hasura në çështjet e trajtuara më sipër, sërish i vlerësoi ato të pamjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit duhet të konsiderohet si i paaftë në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por çmoi se ato do të duhen të vlerësohen së bashku me gjetjet e tjera, të renditura më sipër, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

116. **Lidhur me denoncimet nga publiku të ardhura në Kolegj**, trupi gjykues, pasi vlerësoi informacionin që u përcoll nëpërmjet denoncimeve nga publiku, të administruar gjatë gjykimit të çështjes, si dhe informacionin e përcjellë nga institucionet në përgjigje të kërkesës së trupit gjykues, brenda kufijve të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, konstatoi në terma të përgjithshëm disa problematika që u vlerësuan si të vlefshme për t'u trajtuar prej Kolegjit nën frymën e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si vijon.

Denoncimi i shtetasit I. H.

117. Denoncuesi I. H. ka paraqitur në Kolegj pesë denoncime ndaj subjektit të rivlerësimit, si dhe prokurorëve të tjerë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në të cilat, midis të tjerave, kërkon shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit për aftësitë profesionale, për shkak të vendimeve për pushimin dhe për mosfillimin e ndjekjes penale të procedimeve penale të regjistruara në bazë të kallëzimeve që ka bërë denoncuesi. Sipas denoncuesit, pavarësisht provave dhe fakteve, subjekti i rivlerësimit, në shkelje të ligjit, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***}, datë 17.09.2019, dhe mosfillimin e procedimeve penale nr. {***}, datë 21.11.2022, nr. {***}, datë 20.12.2022 dhe nr. {***}, datë 28.12.2022. Denoncuesi ka depozituar bashkë me denoncimet dhe kopje të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, lidhur me ankimet ndaj vendimeve të marra nga subjekti i rivlerësimit.
118. Lidhur me këto denoncime, subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e depozituara në Kolegj më datë 15.05.2023, ka prapësuar:

118.1. Procedimi penal nr. {***}, datë 17.09.2019, është regjistruar sipas kallëzimit të denoncuesit, në ngarkim të disa shtetasve, për kryerjen e veprës penale “Ndërtim i paligjshëm”, sipas nenit 199/a të Kodit Penal. Nga hetimet e kryera, ka rezultuar se denoncuesi për të njëjtin fakt kishte kryer një kallëzim tjetër penal, mbi bazën e të cilit ishte regjistruar procedimi penal nr. {***}, pushuar me vendimin e një prokurori tjetër. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 02.02.2021 ka vendosur pushimin e procedimit nr. {***}, pasi për të njëjtin fakt ishte disponuar më parë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Ky vendim i është njoftuar dhe denoncuesit, i cili nuk ka ushtruar ankim.

118.2. Lidhur me materialin kallëzues nr. {***}, datë 10.11.2022, sipas kallëzimit të denoncuesit për moskryerje të veprimeve procedurale nga disa punonjës të Komisarariatit të

Policisë Durrës, subjekti i rivlerësimit parashtron se vendimi i mosfillimit është marrë pasi, pas verifikimeve të kryera nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, kjo e fundit ka përcjellë materialet në prokurori, por pa kërkuar fillimin e ndjekjes penale ndaj punonjësve të policisë.

118.3. Në denoncimin nr. {***} prot., datë 16.01.2023, denoncuesi i referohet vendimit për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues me nr. {***}, datë 28.12.2022. Mosfillimi është vendosur me argumentin se për të njëjtin material kallëzues, ka pasur një vendimmarrje të mëparshme të prokurorit lidhur me mosfillimin për materialin kallëzues nr. {***}, datë 10.11.2022.

118.4. Për sa i përket denoncimit për vendimin e mosfillimit të procedimit penal për materialin kallëzues nr. {***}, datë 28.12.2022, regjistruar sipas kallëzimit të denoncuesit ndaj disa shtetasve, funksionarë publikë në Bashkinë Durrës dhe në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit pranë kësaj bashkie, subjekti i rivlerësimit parashtron se ky vendim është marrë pasi ka çmuar se faktet e kallëzuara nuk përbëjnë vepër penale.

118.5. Për denoncimin lidhur me vendimmarrjen e disa prokurorëve të Prokurorisë Durrës, përfshirë dhe vendimin e mosfillimit të procedimit penal për materialin kallëzues nr. {***}, datë 16.01.2023, subjekti i rivlerësimit sqaron se ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për shkak se faktet e kallëzuara janë të njëjta me faktet e paraqitura në kallëzimin e mëparshëm, regjistruar si material kallëzues nr. {***}.

119. Nga verifikimi i akteve të sjella nga denoncuesi bashkëlidhur denoncimit, si dhe nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të prapësimeve, trupi gjykues vëren se:

119.1. Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. {***}, datë 09.02.2023, mbi bazën e ankimit të shtetasit I. H., ka vendosur pranimin e ankimit të ankuesit kundër vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës “Për mosfillimin e procedimit penal lidhur me materialin kallëzues nr. {***}, datë 28.12.2022”, dhe shfuqizimin e këtij vendimi duke urdhëruar prokurorin të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme. Në këtë vendim, gjykata ka arsyetuar ndër të tjera se: *[...] e vlerëson të pabazuar vendimmarrjen e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal. Kjo për arsye se nga aktet e paraqitura nga prokuroria, rezulton se pas paraqitjes së kallëzimit penal, nuk është kryer asnjë veprim me qëllim verifikimin e pretendimeve të kallëzuesit I. H.. Pretendimi i prokurorisë se i njëjti kallëzim është trajtuar edhe më parë dhe për këtë arsye shtetasi I. H. ka qenë në dijeni të faktit se nuk ka fakt penal, është i pabazuar. [...] për të arritur në përfundimin se nuk jemi para veprës penale të deklaratave të rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore apo veprave të tjera penale të pretenduara nga kallëzuesi, prokuroria do të duhej të administronte në radhë të parë procesverbalet e deklarimit të oficerëve të policisë gjyqësore [...] një analizë e tillë nuk është kryer nga prokuroria dhe për këtë arsye edhe vendimmarrja lidhur me mosfillimin e procedimit*

penal, është e pabazuar [...] gjykata e vlerëson të pabazuar qëndrimin e prokurorisë lidhur me faktin se procedimi penal nuk duhet të fillohet pasi shtetasi I. H. e ka paraqitur kallëzimin penal për hakmarrje, duke kallëzuar fakte të pavërteta. Jo vetëm që një vlerësim i tillë s'mund të jetë kurrsesi një vlerësim subjektiv, pa realizuar një hetim objektiv dhe të gjithanshëm, por një arsyetim i tillë është kontradiktor në raport me vendimmarrjen për mosfillimin e procedimit. Kjo për arsye se nëse prokuroria ka vlerësuar se kallëzimi penal i paraqitur nga shtetasi I. H., është kallëzim i rremë, atëherë prokuroria nuk mund të merrte vendim mosfillimi, por duhet të regjistronte procedimin penal për veprën penale të parashikuar në nenin 305 të Kodit Penal.

119.2. Me vendimin nr. {***}, datë 15.02.2023, Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, mbi bazën e ankimit të shtetasit I. H. kundër vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës “Për mosfillimin e procedimit penal lidhur me materialin hetimor nr. {***},” ka vendosur pranimin pjesërisht të ankimit të ankuesit për punonjësit e IMT Bashkia Durrës dhe administratorin e Njësisë Nr. {***}, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe kryerjen e detyrave të caktuara nga gjykata. Në këtë vendim, gjykata ka arsyetuar ndër të tjera se: *lidhur me nëpunësit e IMT Durrës, gjykata vlerëson se nga provat e paraqitura nga pala ankuese, ka indicie se mund të kemi një veprë penale, por nga ana e prokurorit duhet të fillojnë hetime për të verifikuar disa prej pretendimeve të ankuesit.*

119.3. Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. {***}, datë 07.03.2023, mbi bazën e ankimit të shtetasit I. H., ka vendosur pranimin e ankimit të ankuesit kundër vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës “Për mosfillimin e procedimit penal lidhur me materialin kallëzues nr. {***}, datë 16.01.2023”, dhe shfuqizimin e këtij vendimi duke urdhëruar prokurorin të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme. Në këtë vendim, gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *e vlerëson të pabazuar vendimmarrjen e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal. Kjo për arsye se nga aktet e paraqitura nga prokuroria, rezulton se pas paraqitjes së kallëzimit penal, nuk është kryer asnjë veprim me qëllim verifikimin e pretendimeve të kallëzuesit. [...] për të arritur në përfundimin se nuk jemi para veprave penale të kallëzuara nga shtetasi I. H., apo përpara ndonjë veprë tjetër penale, prokuroria duhet të kryejë fillimisht të gjitha hetimet e nevojshme dhe konkretisht: 1. të administrojë të gjithë praktikën e mbajtur nga IMT-ja lidhur me konstatimin e ndërtimit të paligjshëm nga shtetasi S. P.; 2. të administrojë të gjithë praktikën e mbajtur nga IMT-ja lidhur me veprimet e kryera të zbatimit të vendimit administrativ [...]; 3. të verifikojë arsyet që janë parashtruar në procesverbalet e ekzekutimit të vendimit administrativ për mosmarrjen e masave për prishjen e objektit [...].*

119.4. Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. {***}, datë 12.05.2023, mbi bazën e ankimit të shtetasit I. H., ka vendosur pranimin e ankimit të ankuesit kundër vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës “Për mosfillimin e procedimit penal

lidhur me materialin kallëzues nr. {***}, datë 10.11.2022”, dhe prishjen e këtij vendimi duke urdhëruar prokurorinë të vazhdojë hetimin e çështjes, me veprimet hetimore të përcaktuara në arsyetimin e këtij vendimi penal. Në këtë vendim, gjykata ndër të tjera ka arsyetuar se: *vendimi i prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, datë 21.11.2022, “Për mosfillimin e procedimit penal që i përket kallëzimit penal nr. {***}, datë 10.11.2022”, nuk është marrë në interpretim të drejtë të ligjit material e procedural, për arsye se përpara se të arrinte në këtë përfundim, prokurori i çështjes duhet të kishte kryer edhe disa veprime të tjera hetimore për të arritur në një konkluzion të drejtë e të bazuar, [...] do të duhej të ishte administruar vendimi i gjykatës së apelit që ka shqyrtuar ankimin në mënyrë që të ishim para një vendimi gjyqësor të formës së prerë, i cili u jep zgjidhje edhe pretendimeve në lidhje me paligjshmërinë e arrestimit në flagrancë të kallëzuesit. Po ashtu, referuar deklarimeve, rezulton se ka kundërbërje të dukshme nëpërmjet pretendimeve të kallëzuesit dhe punonjësve të policisë, për sheshimin e tyre do të ishte e nevojshme dhe e dobishme që të hetohet në lidhje me sheshimin e tyre nëpërmjet ripyetjes së tyre dhe eventualisht edhe ballafaqimit të deklaruësve [...].*

120. Analiza e konstatimeve të mësipërme, të cilat rezultojnë të jenë qëndrime të gjykatës kompetente që ka kontrolluar veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit në mënyrën se si ai ka trajtuar disa nga kallëzimet e denoncuesit I. H., dëshmon për mangësi të përsëritura të subjektit lidhur me mënyrën e trajtimit të tyre. Panorama e situatës së prezantuar me një shqetësim të dukshëm prej denoncuesit, i cili rezulton se përpos tregimit të perceptimit të tij mbi punën e subjektit, paraqet edhe dokumentacionin që provon përdorimin e mekanizmave ligjore për të kundërshtuar këtë sjellje, evidenton, sipas vlerësimit të trupit gjykues, faktin se subjekti i rivlerësimit ka trajtuar në mënyrë të përsëritur kallëzimet penale të denoncuesit joprofesionalisht. Vlerësimi joprofesional i tyre, sipas konkluzioneve të vendimeve të gjykatës, duket se ka cenuar dhe pamundësuar denoncuesin të sigurojë mbrojtjen ligjore, si një e drejtë që i garantohet çdo shtetasi, nga veprimet e denoncuar si në kundërshtim me ligjin. Trupi gjykues, pa i hyrë vendimmarrjes së subjektit, e pa vlerësuar cilësinë e veprimtarisë procedurale të kryer prej tij, në respektim të kufizimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, gjithsesi mban në konsideratë se, për këtë shkak, duket se së paku denoncuesi I. H. është dashur të ripërballet me organin e prokurorisë, për të rivlerësuar denoncimet e tij, të paktën katër herë, konsideruar vetëm vendimet e subjektit të rivlerësimit, të konsideruara të padrejta e të shfuqizuara nga gjykata, situatë e cila dëshmon për cenim të të drejtave të qytetarëve për shkak të mangësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.
121. Sa më sipër, lidhur me denoncimet e z. I. H., trupi gjykues konstaton nga një analizë edhe thjesht statistikore e qëndrimeve të gjykatës në raport me vendimmarrjet e subjektit të rivlerësimit, të cilat në katër raste kanë vendosur prishjen e vendimeve për mosfillim të procedimeve penale për kallëzimet e paraqitura prej këtij shtetasi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Durrës, më së paku se subjekti ka reflektuar një sjellje profesionale sipërfaqësore e jo në përmbushje të detyrës, duke afektuar të drejtat e kallëzuesit të paktën nëpërmjet mosveprimit të organit të akuzës.

Denoncim i shtetasit S. K.

122. Denoncuesi S. K., në denoncimin e paraqitur në Kolegj, regjistruar me nr. {***} prot., datë 28.03.2023, referon për një procedim penal të regjistruar në emër të shtetasit P. T., me nr. {***}, datë 04.08.2017, për veprën penale "Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtari kriminale". Sipas denoncuesit, megjithëse kanë kaluar më shumë se 5 vjet, nga ana e prokurorit të ngarkuar për hetimin e kësaj çështjeje, subjektit të rivlerësimit, çështja po zvarritet në mënyrë të pajustificuar, jashtë çdo afati hetimor.
123. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar gjatë seancave gjyqësore të zhvilluara në Kolegj se më datë 22.10.2020, është vendosur pezullimi i procedimit penal nr.{***}, në pritje të ndihmës juridike nga autoritete gjyqësore belge dhe italiane. Hetimet kanë rifilluar më datë 25.07.2022, pas mbërritjes së letërporosisë nga autoritetet italiane, dhe nga ky moment janë kryer një sërë veprimesh të tjera hetimore, dhe çështja është ende nën hetim në pritje të letërporosisë nga autoritetet belge. Subjekti i rivlerësimit ka prapësuar në Kolegj se pretendimet e ngritura nga denoncuesi janë të pabazuara dhe kanë marrë përgjigje nga vendimet gjyqësore, të cilat ai vetë i ka bashkëlidhur denoncimit të tij. Për këtë çështje, si dhe për të gjitha çështjet objekt i denoncimeve, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji që duhet të mbajë në konsideratë ngarkesën e lartë në punë për shkak dhe të mungesës së prokurorëve në organikën e prokurorisë në periudhën kur kanë qenë në shqyrtim çështjet objekt verifikimi, si edhe faktin që çështja është ende në shqyrtim.
124. Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2017, për veprën penale "Pastrim i produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale", të cilit i referohet denoncuesi, nga aktet e administruara në Kolegj sipas kërkesës, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, rezulton se:
 - 124.1. Çështja penale nr. {***} është regjistruar mbi materialet referuese të Drejtorisë së Policisë Vendore Durrës në datën 15.09.2017, për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", në ngarkim të shtetasit P. T..
 - 124.2. Me urdhrin për delegimin dhe kryerjen e veprimeve hetimore të datës 19.09.2017, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar kryerjen deri më datë 20.12.2017 të disa veprimeve hetimore, si kërkesa për informacion në banka, kërkesë për informacion në DPP, si dhe në Interpol, kërkesë për informacion në tatime dhe dogana, në QKB, ZRPP, ALUIZNI, DPT Rrugor, marrje aktesh dhe pyetje familjarësh, kryerje ekspertimi financiar, si dhe përgatitje letërporosie.

124.3. Me kërkesën nr. {***} prot., datë 17.07.2019 dhe me kërkesën nr. {***}, datë 17.09.2020, u është kërkuar ndihmë juridike autoriteteve gjyqësore italiane, kurse me kërkesën nr. {***}, datë 17.09.2020, është kërkuar ndihmë juridike prej autoriteteve belge.

124.4. Më datë 22.10.2020, subjekti ka vendosur pezullimin e procedimit penal nr. {***}, në pritje të ndihmës juridike nga autoritetet gjyqësore italiane dhe belge.

124.5. Me vendimin e datës 13.07.2022, subjekti i rivlerësimit ka vendosur rifillimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***}, në kushtet kur nga Ministria e Drejtësisë, me shkresat nr. {***}, datë 23.08.2021 dhe nr. {***} datë 22.07.2021, është përcjellë letërporosia dërguar autoriteteve italiane, të cilat kanë informuar se shtetasi P. T. është dënuar për shfrytëzim prostitucioni në bashkëpunim.

124.6. Veprimet hetimore nga momenti i rifillimit të hetimit, sipas vendimit për delegimin e kompetencave të datës 25.07.2022, kanë vazhduar me analizimin e letërporosisë, këqyrjen dhe marrjen e kopjeve të dokumentacionit që ndodhet në hetimin pasuror nr. 2 të vitit 2020, në ngarkim të shtetasit P. T., kryerjen e ekspertimit teknik-kontabël, si dhe këqyrjen e pasurive të paluajtshme të regjistruara në emër të këtij shtetasit dhe familjarëve të tij. Këto veprime, sipas vendimit, duhet të kryhen deri në datën 25.01.2023.

124.7. Kryerja e ekspertimit teknik kontabël¹⁵, sipas vendimit të prokurorit të datës 13.03.2023, është vendosur me qëllim që t'u jepet zgjidhje pyetjeve të lindura nga hetimi. Ekspertja kontabël, më datë 12.05.2023, ka bërë kërkesë për shtyrjen e afatit të dorëzimit të aktit të ekspertimit minimalisht dhe 60 ditë, për shkak të verifikimeve shumë komplekse.

124.8. Këqyrja dhe marrja e kopjeve të hetimit pasuror nr. 2, në ngarkim të P. T., është bërë me vendimin e datës 24.02.2023.

124.9. Veprimi i fundit hetimor, këqyrja dhe marrja në e-albania e kopjeve të certifikatave familjare dhe personale të shtetasve P. T. dhe S. T., është kryer në datën 23.05.2023¹⁶.

125. Nga analiza e veprimtarisë hetimore të kryer nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë çështje, pa shqyrtuar cilësinë apo logjikën e hetimit, për shkak të kufizimit të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues konstaton se hetimet paraprake lidhur me këtë procedim penal, kanë zgjatur tej afateve të arsyeshme, duke cenuar parimin e sigurisë juridike për shtetasit e përfshirë në to. Ndonëse për shkak të faktit se emri i të dyshuarit që ka kryer veprën penale nuk është shënuar në regjistrimin e njoftimeve të veprave penale, siç parashikon neni 287, paragrafi i dytë

¹⁵ Ekspertim kontabël është bërë dhe me vendimet e datave 12.09.2018 dhe 22.11.2021.

¹⁶ Sipas kërkesës nr. {***} prot., datë 22.09.2017, të Prokurorisë Durrës, Bashkia Durrës, me shkresën nr. {***}, datë 05.10.2017, ka dërguar certifikatat familjare dhe personale për familjen T..

i Kodit të Procedurës Penale, edhe pse ka qenë e qartë që në referimin e veprës se i dyshuari ishte shtetasi P. T., dhe kjo rrethanë shmang referimin të një afat procedural për t'u respektuar, sërish subjekti i rivlerësimit duket se ka përfituar nga kjo hapësirë ligjore, për të zgjatur tej afateve të arsyeshme hetimin e kësaj çështjeje. Në datat e përmendura më lart, trupi gjykues konstaton periudha të gjata kohore, rreth një vit, por edhe më tepër [12.09.2018 deri në 18.07.2019, 18.07.2019 deri në 17.09.2020, 25.08.2021 deri në 13.07.2022], brenda të cilave subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim hetimor, ndërsa konstaton edhe përsëritje të veprimeve hetimore apo trajtimin si të tilla të veprimeve që thjesht mundësojnë aksesimin në databazat e të dhënave publike apo zyrtare, të cilat vlerësohet se nuk kërkojnë një kohë të dedikuar për t'u konsideruar brenda harkut kohor të gati 6 viteve që zgjasin hetimet. Pasja e një procedimi penal nën hetim për një kohë kaq të gjatë, për më tepër që ai nuk paraqet tipologji të ndërlikuar për sa u përket hetimeve me natyrë zbuluese, por ka tiparet e një hetimi historik që synon mbledhjen e dokumentacionit, konsiderohet nga trupi gjykues se dëshmon për mangësi të subjektit të rivlerësimit lidhur qoftë me aspektin e njohurive ligjore, atyre organizative, por edhe atyre që lidhen me etikën e magjistratit, të cilat kanë cenuar të drejtat e qytetarëve. Evidentimi i mungesës së veprimitarisë hetimore të subjektit për periudha të gjata e pa arsye të përligjura, demonstrojnë mungesë të angazhimit e përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksioneve, në kundërshtim me parashikimet e nenit 75, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Kjo sjellje e magjistratit ka shkaktuar zgjatjen e paarsyeshme të hetimeve për këtë procedim penal, e cila në vetvete, mbetet e papërligjur në asnjë rrethanë dhe prodhon gjithsesi një perceptim negativ të publikut, matur nga syri i një vëzhguesi të zakonshëm, në drejtim të funksionimit të organit të akuzës. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për ngarkesë të lartë në punë, nuk mundën gjithsesi të justifikojnë në asnjë rast shtrirjen e hetimeve në harkun kohor të gjashtë viteve, duke cenuar thelbin e veprimitarisë hetimore dhe duke e shndërruar atë një proces abuziv.

126. Në konkluzion, lidhur me këtë denoncim, nga aktet e analizuara më sipër, trupi gjykues vëren se nga një vëzhgim i kronologjisë së veprimeve hetimore të kryera prej subjektit dhe pa vlerësuar ligjshmërinë e veprimitarisë apo logjikën e hetimit, konstatohen periudha kohore relativisht të gjata, në të cilat subjekti nuk ka kryer asnjë veprim procedural, të cilat duket se, përpos të tjerave, kanë ndikuar në zgjatjen e afateve të hetimeve paraprake, që prej vitit 2017, pa arritur ende një përfundim lidhur me to, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtat e individëve për të pasur hetime në një kohë të arsyeshme, pavarësisht statusit ligjor të tyre.

Denoncim i shtetasve A. G., B. Xh. etj., banorë të pallatit nr. {}, lagjja nr. {***}, Durrës***

127. Nga verifikimi i akteve të administruara në Kolegj, pas informacionit të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, trupi gjykues konstaton se procedimi penal është regjistruar më datë 06.12.2019, dhe subjekti i rivlerësimit Bledar Bejko është caktuar si prokuror i çështjes në datën 05.07.2021, sipas vendimit të zëvendësimit të drejtuesit të

Prokurorisë. Gjatë periudhës që çështja është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, janë kryer veprimet si në vijim.

128. Me urdhrin mbi delegimin dhe kryerjen e veprimeve hetimore, datë 06.09.2021, subjekti ka urdhëruar: *Të administrohet akti i ekspertimit teknik nga ekspertët e IN Tiranë. Të bëhet diskutim mbi veprime dinamike pas administrimit të aktit. Të kryhet çdo veprim tjetër i nevojshëm për hetimin e këtij procedimi penal.*

128.1. Me shkresën nr. {***}, datë 06.12.2021, të drejtueses së Prokurorisë Durrës, drejtuar Institutit të Ndërtimit Tiranë, është tërhequr vëmendja se megjithëse në datën 18.01.2021 është vendosur kryerja e ekspertimit teknik dhe janë caktuar ekspertët, ende nuk është dërguar akti i ekspertimit, duke u bërë shkak për zvarritje të paligjshme. Me këtë shkresë, kërkohet paraqitja fizike e ekspertëve së bashku me aktin, më datë 15.12.2021, në zyrën e prokurorit Bledar Bejko. Akti i ekspertimit rezulton të jetë dorëzuar në Prokurorinë Durrës nga Instituti i Ndërtimit më datë 16.12.2021, 11 muaj pasi është kërkuar nga prokuroria.

128.2. Pas administrimit të aktit të ekspertimit, me urdhrin e datës 22.12.2021, subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se duhen kryer veprime shtesë, duke urdhëruar: *Të kryhet këqyrje e të dhënave të IGJEUM, mbi parametrat e tërmetit. Të bëhet vendim riekspertimi teknik shtesë mbi ndërtimin e kryer shtesë. Të administrohet akti i ekspertimit shtesë; Të kryhet çdo veprim tjetër i nevojshëm për hetimin e këtij procedimi penal. Këto veprime të kryhen brenda datës 30.03.2022.*

128.3. Me vendimin për këqyrjen e dokumenteve të datës 29.03.2022, subjekti i rivlerësimit, me qëllim që të zbulohen prova të reja, ka vendosur të bëhet këqyrje/marrje në dosjet hetimore {***} në Prokurorinë Durrës. Sipas procesverbalit të datës 15.04.2022, është bërë këqyrja e akteve dhe është marrë shkresa e IGJEUM-it e datës 06.01.2020, drejtuar Prokurorisë Durrës, me të cilën është përcjellë raporti mbi parametrat e ngjarjeve sizmike të datave 25-26.11.2019.

128.4. Me vendimin e datës 26.07.2022, subjekti i rivlerësimit ka vendosur kryerjen e një ekspertimi teknik shtesë për ndërtimin rreth kafazit të ashensorit dhe përgjatë ½ së sipërfaqes së objektit, si dhe për ndërtimin shtesë papafingo në pallat. Afati i lënë për kryerjen e ekspertimit teknik shtesë, ka qenë brenda datës 15.09.2022. Sipas akteve, ky ekspertim është dorëzuar nga Instituti i Ndërtimit dhe protokolluar në Prokurorinë Durrës 6 muaj më vonë, në datën 28.03.2023.

128.5. Sipas kërkesës së drejtueses së Prokurorisë Durrës, nga Bashkia Durrës, me shkresën nr. {***}, datë 05.05.2023, është dërguar vendimi i Këshillit Bashkiak Durrës nr. {***}, datë 25.02.2022, më të cilin është vendosur prishja e detyruar e disa objekteve, midis tyre dhe e pallatit me {***} kate, godina nr. {***}, lagjja nr. {***}.

129. Trupi gjykues, në analizë të akteve që pasqyrojnë veprimet hetimore të përmendura më sipër, si dhe pas shqyrtimit të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, vlerësoi se faktet e pretenduara në këto denoncime nuk mund të konsiderohen relevante në lidhje me kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, meqenëse duket se zgjatja e hetimeve për një kohë të gjatë nuk i dedikohet vetëm veprimtarisë hetimore të subjektit të rivlerësimit, por edhe të prokurorëve të tjerë, rrethana që e bëjnë të vështirë evidentimin e përgjegjësisë për secilin prej tyre.

Denoncim i shtetas A. Z.

130. Në denoncimin e saj, avokatja A. Z., përfaqësuese ligjore e znj. A. Xh., ankohet për zvarritjen e procesit gjyqësor të çështjes penale nr. {***}, në të cilën organi i akuzës është përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit. Sipas ankueses, subjekti i rivlerësimit nuk është paraqitur në disa seanca gjyqësore, mungesë që ka bërë që seanca paraprake të jetë shtyrë për gati një vit, duke cenuar zhvillimin e gjykimit sipas një afati të arsyeshëm.

131. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë denoncim, në prapësimet e paraqitura në Kolegj ka parashtruar se pretendimet e ngritura nga denoncuesja janë të pabazuara, pasi mungesa në disa seanca gjyqësore ka qenë e justifikuar, ashtu si dhe i është bërë me dije denoncueses nga kryesuesja e seancave gjyqësore.

132. Nga aktet e administruara, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, konstatohet se në shkresën nr. {***}, datë 01.06.2023, që Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, i ka dërguar Prokurorisë Durrës, informon se nga verifikimet e kryera në sistemin ICMIS, rezulton se:

(i) Në datën **15.04.2022**, në seancën paraprake për çështjen penale nr. {***}, planifikuar për t'u zhvilluar në orën 10:30, prokurori i çështjes, subjekti i rivlerësimit, *nuk ka qenë i pranishëm*. Sipas procesverbalit të seancës, prokurori ka njoftuar gjykatën se ndodhet në gjykim tjetër për caktimin e një mase sigurie. Në seancën për caktimin e masës së sigurisë, për çështjen nr. {***}, planifikuar për t'u zhvilluar në orën 10:45 dhe çelur në orën 10:44, prokurori ka qenë i pranishëm.

(ii) Në datën **06.06.2022**, në seancën për çështjen penale nr. {***}, planifikuar për t'u zhvilluar në orën 13:30, subjekti i rivlerësimit *nuk ka qenë i pranishëm*. Sipas procesverbalit të seancës, subjekti i rivlerësimit është njoftuar, por nuk ka paraqitur asnjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitjen e tij në gjykim. Gjithashtu, edhe në seancën për çështjen penale nr. {***}, planifikuar për t'u zhvilluar në orën 13:30, subjekti i rivlerësimit *nuk ka qenë i pranishëm*. Në përgjigjet e pyetjeve të relatores, të dorëzuara në seancën e datës 17.05.2023 në Kolegj, subjekti ka parashtruar se në të njëjtën orë që ka qenë e planifikuar seanca për çështjen {***}, në të cilën nuk ka marrë pjesë, pasi për shkak të kompleksitetit të çështjes, si dosje e ardhur nga Krimet e Rënda, ka çmuar të përgatisë dhe studiojë aktet e dosjes gjyqësore.

(iii) Në datën **06.12.2022**, në seancën për çështjen penale nr. {***}, planifikuar për t'u zhvilluar në orën 11:15 dhe çelur në orën 13:42, subjekti i rivlerësimit *nuk ka qenë i pranishëm*. Nga procesverbali i seancës, rezulton se gjykata është shprehur se: *Jemi në kushtet kur prokurori nuk është paraqitur për shkak të mbylljes së rrugës nga Tirana në Durrës, e ka pasur të pamundur paraqitjen sot*. Në përfundim të seancës, gjykata ka vendosur të caktojë avokatin kryesisht, pasi avokatja e caktuar më parë e të pandehurit ka dhënë dorëheqjen.

(iv) Në aktet e dërguara nga Prokuroria Durrës, janë dhe procesverbalet e seancave të datave 03.10.2022, 16.11.2022 dhe 13.02.2022. Nga këto procesverbale, rezulton se seancat e datave 03.10.2022 dhe 16.11.2022, në të cilat subjekti ka qenë prezent, janë shtyrë për shkak se i pandehuri nuk ka pasur avokat mbrojtës. Ndërsa nga procesverbali i seancës së datës 13.02.2023, rezulton se subjekti nuk ka qenë prezent dhe se ka njoftuar sekretarinë gjyqësore se aktualisht ndodhet në një seancë mase sigurimi, e cila zgjat në kohë.

133. Në konsideratë të rrethanave të përshkruara më sipër, trupi gjykues konstaton mungesën e pajustificuar të subjektit të rivlerësimit, me cilësinë e prokurorit të çështjes, në tri seanca gjyqësore të caktuara për shqyrtimin e kërkesës së prokurorit për dërgimin në gjyq të procedimit penal në ngarkim të shtetasit P. K.. Sipas akteve të administruara në Kolegj, rezulton se subjekti nuk është paraqitur në seancën e datës 06.06.2023, pa deklaruar asnjë arsye para gjykatës për mungesën. Ai nuk rezulton të jetë paraqitur as në seancën e caktuar po në këtë ditë për gjykimin e një çështjeje tjetër penale, seanca të caktuara në të njëjtën datë, për shkak të mosrakovitit të orareve gjyqësore. Shpjegimi i prokurorit se ai ka qenë duke studiuar një çështje tjetër të ardhur për kompetencë nga Prokuroria e Krimeve të Rënda (Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar), nuk është një shkak i arsyeshëm. Prokurori ka për detyrë të organizojë punën dhe veprimtarinë e tij në funksion të kryerjes në kohë të veprimtarisë procedurale, brenda së cilës pjesëmarrja dhe përfaqësimi i akuzës në gjykim, është një veprim që gëzon prioritet në aktivitetin e përgjithshëm të veprimtarisë procedurale, krahas veprimeve që kanë një afat për kryerjen e tyre. Nga procesverbali i seancës së datës 06.12.2022, rezulton se gjyqtarja ka referuar mungesën e prokurorit, duke përmendur se ai ka qenë në pamundësi për t'u paraqitur për shkak të mbylljes së autostradës Durrës-Tiranë, rrethanë e cila duhet të ishte administruar nga subjekti i rivlerësimit për të mos lejuar shtyrjen e një seance gjyqësore, që për më tepër nuk ishte e para që caktohej për të njëjtën kërkesë. Kalimi rrugor nëpërmjet autostradës Durrës-Tiranë, nuk rezulton të jetë e vetmja mënyrë për të arritur në qytetin e Durrësit dhe subjekti kishte detyrimin të merrte masat për të siguruar ushtrimin e funksioneve të tij. Në seancën e datës 13.02.2023, rezulton sërish se gjyqtarja e çështjes ka referuar për mungesën e prokurorit me shënimin se ai ka njoftuar se gjendet në një masë sigurimi që zgjat. Nga aktet, nuk rezulton që ky fakt i pasqyruar në procesverbal, të provohet me ndonjë dokument që tregon zhvillimin e një seance tjetër gjyqësore në këtë datë dhe orë, për pasojë ai mbetet në nivelin deklarativ. Në seancën e datës 20.04.2023, gjyqtarja e seancës paraprake ka vendosur të pranojë kërkesën e prokurorit dhe të dërgojë për gjykim çështjen penale, mbas një viti nga dita kur

kërkesa për gjykim ishte paraqitur në gjykatë, duke e zgjatur këtë proces që ligji ka parashikuar se duhet të jetë i shpejtë dhe të zhvillohet brenda 30 ditëve, tej çdo limiti për respektimin e afateve procedurale dhe në dëm të interesave të palëve ndërgjyqëse.

134. Trupi gjykues, sa më sipër, arrin në përfundimin se provohet mungesa e pajustificuar e subjektit të rivlerësimit në disa seanca gjyqësore, fakt që ka ndikuar, ndër të tjera, në zgjatjen prej një viti të gjykimit të një kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq. Kjo zgjatje është në shkelje të çdo parashikimi ligjor për afatet e gjykimit të kësaj kërkesë sipas parashikimit të nenit 332, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale¹⁷.
135. Problematikat e konstatuara në analizë të denoncimeve të ardhura për subjektin e rivlerësimit, krahas atyre të konstatuara në analizë të shkaqeve të ankimit që i adresoheshin kriterit të vlerësimit të pasurisë, e çojnë trupin gjykues në konkluzionin se lidhur me këtë kriter, mangësitë profesionale të evidentuara në veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit, nuk mund të shërohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës.
136. Trupi gjykues i Kolegjit, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vlerësoi në mënyrë të përgjithshme të tria kriteret e rivlerësimit për subjektin, bazuar në konkluzionet e mësipërme për të gjitha çështjet e marra në shqyrtim në këtë gjykim. Shkeljet dhe problematikat e konstatuara në drejtim të secilit prej kriterëve, të vlerësimit të pasurisë, të dhënave që vijnë nga kryerja e kontrollit të figurës, por që përfshihen në analizë të shkeljeve të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe të mangësive që rezultuan në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, së bashku me mangësitë e konstatuara prej vlerësimit të denoncimeve nga publiku, e çuan Kolegjin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit e ka cenuar me sjelljen e tij profesionale, por edhe për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë, besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Jo rastësisht, në vlerësimin e trupit gjykues, konstatohet se pothuaj të gjitha problematikat e konstatuara në kriterin e aftësive profesionale janë prezantuar nëpërmjet denoncimeve publike, të cilat kanë rezultuar të drejta pas hetimit të organeve të rivlerësimit. Përsa përfaqëson këto mangësi në vlerësimin tërësor të subjektit, është e tillë që e bën të pamundur riparimin e tyre nëpërmjet programit të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës dhe, si rrjedhojë, Kolegji konkludoi se vazhdimi i ushtrimit prej tij të funksioneve të prokurorit do të ishte i papërshtatshëm dhe në kundërshtim me qëllimin dhe parashikimet e nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe, për pasojë, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duhet vendosur shkarkimi i tij nga detyra.
137. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues çmon se vendimi i Komisionit nr. 535, datë 26.05.2022, duhet ndryshuar pasi nuk gjendet i drejtë e i bazuar në fakte, prova dhe ligj.

¹⁷ Gjykata vendos mbi kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të saj.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 535, datë 26.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Bledar Bejko.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 26.06.2023, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi - kundër

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e relatores së çështjes, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, kam votuar kundër kërimit të ankimit të Komisionerit Publik dhe vendimit nr. 25, datë 26.06.2023, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim Kolegji), që ka vendosur ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Si relatore kam propozuar ndryshimin e vendimit nr. 535, datë 26.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim "Komisioni"), pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Bledar Bejko për një periudhë 1-vjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës, bazuar në nenet E, pika 3 dhe Ë, pika 1 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 44, shkronja "b", dhe 66, pika 1, shkronja "b" të ligjit nr. 84/2016, për arsyt si më poshtë.

Lidhur me kriterin e pasurisë

2. Për pasurinë apartament, me sip. 96,5 m², në {***}, {***}, Tiranë, Komisioni, ka konkluduar se: *"[...] deklaratimet e subjektit edhe në eventualitetin e çmuarjes si pasaktësi të deklaratimit të tij, për sa kohë kjo e fundit nuk rezultoi e shoqëruar me mungesë financiare, pra, nuk passjell asnjë pasojë, nuk mund të përbëjnë shkak për penalizimin e tij. Në një vlerësim tërësor të të gjitha rrethanave të rezultuara, si gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe gjatë atij shtesë, në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues çmoi se subjekti ka shpjeguar dhe provuar bindshëm burimet e krijimit të saj¹".*
3. Komisioneri Publik në ankim vlerëson se: *"Mosdeklarimet në deklaratat periodike vjetore, deklaratimet e pasakta dhe kontradiktore në deklaratën vetting dhe gjatë hetimit administrativ, mbi burimin financiar që ka shërbyer për shlyerjen e parakohshme të kredive në shumën totale 9.000 euro, çojnë në pamundësi për të verifikuar se cilat nga deklaratimet e subjektit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike, lidhur me burimin e të ardhurave për shlyerjen e kësaj shume. Pasaktësitë në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit e bëjnë, në këtë rast, deklaratimin e tij të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa "a", si dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016".*
4. Shumica në vendim, në paragrafin nr. 43, për këtë pasuri ka konkluduar se: *"Në përfundim, për pasurinë apartament, me sip. 96,5 m², trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë të burimit të shlyerjes së dy kredive konsumatore të marra prej tij në vitin 2008, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja "a" të ligjit nr. 84/2016, pasaktësi e cila, për shkak të identifikimit të një burimi tjetër financimi përgjatë hetimit*

¹ Paragrafi 2.45 i vendimit të Komisionit.

administrativ, ka pamundësuar kontrollin e të ardhurave të ligjshme të përdorura për shlyerjen e parakohshme të kredive”.

Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues kam vlerësuar se:

5. Lidhur me pretendimin e Komisionerit, të pranuar nga shumica e trupit gjykues në vendim, se subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në 2008 dhe as në deklaratën *vetting* kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “{***}” ShPK, pagesën në shumën 20.000 euro, të kryer në prill të vitit 2008, si dhe burimin e krijimit të saj, në kushtet kur shuma e kthyer nga kjo shoqëri ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka sqaruar në Komision se si burim i shumës 20.000 euro janë 11.000 euro të dhëna nga babai dhe 9.000 euro nga dy kreditë konsumatore të marra në datën 23.04.2008, në “Tirana Bank”, nga subjekti në vlerën 4.000 euro dhe nga bashkëshortja në vlerën 5.000 euro. Rezulton e provuar se dy kreditë konsumatore janë shlyer brenda vitit 2008, me burim nga paratë e dhëna subjektit të rivlerësimit nga prindërit e tij (bazuar në deklaratimet gjatë hetimit në Komision). Pavarësisht se subjekti nuk e ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “{***}” ShPK, revokimin e saj, si dhe kthimin e shumës prej 20 mijë eurosh (në një hark kohor prej disa muajsh brenda vitit 2008), ai ka deklaruar saktë burimin e krijimit të shumës 20.000 euro, si dhe të apartamentit me sip. 96,5 m² (në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën periodike vjetore 2008). Dy kreditë konsumatore prej 9.000 euro dhe 11.000 euro të dhëna nga babai i subjektit kanë shërbyer njëkohësisht si burim për shumën 20.000 euro, paguar shoqërisë “{***}” ShPK, dhe pas kthimit të kësaj shume në rrugë bankare edhe si burim për blerjen e apartamentit. Vlerësoj se marrëdhënia kontraktore me shoqërinë “{***}” ShPK, e cila është krijuar dhe revokuar brenda vitit 2008, nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike për subjektin, të cilën ai do të ishte i detyruar ta deklaronte në kuptim të ligjit në deklaratën periodike vjetore dhe veçanërisht në deklaratën *vetting*.
6. Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrimin për t’i deklaruar këto kredi meqenëse veprimet për marrjen dhe shlyerjen e tyre janë kryer brenda vitit 2008, pra, detyrimi kontraktual me bankën ka lindur dhe është shuar brenda vitit, duke mos pasqyruar detyrimin për deklarim në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008. Në këtë deklaratë periodike, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë”, përcaktohej se subjekti duhet të deklarojë *detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë (kredi, huamarrje, detyrim për studime etj.) që ekzistojnë brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të mbetura ende pa u shlyer për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit [...]*. Sa më lart arsyetuar, mosdeklarimi në deklaratën periodike të vitit 2008 i dy kredive, që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit, nuk duhet të ndikojë në vlerësimin përfundimtar lidhur me burimin e të ardhurave për shlyerjen e shumës së kredive. Rezulton që subjekti i ka deklaruar këto kredi në deklaratën *vetting* si burime për krijimin e apartamentit. Gjithashtu, subjekti arrin të provojë me dokumentacion marrjen e dy kredive konsumatore dhe në deklaratën periodike të vitit 2008 ka

deklaruar qartësisht se prindërit i kanë dhënë 57.000 euro. Në këtë shifër ai ka përfshirë dhe shumën e dhënë nga babai për shlyerjen e dy kredive konsumatore të marra po në këtë vit.

7. Lidhur me mospërputhjen midis deklarimeve në deklaratën *vetting* dhe gjatë hetimit në Komision të burimit për shlyerjen e 2 kredive konsumatore, subjekti në Komision dhe në Kolegj është shprehur se është një lapsus nga ana e tij, dhënë në deklaratën *vetting*, fjalia që “kredia u shlye nga fondet të familjes së R.R.B”, dhe se ai gabimisht ka shënuar që është shlyer nga prindërit e bashkëshortes, ndërkohë që, ashtu siç deklarohet në DPV-në e vitit 2008, shuma e dhuruar është 57.000 euro. Pra, rezulton se në vitin 2008 subjekti ka deklaruar shumën 57.000 euro të dhënë nga prindërit, ndërsa në deklaratën *vetting* është po kjo shumë, por e ndarë në 47.000 euro dhënë nga prindërit ndërsa 10.000 euro janë transferuar nga llogaria e Bledar Bejkos pranë “Tirana Bank” (këto fonde janë me burim 9.000 euro kredi + 1.000 euro nga babai). Vlerësoj se qëndron pretendimi i subjektit se shlyerja e kredisë me burim të ardhurat nga prindërit provohet dhe nga arkëtimi i shumës 5.000 euro në datën 05.06.2008, në llogarinë e R. R., me burim dhurimin e prindërve të Bledar Bejkos me të cilën është shlyer kredia konsumatore² dhe se përbën lapsus shënimi kredia është shlyer nga prindërit e bashkëshortes. Pavarësisht nga deklarimi i subjektit në deklaratën *vetting*, nga të dhënat faktike rezulton e provuar se shlyerja e kredive është bërë nga shuma 57.000 euro, dhënë nga babai i subjektit.
8. Vlerësoj të paargumentuar në arsyetim të vendimit e madje përtej shkaqeve të ankimit të Komisionerit, që çon në rëndimin e pozitës së subjektit të rivlerësimit, konkludimin e shumicës se subjekti gjatë hetimit administrativ ka identifikuar një burim tjetër financimi të pasurisë që ka pamundësuar kontrollin e të ardhurave të ligjshme të përdorura për shlyerjen e parakohshme të kredive. Në këto kushte e vlerësoj të pabazuar në ligj dhe në fakte konkluzionin në vendim se për pasurinë apartament, me sip. 96,5 m², subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të burimit të shlyerjes së dy kredive konsumatore të marra prej tij në vitin 2008, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
9. Në përfundim, për sa i përket vlerësimit të burimit të të ardhurave për shlyerjen e dy kredive, pavarësisht lapsusit në deklaratën *vetting*, nga shumica e trupit gjykues duhet të mbaheshin në konsideratë deklaramet e subjektit të rivlerësimit në vitin 2008, për dhënien e shumës 57.000 euro nga babai, po ashtu dhe në deklaratën *vetting*, shumë e cila është pranuar në Komision, si dhe nuk është kundërshtuar nga Komisioneri Publik si e ardhur e ligjshme e babait, duke konsideruar këtu dhe shumën për shlyerjen e dy kredive konsumatore. Për rrjedhojë, deklarimi i subjektit është i saktë dhe me burimet e ligjshme financiare, në përputhje me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

² Sipas prapësimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj rezultateve hetimore.

10. Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *“(i) nga hetimi administrativ nuk rezultoi që subjekti të ketë përdorur apo përfiturar të ardhura nga shitja e këtij automjeti; (ii) vlera e blerjes së automjetit, së bashku me të gjitha taksat dhe detyrimet doganore mbi çmimin e blerjes së tij, përbëjnë shumën totale të dhëna nga shtetasi I.V., sipas deklaratës noteriale; (iii) konfirmohet fakti se i njëjti noter ka hartuar dhe nënshkruar aktet noteriale, përfshirë edhe deklaratën për dhënien e shumës 2.000.000 lekë subjektit për blerjen e automjetit, kontratën e shitjes në favor të shtetasit I. V. për shumën 500.000 lekë dhe se kjo vlerë e shënuar në kontratën e shitjes duket se nuk ka ndikuar në shmangien e ndonjë takse apo detyrimi doganor, pasi DPSHTRR-ja ka konfirmuar regjistrimin e automjetit në emër të shtetasit I.V. dhe njëkohësisht deklarata e këtij të fundit konfirmon marrëveshjet e bëra dhe në asnjë rast nuk rezulton të kenë lindur pretendime mes palëve, konkludon se në gjendjen faktike të kësaj çështjeje përjashtohet çdo rrethanë përfituese nga subjekti si shmangia nga ndonjë detyrim tatimor, për sa kohë pronari real i këtij automjeti është shtetasi I.V. Në të tilla kushte nuk identifikohen fakte apo rrethana që mund të passillnin një vlerësim ndryshe për penalizimin e subjektit”.*
11. Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës, pasi nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2007 blerjen, burimin e krijimit, shitjen dhe as të ardhurat e realizuara nga shitja e këtij automjeti. Komisioneri Publik vlerëson se qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, në drejtim të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të përcjellë në lidhje me këtë pasuri të luajtshme, e bëjnë deklarinë e subjektit të rivlerësimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
12. Shumica në vendim, për këtë pasuri, në paragrafin nr. 50 shprehet se: *“Në përfundim, për pasurinë automjet tip “Daimler Chrysler”, E270 CDI, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit është jo bindës në shpjegimet e tij lidhur me natyrën e transaksionit të kryer në vitin 2007 për blerjen dhe shitjen e kësaj pasurie. Ai nuk rezulton të ketë bërë deklarime në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 për këtë pasuri të luajtshme të regjistrueshme në regjistrat publikë e cila, më së paku formalisht, është fituar dhe tjetërsuar prej tij nëpërmjet veprimeve juridike të blerjes dhe shitjes së pasurisë e të pasqyruara në kontratat formale të shitjes. Kontradiktat në elementët e çmimit të këtij transaksioni të evidentuara në kontratat respektive të shitjes dhe blerjes, në mungesë të deklarimeve në kohën e kryerjes së transaksionit, mbeten elementë të cilët pasqyrojnë një problematikë që meriton të vlerësohet prej Kolegjit në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016”.*

Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues kam vlerësuar se:

13. Nga aktet në fashikull dhe deklaratimet e subjektit në procesverbalin në ILDKPKI në datën 27.04.2016 dhe gjatë hetimit administrativ në Komision rezulton se këtë automjet subjekti, pasi e ka blerë në Gjermani me kontratë shitblerje të rregullt, e ka mbajtur nga data 13.04.2007 (hyrja në Shqipëri) deri në datën 11.05.2007 (kur është bërë shitja sipas kontratës), pra, për një periudhë 1-mujore. Sipas deklaratimeve të subjektit dhe deklaratës noteriale rezulton e provuar që shtetasi I. V. i ka kërkuar subjektit t'i blejë një automjet në Gjermani, me shpenzime dhe vlerë të parapaguar prej tij. Këto të dhëna konfirmojnë deklaratimet e subjektit për kryerjen e një blerjeje për llogari të një personi tjetër dhe jo për veten e tij dhe, gjithashtu, janë një provë që vërteton faktin që këta persona kishin një marrëdhënie miqësore mes tyre, pavarësisht se në kontratën e shitjes është shënuar se palët nuk njihen.
14. Lidhur me ndryshimin e çmimit të shitjes në kontratë në vlerën prej 500.000 lekësh, provohet se nga llogaritja e të gjithë shpenzimeve për blerjen dhe zhdoganimin e automjetit, shuma që rezulton prej 1.969.608 lekësh është sa shuma që subjekti ka deklaruar që i ka dhënë shtetasi I. V. (2.000.000 lekë). Mendoj që pavarësisht deklaratimit kontradiktor nuk ka vend për dyshime se deklarimi ndryshe i çmimit në kontratën e shitblerjes është bërë për shkak të ndonjë përfitimi nga subjekti. Gjithashtu, nuk rezulton që në këtë periudhë subjekti të ketë deklaruar krijimin e ndonjë pasurie që mund të çojë në lindjen e dyshimit për vërtetësinë e çmimit të shitjes së automjetit në vlerën prej 500.000 lekësh dhe jo aq sa ishte në kontratën e blerjes në Gjermani. Edhe nga hetimi në Komision rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë fitim/të ardhur nga ky transaksion shitblerjeje.
15. Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën periodike të vitit 2007 nga subjekti të shitblerjes së automjetit, të ngritur si shkak ankimi nga Komisioneri dhe të pranuar nga shumica e trupit gjykues në konkluzion të vendimit për këtë pasuri, e vlerësoj në tejkalim të fushës së veprimit të ligjit nr. 84/2016. Në kuadër të këtij ligji, objekt kontrolli është deklarata *vetting* për pasuritë e deklaruara dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit të këtyre pasurive. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një transaksion shitblerjeje të subjektit të rivlerësimit për një pasuri të luajtshme, që edhe pse shumica shprehet që për të janë kryer veprime juridike dhe është regjistruar në regjistrat publikë, vlerësoj se gjurma e lënë në këto regjistra për një periudhë 1-mujore gjatë vitit 2007 është shuar në kuptim të detyrimit ligjor për ta deklaruar në deklaratën periodike e, aq më tepër, për ta sjellë në deklaratën *vetting*. Bazuar në këtë arsyetim, vlerësoj se as Komisioneri Publik dhe as shumica në vendim nuk kanë arritur të evidentojnë lidhjen që ka ky mosdeklarim në procesin e rivlerësimit të subjektit. Për sa kohë që subjekti nuk ka deklaruar dhe nuk provohen të ardhura nga ky transaksion, që mund të afektonin pasuri të tjera të tij deri në procesin e rivlerësimit, mosdeklarimi në deklaratën periodike të vitit 2007, si dhe pasaktësitë e evidentuara në akte mbeten shkelje që mund të konsiderohen në kuadër të ligjit nr. 9049, por jo për efekt të procesit të rivlerësimit.

16. Në arsyetimin e vendimit të shumicës, në paragrafët 48 dhe 49, nuk arrij që të gjej asnjë argument se cila është lidhja e mosdeklarimit të kësaj pasurie në deklaratën periodike të vitit 2007 me deklaratën *vetting* në kuadër të procesit të rivlerësimit.
17. Në përfundim, çmoj se mosdeklarimi i shitblerjes së automjetit në vitin 2007 dhe sjellja e sforcuar në procesin e rivlerësimit të kësaj pasurie nuk mund të marrë vlerën e pasaktësisë me pasojë deklarim të pamjaftueshëm në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, siç pretendon Komisioneri Publik dhe shumica në vendim, duke tejkaluar në mënyrë të paarsyeshme konceptin e rivlerësimit kalimtar.
18. Për pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa belge, {***} dhe për transaksionet bankare të kryera nga personi i lidhur R.B. (R.), jam dakord me qëndrimin e mbajtur nga shumica në vendim.

Për shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e figurës dhe gjetjet në raportin e DSIK-së

19. Për kontrollin e figurës, Komisioni në vendim është shprehur se: “[...] të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së nuk provojnë implikimin e subjektit të rivlerësimit në veprime të paligjshme me natyrë korruptive, ndikim të paligjshëm apo kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar (në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë)”.
20. Komisioneri Publik, bazuar në raportin e DSIK-së³, parashton në ankim se lidhur me procedimin penal nr. {***}, ndryshe nga qëndrimi i mbajtur nga Komisioni, çështjet e referuara në raportin e DSIK-së që ngrenë dyshime për përfshirje në veprime korruptive, paraqesin rrethana të ndryshme nga ato të verifikimit të aftësive profesionale të subjektit. Në përfundim, për kontrollin e figurës, Komisioneri Publik vlerëson se nga të dhënat e administruara si rezultat i informacioneve të organeve ligjzbatuese, duket se rezultojnë disa rrethana, të cilat, të analizuara së bashku me rezultatet e tjera të hetimit, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
21. Shumica e trupit gjykues, në paragrafin nr. 81 të vendimit, është shprehur se: “Në konkluzion, për kriterin e kontrollit të figurës, në analizë të veprimeve procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me procedimin penal nr. {***}, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit

³ DSIK-ja pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, ka përcjellë raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, në të cilin informohet se: “[...] Gjatë periudhës në të cilën z. Bejko ushtronte detyrën si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive *****. Në përfundim, grupi i punës, nisur nga të dhënat e siguruar nga autoritetet verifikuese, ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës, në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Bledar S. Bejko [...]”.

Gjyqësor Durrë, s për veprën penale të vrasjes, të vendosura në kontekstin e informacioneve të administruara nga organet ndihmëse në procesin e kontrollit të figurës, sipas nenit 36 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në përfundimin se ndonëse nuk rezultojnë rrethana që çojnë në kualifikimin e subjektit, si të papërshtatshëm në kuptim të këtij kriteri, gjenden mjaftueshëm elemente që tregojnë për ekzistencën e një vlerësimi me mangësi në kuadër të aftësive profesionale, të vlefshme për të krijuar premisat e duhura për një vlerësim të tyre sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016”.

22. Ndaj mendim të kundërt me shumicën e trupit gjykues, lidhur me konkluzionin për kontrollin e kriterit të figurës, duke e konsideruar kontradiktor këtë konkluzion dhe të pabazuar në jurisprudencën e Kolegjit, lidhur me ndërthurjen që i është bërë vlerësimit të këtij kriteri me standardet e kontrollit të aftësive profesionale. Shumica nga njëra anë konfirmon qëndrimin e Komisionit në paragrafin 72⁴ të vendimit e nga ana tjetër kundërshton qëndrimet e mbajtura nga Kolegji, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit në kriterin e figurës⁵.
23. Referuar shkakut të ankimit të Komisionerit Publik për kriterin e figurës, të mbështetur nga shumica në vendim, vlerësoj se analizimi i gjetjes së DSIK-së në këndvështrim të vlerësimit të aftësive profesionale është bërë në mënyrë të sforcuar brenda këtij kriteri, për sa kohë Komisioni në vendim e ka trajtuar dhe shqyrtuar hollësisht fashikullin që i përket procedimit penal nr. {***}, në pjesën “Gjetje të tjera”.
24. Duke vlerësuar se konkluzioni i Komisionit është i drejtë dhe i bazuar në fakte dhe në ligj, për këtë shkak ankimi, konstatohet se fashikulli penal që i përket procedimit penal nr. {***}, datë 12.04.2017, në ngarkim të të pandehurit K. E., akuzuar për veprën penale “vrasje nga

⁴ Paragrafi 72 i vendimit: “Në vlerësim të sa më sipër, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, nga aktet në dispozicion, si dhe nga raporti i DSIK-së, trupi gjykues konfirmon qëndrimin e mbajtur nga Komisioni se nuk provohet që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo se ka rrethana të tilla që do të kualifikonin subjektin e rivlerësimit si të papërshtatshëm për kriterin e kontrollit të figurës në kuptim të parashikimeve të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 38 e 39 të ligjit nr. 84/2016”.

⁵ Vendimi nr. 20/2020 (JR) i Kolegjit, paragrafi 34.3: “[...] Kolegji vlerëson se, pavarësisht se u është dhënë përgjigje të gjitha shkaqeve të ngritura nga subjekti në ankim, këto procedime penale janë marrë në shqyrtim nga Komisioni në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës, por duke analizuar aftësitë profesionale të subjektit, pasi në Raportin e DSIK-së rezulton se disponohen të dhëna, nga ku ngrihen dyshime për përfshirje në veprime korruptive në disa çështje penale, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në këtë kontekst është e pamundur që, në kuadër të vlerësimit të figurës, të zbatohen standardet e kontrollit të aftësive profesionale, pasi burimet mbi të cilat merren informacionet për kontrollin e këtyre kriterëve të rivlerësimit, janë të ndryshme, gjithashtu i ndryshëm është edhe objekti i kontrollit. Në nenin 71 të ligjit nr. 96/2016 përcaktohen kriteret, mbi të cilat kryhet vlerësimi profesional, të cilat janë: aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë organizative; etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit dhe prokurorit; aftësitë personale dhe angazhimi profesional. Në këtë këndvështrim, në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës, e cila ka standarde të posaçme të kontrollit sipas nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të aplikohen standardet e kontrollit të kriterit të aftësive profesionale [...].

pakujdesia”, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal, është administruar në Komision, në vijim të informacioneve të DSIK-së, si dhe pas denoncimeve të përsëritura të shtetases V. A., dhe është trajtuar nga Komisioni në kuadër të vlerësimit profesional të subjektit. Në këto rrethana, në vlerësimin e këtij shkak ankimi të Komisionerit, shumica duhej të mbante në konsideratë qëndrimin e Kolegjit që është shprehur në disa vendime të tij⁶ se: “[...] rastet e referuara në raportin e DSIK-së, që ngrenë dyshime për korrupsion, në mungesë të provave apo hetimit nga ana e Komisionit, në funksion të përcaktimit të ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme në dritën e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, nuk përmbajnë elemente të qenësishme që të cilësohen me ndikim në vlerësimin e kriterit për kontrollin figurës”.

25. Komisioneri Publik ngre si shkak ankimi për procedimin penal nr. {***} se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë kryer njoftim mbi vendimin e pushimit⁷, sipas parashikimeve ligjore, duke u mohuar palëve të drejtën për ushtrimin e ankimit e duke sjellë si pasojë barazimin me vendimin e pafajësisë për të akuzuarin.
26. Rezulton se Komisioni në vendim ka trajtuar në mënyrë të detajuar denoncimin e shtetases V. A. dhe ka konstatuar se në kohën kur është dhënë vendimi i pushimit në datën 11.7.2017 nuk kishte hyrë në fuqi ligji nr. 35/2017, ndryshime në Kodin Penal, ku trashëgimtarët nuk njiheshin si subjekte procedurale. Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se në tërësi nga të dhënat e rezultuara nga komunikimet, si dhe nga vendimet e gjykatave, duket se ankuesja ka marrë dijeni për vendimin e pushimit.
27. E vlerësoj të bazuar në fakte dhe në ligj përfundimin e Komisionit, që pas një hetimi të zgjeruar, në raport me legjislacionin, veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit në këtë çështje, vendimet e dhëna nga gjykatat ndaj subjektit lidhur me kallëzimet e bëra nga shtetasja V. A.⁸, përfshirë edhe statusin ligjor të vendimmarrjes, kontrolluar nga një gjykatë më e lartë, ka konkluduar se

⁶ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 1/2020, datë 15.01.2020, paragrafët nr. 66, 68; nr. 6/2020, datë 18.06.2020, paragrafi nr. 43.6. dhe nr. 20/2020, paragrafi nr. 34.5,

⁷ Në vendimin e pushimit të datës 11.07.2017, rezulton e shkruar “Me këtë vendim të njoh personat e interesuar”.

⁸ Shtetasja V. A. ka paraqitur kallëzimin penal, regjistruar me nr. {***}, ndaj prokurorit Bledar Bejko për veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Nga aktet në fashikull konstatohet se ndaj shtetasit Bledar Bejko nuk rezulton të jetë regjistruar procedim penal, konfirmuar kjo nga verifikimi i bërë në regjistrat e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë për Krime të Rënda dhe SPAK-ut, dhe se për çështjen penale nr. {***} është vendosur mosfillimi si procedim penal (i pa ankimuar), sepse pretendimet e paraqitura në kallëzim nuk përmbajnë elementët e veprës penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”. Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka informuar, me shkresën nr. {***} prot., datë 29.12.2021, se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar kallëzimi nr. {***}, nga ish-Prokuroria e Krimeve të Rënda Tiranë. Pas kryerjes së verifikimeve lidhur me këtë kallëzim është regjistruar procedimi penal nr. 87/2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal “korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”. Me vendimin nr. {***}, datë 20.10.2020, Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka vendosur pushimin e çështjes (e pa ankimuar).

lidhur me procedimin penal nr. {***} nuk konstatohen problematika që të ndikojnë në vlerësimin e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit.

28. Në ndryshim nga arsyetimi i shumicës së trupit gjykues në paragrafët 77-79 vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk ka mohuar detyrimin ligjor për njoftimin e vendimit të pushimit personave të interesuar, në këtë rast bashkëshortes së viktimës, V. A., pavarësisht argumentit të dhënë se ai e ka konsideruar një veprim administrativ dhe detyrë të sekretarisë, pasi ai ka disponuar në vendimin e pushimit në datën 11.07.2017, për njoftimin e këtij vendimi. Duke mos qenë dakord me këtë argument të përdorur nga subjekti, për të justifikuar mosndjekjen nga ana e tij që akti t'i njoftohej bashkëshortes së viktimës, kjo nuk bën të pavlerë faktet dhe rrethanat se: (i) denoncuesja V. A. gjatë procedimit penal nr. {***} ka pasur dhe ka ndërruar disa mbrojtës ligjorë; (ii) ka marrë në dorëzim dhe është njohur me të gjitha aktet e dosjes penale; (iii) ka publikuar fakte dhe prova nga dosja penale; (iv) ka bërë ankim vetë dhe nëpërmjet avokatit të saj në Prokurorinë e Përgjithshme⁹, në Presidencë, në Kryeministri, në KLD dhe në Komitetin Shqiptar të Helsinkit; (v) ka marrë pjesë në gjykimin e të pandehurit K. E. së bashku me avokatin e saj; dhe (vi) ka bërë ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, marrë ndaj të pandehurit.
29. Në analizë të rrethanave të referuara më lart, vlerësoj se denoncuesja V. A. me veprimet që ka kryer, të cilat kanë ardhur si reflektim kundërshtimi ndaj vendimit të pushimit, më bëjnë të vështirë që të besoj se ajo nuk është njoftuar me vendimin e pushimit të datës 11.07.2017. Gjithashtu, çmoj se shumica në vendim duhej të mbante në konsideratë edhe faktin që edhe nëse denoncuesja nuk ishte njohur me vendimin e pushimit, ajo në çdo kohë mund ta kërkonte atë vendim dhe të ushtronte ankimin në gjykatë, meqenëse Kodi i Procedurës Penale, përpara ndryshimeve të vitit 2017 nuk parashikonte asnjë afat dhe ankimi ndaj vendimit të pushimit mund të ushtrohej në çdo moment, pavarësisht ditës së marrjes dijeni.

Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

30. Komisioni, pas analizimit të disa procedimeve penale dhe disa denoncimeve nga publiku të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka vlerësuar se ato në tërësi nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit. Në përfundim, Komisioni, pasi shqyrtoi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë shkak, konsiderohet “i aftë”.

⁹ Shkresa zyrtare e Prokurorisë së Përgjithshme me nr. {***} prot., datë 05.05.2023, që përmban të gjithë praktikën e ankimit të shtetases V. A., si dhe dokumentacioni i plotë i praktikës, dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme, ku në ankim evidentohet qartë se vendimi i pushimit cilësohet si paargumentuar apo i bërë me tendencë abuzive.

31. Komisioneri Publik në ankim ndan qëndrim të ndryshëm lidhur me gjetjet e konstatuara në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, duke parashtruar konstatime për disa procedime penale për të cilat ka qenë i ngarkuar subjekti i rivlerësimit.
32. Shumica e trupit gjykues, në paragrafin 115 të vendimit, ka konkluduar se: *“Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim problematikat e trajtuara brenda kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale të ngritura në ankimin e Komisionerit Publik e të arsyeuara edhe më lart, ndonëse konstatoi mangësi të subjektit të rivlerësimit në drejtim të aspektit të njohurive ligjore dhe të arsyetimit ligjor, por edhe në drejtim të aftësive organizative të tij, të hasura në çështjet më sipër të trajtuara, sërish, i vlerësoi ato të pamjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit duhet të konsiderohet si i paaftë në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por çmoi se ato do të duhen të vlerësohen së bashku me gjetjet e tjera, të renditura më sipër, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016”.*
33. Lidhur me konkluzionin e shumicës së trupit gjykues, jam dakord dhe e mbështes atë deri në pikën ku shprehet që nuk ndodhemi në një vlerësim të pamjaftueshëm të aftësive profesionale, duke mos qenë dakord për trajtimin parë në vlerësimin tërësor me gjetjet e tjera të renditura në kriteret e tjera, bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
34. Konstatoj se shumica e trupit gjykues, në analizë të shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, ka gjetur të bazuara konstatimet e tij për:
- procedimin penal nr. 1908/2017, regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të punonjësve të policisë të dyshuar, Komisar K. Xh. dhe nënkomisar Gj. A., ku përcaktohet se: *“Duket se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, të arsyetimit ligjor dhe cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik të prokurorit, sipas parashikimeve të nenit 73, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, dhe duhet të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016”;*
 - denoncimin e shtetasit A. A., i cili pretendon se subjekti ka vendosur në mënyrë të padrejtë mosfillimin e procedimit penal të iniciuar mbi bazën e kallëzimit të denoncuesit, ku përcaktohet se: *“Subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, pasi mosrespektimi i afateve ligjore, moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3 dhe nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 dhe duhet të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016”;*
 - denoncimin e shtetasit S. M., duke pretenduar se kallëzimi i bërë prej tij me nr. {***}, datë 15.5.2008, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nuk është ndjekur dhe trajtuar nga subjekti, ku përcaktohet se: *“Subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, pasi moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme bie*

ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3 dhe nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 dhe duhet të merret në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016”.

35. Në një vlerësim të tri shkaqeve të ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, konstatoj se shumica i ka bërë një arsyetim tejet të zgjeruar situatës faktike dhe akteve të administruara në fashikuj për këto procedime penale, duke çuar në rëndimin e pozitës së subjektit të rivlerësimit dhe nuk ka mbajtur në konsideratë parashikimin ligjor të pikës 4, të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, ku përcaktohet se: *“Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit, pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet”.*
36. Duke mbajtur në konsideratë në tërësi për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale se qëndrojnë konstatimet e Komisionerit Publik dhe të shumicës së trupit gjykues në vendim, për disa mangësi të shfaqura nga subjekti i rivlerësimit në këto çështje të referuara, por që nuk janë në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës të mos ta zgjidhë këtë çështje për 1 vit, çmtoj se shumica duhej të mbante në konsideratë, ndër të tjera, edhe:
- ushtrimin e detyrës së magjistratit bazuar në bindjen e tij të brendshme;
 - mosvlerësimin mbi bazë të themelit të çështjes;
 - moskonstatimin e gabimeve/mangësive të një natyre serioze dhe thelbësore apo të një serie në vazhdimësi të veprimeve/mosveprimeve të gabuara;
 - ngarkesën e lartë të volumit të punës së përballuar nga subjekti i rivlerësimit, sidomos në vitet e fundit;
 - shkallën e vështirësisë dhe kompleksitetin e disa procedimeve penale.
37. Në konkluzion të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, vlerësoj se mangësitë e konstatuara në drejtim të aspektit të njohurive ligjore e të arsytimit ligjor për subjektin e rivlerësimit, si dhe në drejtim të aftësive organizative të tij, vetëm për 3 çështjet e ngritura në ankim nga Komisioneri Publik, nuk mund të shërbejnë për të përgjithësuar punën e subjektit në mbi 20 vite ushtrim detyre, si dhe nuk duhet të marrin peshën për t’u konsideruar në vlerësimin tërësor, sipas nenit 4, pika 2 të ligjit nr. 84/2016.
38. Në përfundim, në vlerësimin tërësor të çështjes, për sa i përket vlerësimit të aftësive profesionale, shumica e trupit gjykues duhet të mbante në konsideratë vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, datë 18 janar 2017: *“Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë*

mungesë të aftësive profesionale¹⁰”, si dhe jurisprudencën e Kolegjit, mbajtur në vendimin nr. 28/2020: “Kolegji çmon se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore nuk mund të jetë një alternativë vlerësimi e përdorur prej organeve të rivlerësimit, për sa kohë që ky lidhet me vlerësimin e çmimit e provave dhe mbështetet mbi bindjen e brendshme të magjistratit. Në rastin konkret, pikërisht vlerësimi i aftësive profesionale të magjistratit, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjyqësore përkatëse, duke arsyetuar mbi provat e të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit, prandaj edhe Kolegji vlerëson se konkluzioni se subjekti ka dhënë një zgjidhje të gabuar, duke deklaruar pafajësinë e njërit prej të gjykuarve, është një konkluzion në tejkalim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk mund të përdoret për të kryer vlerësimin e tij¹¹”, konkluduar arsyetimi në paragrafin 12.5 të tij¹², që e konsideroj të njëjtlëshme edhe në rastin e magjistratit prokuror.

Lidhur me denoncimet nga publiku të ardhura në Kolegj

39. Në Kolegj, gjatë shqyrtimit të çështjes në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, janë paraqitur nga publiku ose janë përcjellë nga Komisioneri Publik këto denoncime: (i) pesë denoncime nga shtetasi I. H., nga të cilat tre denoncime, përcjellë në Kolegj nga Komisioneri Publik¹³ dhe dy denoncime të ardhura në Kolegj me e-mail¹⁴; (ii) denoncim nga shtetasit A. G., S. R., J. K., B.

¹⁰ Paragrafi 54 i vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

¹¹ Paragrafi 10.8 i vendimit të Kolegjit.

¹² Paragrafi 12.5 të vendimit të Kolegjit: “Kolegji vlerëson të nënvizojë qëndrimin se fakti që një gjykatë më e lartë, në këtë rast Gjykata e Lartë e vendit, ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm në vlerësimin e një çështjeje gjyqësore nga ajo që ka mbajtur gjykata ku është pjesë e vendimmarrjes magjistrati (subjekti i rivlerësimit), nuk mund të përdoret apriori si një argument për të vlerësuar negativisht aftësitë profesionale të magjistratit, veçanërisht ato që lidhen me zgjidhjen e çështjes, siç është rasti konkret. Në këtë arsyetim, vlen të sillen në vëmendje se edhe sistemi i vlerësimit periodik të magjistratëve, i parashikuar prej ligjit nr. 96/2016, nuk parashikon matjen e aftësive për gjykim apo arsyetimin ligjor të magjistratëve në varësi të qëndrimit që gjykatat më të larta mbajnë mbi vendimet e tyre. Aq më shumë, ky kriter nuk mund të përdoret si determinant në procesin e rivlerësimit, në të cilin pasoja e vlerësimit profesional mund të ndikojë në mënyrë thelbësore fatin profesional të magjistratit, por edhe më tepër kur i gjithë ky proces ka pasur nën vlerësimin e tij edhe vetë aftësitë profesionale të të gjithë gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë, të cilët në raste të caktuara, në varësi të shkallës ku kanë gjykuar, mund të kenë qenë përkatësisht, gjyqtarë më të lartë ose më të ulët. Në këtë kontekst, qëndrimet e mbajtura nga gjykatat më të larta mund të provokojnë një vlerësim apo hetim të mëtejshëm drejt sjelljes profesionale të magjistratit, por ato nuk mund të jenë kriteri matës determinant për vlerësimin e aftësive profesionale të tyre. Përpos këtij arsyetimi, rekomandimet e Këshillit të Evropës mbi pavarësinë e sistemit gjyqësor, si dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatës së Lartë në Shqipëri, dhe parimet e gjithëpranuara të Bangalores mbi sjelljen e gjyqësorit, kanë qenë të qarta dhe eksplicite në këto raste për mospërdorimin e një vendimi të një gjykate më të lartë për të vlerësuar aftësitë profesionale të një gjyqtari të një shkalle më të ulët”.

¹³ Sjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 09.12.2022, shkresën nr. {***} prot., datë 13.12.2022 dhe shkresën nr. {***} prot., datë 18.4.2023.

¹⁴ Protokolluar me nr. {***} prot., datë 16/01/2023 dhe me nr. {***} prot., datë 11.05.2023.

Xh. dhe A. D.¹⁵; (iii) denoncim nga banorët e pallatit nr. {***}, Durrës¹⁶; (iv) denoncim nga shtetasja A. Z.¹⁷, denoncim nga avokati S. K.¹⁸; si dhe (v) denoncim nga shtetasja L. P.¹⁹.

40. Shumica e trupit gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi me shumicë votash që të vlerësonte denoncimet nga publiku të administruara në Kolegj gjatë gjykimit të çështjes, bazuar në informacionin që u kërkua nga prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në përgjigje të kërkesës së bërë nga trupi gjykues.
41. Lidhur me denoncimet e depozituara në Kolegj nga Komisioneri Publik dhe drejtpërdrejt nga denoncuesit, kam votuar që të mos merren në shqyrtim të mëtejshëm të thelluar nga ana e trupit gjykues, duke mbajtur në konsideratë se:
- nuk përmbajnë elementet e kërkuara nga pika 2, e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, për fakte dhe rrethana që të krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore²⁰;
 - disa prej tyre janë në proces hetimi nga organi i prokurorisë, për shkak të rrëzimit të vendimeve të mosfillimit dhënë nga subjekti i rivlerësimit, por edhe si rezultat i bashkimit të 2 ose më shumë procedimeve penale për kallëzimet e njëjta apo të ngjashme (kjo provuar me shkresat e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës nr. {***} prot., datë 15.05.2023 dhe nr. {***} pro., datë 02.06.2023);
 - disa prej procedimeve penale janë marrë nga subjekti i rivlerësimit prej prokurorëve të tjerë, me urdhër të drejtuesit të prokurorisë, që nënkupton edhe faktorin kohë në zgjatjen e hetimeve, përfshirë këtu edhe kompleksitetin e çështjeve që hetohen;
 - shkallën e subjektivitetit të denoncuesve, si dhe perceptimin e tyre individual për situatën faktike dhe zgjidhjen që pretendojnë²¹.
42. Referuar nenit E, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës, për çështjet që janë në shqyrtim, shumica e trupit gjykues nuk duhet që të shtrijë vlerësimin, pasi edhe pse prokurori është shprehur me vendim mosfillimi, kur çështja është në proces, prokurori do të vijojë të kryejë edhe një sërë

¹⁵ Përcjellë në Kolegj me shkresën nr. {***} prot., datë 09.02.2023, të Komisionerit Publik.

¹⁶ Përcjellë në Kolegj me shkresën nr. {***} prot., datë 10.02.2023, të Komisionerit Publik.

¹⁷ Protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 22.02.2023.

¹⁸ Protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 28.03.2023.

¹⁹ Regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 11.05.2023.

²⁰ Neni 53 i ligjit nr. 84/2016: "1. Çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit. Institucioni i rivlerësimit është i detyruar të kontrollojë nëse informacioni është dhënë nga një person i njohur ose anonim. 2. Informacioni duhet të përmbajë përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore, sipas kriterëve të rivlerësimit, veçanërisht për veprimin ose praktikën e dyshuar, pasojat ligjore, rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, si dhe të dhënat mbi identitetin e personit [...]".

²¹ Në rastin e denoncimeve nga I. H., nga aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit nga prokuroritë e rretheve Durrës dhe Tiranë, rezulton që ky denoncues të ketë bërë një numër shumë të madh denoncimesh në 2 prokurori të vendit (10 në Tiranë dhe 14 në Durrës, sipas shkresës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës nr. {***} prot., datë 15.05.2023).

vendimmarrjesh të tjera që do të duhet të jenë pjesë e vlerësimit të plotë të çështjes (denoncimet e shtetasit I. H.).

43. Për sa më lart, për denoncimet nga publiku, kam vlerësuar se problematikën e konstatuar nuk janë të mjaftueshme dhe me peshë të tillë për ta klasifikuar subjektin e rivlerësimit si të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës, si dhe për cenim të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
44. Në konkluzion të këtij arsyetimi konstatohet se vendimi nr. 25, datë 26.06.2023, i Kolegjit, për vlerësimin e të gjitha shkaqeve të ankimit të ngritura nga Komisioneri Publik për të tria kriteret e rivlerësimit, nuk ka arritur që t'i konsiderojë ato të mjaftueshme për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 61, pikat 1- 4 të ligjit nr. 84/2016. Shumica e trupit gjykues në vendim, shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik për kontrollin e vendimit të Komisionit, duke përfshirë edhe mangësitë e konstatuar në denoncimet nga publiku, në mënyrë të sforcuar i ka ngritur dhe konsideruar në vlerësimin tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke i kualifikuar si cenim të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, të tillë që subjekti i rivlerësimit të ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit, dhe duke dhënë në përfundim masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për sa kam analizuar më lart, i vlerësoj këto shkaqe ankimi të pabazuara dhe në tejkalim të objektit të rivlerësimit.
45. Në përfundim të arsyetimit të mësipërm, konkludoj se ankimi i Komisionerit Publik, për shkaqet e mësipërme, nuk duhet të pranohej dhe vendimi nr. 535, datë 26.05.2022, i Komisionit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Bledar Bejko, është i drejtë dhe i bazuar në fakte e në ligj dhe, për këtë arsye, duhet të lihej në fuqi.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi